nr. 78, viti/anno XIII, llonar-shëndrè / luglio-dicembre 2014

Jeta Arbëreshe

e-mail: *jetarbreshe@libero.it* - *http://digilander.libero.it/jetarbreshe* **(Mondo Italo-Albanese)**

Del nga gjashtë muaj - Semestrale online della Minoranza linguistica storica Albanese d'Italia - **Eianina / Purçill (Cs- Italia)**

Përmbajtja / Sommario

TË DREJTAT E SHQIPTARËVET faqe 2/4
Ermira Babamusta

EDITORIALI faqe 3
Drejtori

NGA KATUNDET ARBËRESHË faqe 5-9
Italo Costante Fortino, Motimadh

TEKSTE, ZAKONE POPULLORË NGA KATUNDET ARBËRESHË faqe 10-15
Carmine Stamile, Gregorio Talò, Kostantin Bellushi, Anna Blaiotta, Giuseppe Chiaffitelli, Maria Miranda

PËRVJETORË faqe 16-19
Drejtori, Flavia D'Agostino

POEZI SHQIPE faqe 20-24
Visar Zhiti, Lek Pervizi

POEZI ARBËRESHE faqe 25
Zef Beccia, Marg Scilippa

ESE E REFLEKSE KOSOVARE faqe 26-29
Ali Podrimja

STUDIME E ARTIKUJ MBI J. DE RADËN faqe 30-47
Denisa Tare, Vebi Bexheti, Alma Dema, Greta Jani, Alisa Velaj, Imri Badallaj

STUDIME E ARTIKUJ MBI BOTËN ARBËRESHE/ARBRO-SHQIPTARE faqe 48-55
Agim Vinca, Manjola Lubishtani, Helena Grillo

PAPA NË SHQIPËRI faqe 56-59
Elidon Dodaj

ARTIKUJ E STUDIME MBI BOTËN SHQIPTARE faqe 60-63
Lush Gjergji

SEMINARI NDËRKOMBËTAR I PRISHTINËS faqe 64

BIBLIOGRAFIA E REVISTËS 'JETA ARBËRESHE' (nn.72,73-78) faqe 65-73
Autorë & Shkrime / Shënime Bibliografikë

BIBLIOGRAFI ARBËRESHE NDËPËR REVISTAT SHQIPTARE faqe 74-75

REÇENSIONA, LIBRE E REVISTA faqe 76

JO VETËM ARBËRISHT faqe 77
Pierfranco Bruni

QISHA BIXANTINE ARBËRESHE faqe 78-95
Emanuele Giordano

FRAZEOLOGJI ARBËRESHE faqe 96
Drejtori

Peticionë: Të hiqet statusi kandidat i Serbisë për në BE

Serbia shkelën 'të drejtat e njeriut' mbi Shqiptarët *

Ermira Babamusta, Ph.D.
shqiptare, eksperte për marrëdhënie ndërkombëtare, London/New York

15 October/Tetor 2014

To / Zotërinjvet: **Barack Hussein Obama**, President of United States
Ban Ki-Moon, Secretary-General of the United Nations
European Commission: Humanitarian Aid and Civil Protection (ECHO) Department; and Enlargement Department (ELARG)
Jens Stoltenberg, Secretary General of NATO
Michel Platini, President of UEFA
Robert Menendez, Chairman of the United States Senate Committee on Foreign Relations

OBJEKT: ShBA-ja dhe Komuniteti Ndërkombëtar duhet të paraprijnë në çështjet emergjente të shkeljes së drejtave njerëzore ndaj Shqiptarëve sot.

Më 14 tetor 2014, 45 qytetarë shqiptarë u arrestuan në Aeroportin e Beogradit, duke përfshirë edhe Ambasadorin shqiptar, z. Ilir Boçka. Një grup gazetarësh, biznesmenë dhe titullarë nga Shqipëria, në udhëtim për të parë ndeshjen Serbi-Shqipëri, u ndaluan në mbasdite, sepse një shqiptar po udhëtonte me shallin e përfaqësueses kombëtare. Autoritetet serbe të aeroportit nuk dhanë asnjë shpjegim dhe arrestuan pa bazë ligjore 45 shqiptarë. Kjo është shkelje direkte e Nenit 2, 7, dhe 9 e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Ky skandal diplomatik u acarua shumë shpejt me abuzime kundra të drejtave të njeriut ndaj shqiptarëve, nga aktet e dhunës Serbe gjatë lojës së futbollit.

Ne jemi thellësisht të shqetësuar që përjetuam një lojë, e cila pasqyroi gjëndje lufte, ku 5,000 forca policore serbe bashkë me forcat e sigurisë kombëtare serbe, rrethuan Stadiumin "Partizani" në Beograd, me 14 tetor 2014, ku nuk lejuan asnjë me pashaportë shqiptare të hyjin në stadium. Ky nivel sigurie është rast paprecedent në historinë botërore. Federata e Futbollit të Serbisë përveç kushtete të tjera diskriminuese ka: **(1)** mohuar bileta dhe hyrje të shqiptarëve nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, etj; **(2)** ndaluar udhëtimin e ekipit të Kombëtares Shqiptare "Kuq e Zi" të udhëtojnë të shoqëruar me tifoza shqiptarë. Këto rregulla raciste, të miratuara nga shteti i Serbisë, janë në kundërshtim të rregullores së UEFA's "Fair Play", dhe nuk promovojnë bashkim dhe solidaritet në futboll.

Jemi thellësisht të indinjuar që policia serbe, lojtarët e ekipit serb dhe tifozat serb sulmuan brutalisht tre lojtarë shqiptarë në dhomën e zhveshjes. Në fakt, gjatë lojës tifozat serb kanë goditur drejtëpërdrejtë lojtarët shqiptare me shishe, gurë, karrike dhe fishekzjarre. Asnjë zyrtar i lojës, dhe as policia serbe nuk i ndaluan këto akte dhune. Fotografi dhe video të publikuara tregojnë një sërë rastesh kërcënimi dhe dhunë fizike ndaj ekipit shqiptar, nga lojtarët dhe tifozët serb, si dhe nga e njëjta forcë policore serbe, e cila kishte për detyrë të zbatonte masat e sigurisë. Parrullat raciste "Vrisni Shqiptarët" nga lojtarët dhe tifozat serb ishte po ashtu e papërgjegjëshme. Loja Serbi-Shqipëri u ndërpre nga gjyqtari anglez Martin Atkinson për shkak të traumës psikologjike dhe dhunës fizike ushtruar ndaj ekipit shqiptar gjatë ndeshjes në Beograd.

Këto janë shkelje serioze e të drejtave të njeriut, në një kohë kur Bashkimi Europian hapi negociatat zyrtare per anëtarësimin e Serbisë në BE me 21 Janar 2014. Ndërsa këto shkelje vazhdojnë sot, **(1)** mijëra shqiptarë në Luginën e Preshevës Shqiptare (Serbia Jugore) janë arrestuar, torturuar, vrarë, dhe vazhdojnë të kenë shkelje brutale e të drejtave të njeriut për dekada; **(2)** dhjetëra mijë shqiptarë në Kosovë janë vrarë dhe persekutuar nga autoritetet serbe në fushatat e spastrimit etnik; **(3)** diskriminim, rracizëm dhe shkelje e të drejave të njeriut ndaj shqiptarëve etnik në Maqedoni (1 million shqiptarë), duke përfshirë edhe arrestimin e gjashtë shqiptarëve me burgim të përjetshëm pa prova dhe fakte, që rezultoi në protesta paqësore të shqiptarëve në mbarë botën në Amerikë dhe Europë; **(4)** rracizëm dhe shtypje të shqiptarëve në Mal të Zi: largim me dhunë nga trojet e tyre dhe mohimi i mësimit të gjuhës shqipe dhe simboleve kombëtare;**(5)** Greqia, anëtare e BE-së, sot refuzon të drejtat e njeriut ndaj shqiptarëve të Çamërisë: 300,000

(vijon te faqja 4)

Papa: “Liria e Besës është një e drejtë e njeriut”.

Papa Frangjisku I, krei i Qishës Katolike të Rromës, gjatë vitit 2014 bëri edhe këta tre udhëtime: një ndë Kalabrì (te Dioqeza Latine e Cassano Jonio-s (Cs), gjitòne e Eparkisë Bixantine të Ungrës), njetër ndë Shqipëri e njetër në Turqi. Më parë erth e pá ka rrimi (Kalabrì), pra vate njohu rrënjat tona mëmësore-gjuhësore (Shqipëri) e pra ato besimtare-bixantine (Turqi, Patriarkati i Bisanxit/Kostantinòpolit). Një pelegrinazh i krishterë-arbëresh, me kë dish’ t’na lidhnij degat e sotme me rrënjat e djeshme. Ndë Shqipëri përpoqi katolikë, ortodhoksë e islamikë: këtu të krishterët (katolikë e ortodoksë) nëng zëhen me islamikët, s’ka fanatizëm. Mëmëdheu është i lirë, Besa është e lirë. Në Turqi, ku katolikët janë pakë, Papa u përpoq me presidentin Erdogan islamik e me patriarkun e Kostantinopolit Bartolomeu I, i krishterë ortodhoks. Me Erdoganin ‘e ngritë’ fjalët e Papës i muar ajri, me Patriarkun ortodhoks dy Qishat bën njetër hap përpara tek udha e paqësimit. Ndreu e Pjetri, dishipul të Zotit Krisht, ishin vllezër. I pari i thërritur ka Zoti Krisht qe Ndreu, e ky pra qelli Pjetrin te Mjeshtri. Ndreu, i pari i dishipulvet; Pjetri, i pari ndër Apostulit. Ndreu, i pari peshkop i Bisanxit/Kostantinopolit, Pjetri i pari peshkop i Rromës. Në Kostantinopol, tek Qisha e Shën Ndreut, tek dita e festës së tij, 30 shënmartir, u përpoqtin trashgimtarët e dy Qishavet, të Rromës e të Bisanxit, ajo Latine e ajo Bizantine Ortodhokse. E këtu Papa Latin (Pjetri) i lipi bekimin vëllaut Ortodhoks (Ndreut). Dy Qishat janë po të priren Motra, si ishin Vëllezër ata ç’i themeluan. Papa ndë Turqi gjet një Dhé me dy realitete: Islamikët, me Erdoganin president, janë po të imponojën diktaturën fetare islamike mbi të tjerët Besime; ka jetra anë gjet një Qishë Ortodhokse gati të bënjë paqë me Qishën Latine. Në ëmrin e Zotit Krisht.

Në shek.XV Bisanxi ra nën Turqit më parë se Kruja. Arbëreshët shkuan nd’Italli për të shpëtojën Besën e Krishterë dhe Lirinë. E qëndruan të Krishterë, të Lirë, Shqiptarë e Bixantinë. Një urë ekumenike. Po Krishtërimi s’është një kulturë, o një zakon, o një rrënjë. Krishtërimi është një Besë. Do rruar e do mbrojtur si Besë. Skanderbeku qe “luftari i Krishtit” e Skanderbeku është modeli i Arbëreshëvet, sot si dje. Feja s’imponohet më me shpatë, predikohet vet me fjalë. Në paqe. Nganjerì, pra, është i lirë të zgjethë Besën çë do. E para “e drejtë e njeriut”.

Drejtori

IL PAPA: “lA LIBERTÀ DI RELIGIONE E’ UN DIRITTO DELL’UOMO” - Papa Francesco I, capo della Chiesa Cattolica di Roma, durante il 2014, ha fatto anche questi tre viaggi: uno in Calabria (nella Diocesi Latina di Cassano Jonio-Cs, vicina di casa dell’Eparchia Bizantina di Lungro), un altro in Albania e un altro in Turchia. Prima è venuto a vedere dove stiamo (Calabria), poi è andato a conoscere le nostre radici etniche e linguistiche (Albania) e poi quelle religiose-bizantine (Turchia, Patriarcato di Bisanzio / Costantinopoli). Un pellegrinaggio cristiano-arbëresh, con cui ci ha voluto collegare i rami di oggi con le radici di ieri. In Albania ha incontrato cattolici, ortodossi e islamici: qui i cristiani (cattolici e ortodossi) non litigano con gli islamici, non c’è fanatismo. La Madrepatria è libera, la Fede è libera. In Turchia, dove i cattolici sono pochi, il Papa si è incontrato con il presidente Erdogan, islamico, e col patriarca di Costantinopoli Bartolomeo I, cristiano ortodosso.Con “il freddo” Erdogan le parole del Papa le ha prese il vento, col Patriarca ortodosso le due Chiese hanno fatto un altro passo avanti sulla strada della pacificazione. Andrea e Pietro, discepoli di Gesù Cristo, erano fratelli. Il primo chiamato da G.Cristo fu Andrea, e questi poi portò Pietro dal Maestro. Andrea, il primo dei discepoli; Pietro, il primo tra gli Apostoli. Andrea, il primo vescovo di Bisanzio/Costantinopoli; Pietro, il primo vescovo di Roma. A Costantinopoli, nella Chiesa di S.Andrea, nel giorno della sua festa, 30 novembre, si sono incontrati i successori delle due Chiese, di Roma e di Bisanzio, quella latina e quella Bizantina Ortodossa. E qui il fratello Latino (Pietro) ha chiesto la benedizione al fratello Ortodosso (Andrea). Le due Chiese stanno per tornare Sorelle, come erano Fratelli quelli che le hanno fondato. Il Papa in Turchia ha trovato una terra con due realtà: gli islamici, con il presidente Erdogan, stanno per imporre la dittatura religiosa islamica sulle altre Religioni; dall’altra parte ha trovato una Chiesa Ortodossa pronta a fare pace con la Chiesa Latina. Nel nome di Gesù Cristo.

Nel sec.XV Bisanzio cadde sotto i Turchi prima di Kruja. Gli Arbëreshë vennero in Italia per salvare la Fede Cristiana e la Libertà. E sono rimasti Cristiani, Liberi, Albanesi e Bizantini. Un ponte ecumenico. Ma il Cristianesimo non è una cultura, o una tradizione, o una radice. Il Cristianesimo è una Religione. Da vivere e da difendere come Religione. Skanderbeg è stato “l’atleta di Cristo” e Skanderbeg è il modello degli Arbëreshë, oggi come ieri. La Religione non s’impone più con la spada, si predica solo con la parola. In pace. Ognuno, poi, è libero di scegliere la Religione che vuole.

Il primo “diritto dell’uomo”.

Peticionë: Të hiqet statusi kandidat i Serbisë për në BE

Serbia shkelën 'të drejtat e njeriut' mbi Shqiptarët

(vjen ka faqja 2)

në Shqipëri, 100,000 shqiptarë ortodoks në Çamëri, dhe mbi 200,000 në Europë dhe Amerikë; duke iu mohuar të drejtën e kthimit të pronës, të drejtën e rikthimit në vendlindje, të drejtën e gjuhës amëtare, duke moslejuar futjen e shqiptarëve çam me pashaporta shqiptare në Çamëri (Greqi) për të vizituar varret e të parëve dhe pronat e tyre; Greqia akoma nuk ka hequr ligjin absurd të luftës me Shqipërinë. Po ashtu mbi 500,000 shqiptarë të emigruar në Greqi, u mohohet e drejta e gjuhës amëtare, e punësimit, e identitetit kombëtar, në shumë raste duke i arrestuar dhe vrarë pa shkak. Nga viti 1998-2002, 502 fëmijë shqiptarë romë u zhdukën nga Instituti i Fëmijëve në Athinë, "Aghia Varvara", duke shkelur Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve.

Në interes të mbrojtjes së paqes, demokracisë dhe të drejtave të njeriut, ne ju kërkojmë:

Të merren masa urgjente kundër personave përgjegjës serb, që kryen akte dhune dhe abuzim fizik ndaj lojtarëve shqiptarë në lojën zhvilluar në Beograd. Ne i kërkojmë UEFA-s të heqi dhe penalizojë lojtarët serb që thyen rregulloren e UEFA-s, dhe sulmuan dhunshëm lojtarët shqiptarë.

I bëjmë thirrje qeverisë së Serbisë të shkarkojë nga puna policët serb që bënë brutalitet policor kundra skuadrës shqiptare, dhe t'i dënojë penalisht.

Ne kërkojmë që Komisioni Europian të heqi statusin kandidat të Serbisë për në BE.

Të merren masa për shkeljet e të drejtave të njeriut ndaj shqiptarëve që jetojnë në Serbi, Mal të Zi, Maqedoni dhe Greqi. Ne kërkojmë që Kombet e Bashkuara të krijojnë një mandat për të drejtat e njeriut, për të mbrojtur shqiptarët etnik në këto territore. Të zbatohet Marrveshja e Ohrit (2001), ku shqiptarët etnik të mos trajtohen si qytetarë të dorës së dytë.

I kërkojmë Kongresit Amerikan të krijojë një projekt-ligj që ofron përkrahje financiare dhe mbështetje nevojave dhe të drejtave të shqiptarëve nëpër botë (prej 15 milion).

T'i bëhet presion qeverisë Serbe me letra, takime dhe deklarata për: (1) njohjen e pavarësisë së Kosovës; (2) Serbia të kërkojë falje publike ndaj qytetarëve të Kosovës për krimet; (3) dhe të japi dëshshpërblimet e luftës.

Kërkojmë që politika e jashtme Amerikane, si gjithmonë, të paraprijë për mbrojtjen e shqiptarëve, në bashkëpunim me BE-në dhe komunitetin ndërkombëtar. Populli shqiptar historikisht është paqësor, liridashës, që mbrojti qytetërimin Europian ndër shekuj, dhe i vetmi popull në botë që shpëtoi çdo jetë çifute nga regjimi hitlerian në Luftën e II Botërore; sot ky popull shtypet dhe dhunohet.

Lutemi të plotësohen këto kërkesa, sepse janë në të mirë të stabilitetit dhe paqes në Ballkan dhe Evropë.

(*artikull i botuar)

Jeta Arbëreshe

Semestrale online di Cultura e Informazione Arbëreshe, in Italia e nel Mondo

Revistë gjashtëmujore online e Shoqatës Kulturore "Jeta Arbëreshe", Purçill / Eianina (Cs-Italia)
Drejtor përgjegjës / Direttore responsabile**: Agostino Giordano**
Drejtorí, Redaksí e Administratë / Direzione, Redazione, Amministrazione: via G.Marconi,30 – 87010 Eianina-Purçill (Cs-Italia)
Tel. (+39) 0981-32539 / e-mail: jetarbreshe@libero.it
sito internet - http:/digilander.libero.it/jetarbreshe
Për të jipen dhurata / Per eventuali Donazioni in denaro: Iban IT 22 H 07062 70850 000000116918, intestato a: Associazione Culturale "Jeta Arbëreshe" – 87010 Eianina/Purçill (Cs-Italia)
Regjistrim / Registrazione: Tribunale di Castrovillari (Cs), nr.4/2001 del 28-12-2001
Artikuj, Dorëshkrime e Fotografí, edhe ndëse s'botohen, nëng priren prapë /Articoli, Manoscritti e Foto, anche se non pubblicati, non si restituiscono
Drejtoria nëng është përgjegjëse për përmbajtjen dhe formën e artikujvet të nënshkruar / La Direzione non è responsabile del contenuto e della forma degli articoli firmati
Gjithë të drejtat të rezervuara / Tutti i diritti riservati

Si e mbajin mend don Andonin, Allimarr

Italo Costante Fortino
"Instituti Orientale" i Napolit, ka Shën Bendhiti (Cs)

Zoti don Andoni bëri priftin Allimarr çë nga viti 1959, e gjithë gjindja e mban mend adhe sod, sikurse qe dje çë qe trasferirtur më parë Shën Sofi (1980) e pra Çivit (1986), ku është adhe sod. Jetrën ditë vajta Allimarr sa të gjënja një gjirì çë nëng shihnja ka dica muaj e diskursi vate ra mbi Don Andonin ture më thënë se Don Andoni Allimarr mbeti mirë, se nëng kish të kish ikur, se kish bërë shumë shurbise të mira, se dij e rrij ndë mest gjindjes, dij e rrij ndë barr e ndë kandinë, si ndë shpitë e gjindjes, si ndë qishë, se kish bërë adiritura një qish të re mbi Qana, se ture bërë atë qishë i kish dhënë të shurbenjin gjindjes e gjithë katundit…; se… ndë fund, tha ky gjiri, ndëç gjithë zotrat tonë ishin si ai, Eparkia sod ish më e mirë! E pra fërnoi ture thënë kështu: "U rri i vetëm të shpia ime. Ime shoqe diqi vjet. Tim bij, - tre kam, - janë të tre - ndë Xhermanie. Ndëç Don Andoni ish adhe këtu më bëj pjaxhir se vij e më gjëj, bëjim një partit me karta e pijim një qelq verë nga më të mirët çë kam. Kam vurtet nostalxhi nga kumbanjia çë më bëj Don Andoni, pse ture bërë një partitë me karta e ture pirë atë qelq verë më thoj shumë shurbise çë u nëng dinja. Bën e njoha Parrajsin, Pisën (këtë veramendi e njihnja) e bën e njoha edhe Zotin Krisht ".

Don Liu – kështu e thërritij gjithë gjindja e Allimarrit, jo se ish prift po se kish qënë i një familje të bëgat çë pra kish bjerrë gjithsej e kish ratë ndë truall, po titullin "Don" e kish mbajtur – mbeti e penxoi një cik e pra tha: "Don Andoni, pra, më hapu trutë. U më parë se të njihnja Don Andonin nëng kishnja vatur mai ndë qishë përçë thonja se nëng kishnja mot të lëbirnja. Po kur çë bën e stistin qishën e re mbi Qana ndiejta se trutë m'u ndërruan diel pas dielje: një herë venja se më dukej një qishë e bukur, nj'etër herë se gjënja ca miqë e bëjim një qaqerjat, ndonj'etër herë adhe përçë përpiqeshnja me Don Andonin e thojim kaq shurbise çë më ngitin zëmrën. Nani çë erdhi Zoti i ri Don Nikolla Miraku u ndë meshë vete nga të diel e kur shoh Zot Nikollën më duket se shoh Don Andonin". Një emocionë e madhe i kish marr zëmrën e i shkëlqejin sytë e gjalla.

Nj'ëtër ditë ishnja te kroi Bitër, jo shumë largu nga shpia e Don Liut e përpoqa Menën, një grua çë bëj mjeshtrën ndë azilin. Si më pa më tha sa të hynja te shpia e saj, atje ndanë, se më bëj kafeun. Ture pitur kafeun e ture bredhur me Bekun, të birin çë rrij e bridhij me Pley Steshionin, Mena kujtoj kur ish e re e kur të shtunën vej te shpia e Zotit sa të bëjin prova për të mbësuar meshën arbëreshe. Ishin ndonjë dymbëdhjet trima e kopile e të parat herë neng i përqej fare të ndërrojin këngët greke, çë xha dijin, me ato arbërshe, çë kit mbësojin e mëngu njihin alfabetin arbëresh. Ishin gjithë konvinte se mesha greke ish më e bukur se ajo arbëreshe e se voka greke ish më armonioze se ajo arbëreshe. Ish edhe njeri çë thoj se kapirin më shumë fjalët greke se ato arbëreshe.

"Don Andoni, tha Mena, pat të dersij tre kumisha sa të bën e kapirim se, për esemb, fjalën "eleison" nëng e kapirij vërtet mosnjeri, mendri fjalën "lipisi" dica e kapirin të tërë e dica tjerë sa pak kapirin rrënjën "lip". Mena, pra, vate mori librin e meshës e më buthtoi se nani ajo di edhe të djovasinj arbëreshin, pse një herë Don Andoni i dha një foljèt me alfabetin arbëresh çë prevesur Dhimitri Emmanuelli kish stambartur te rivista "Katundi jonë". Ju përgjegja u e i thash se vurtet rivista thërritet "Katundi ynë" e jo "Katundi jonë", nëmos mund të ofendiret Dhimitri se i shtrëmbojim titullin e rivistës. Ajo me një cik nxirr tha: "Beh! Nani mos esaxherar, zoti prevesù -, se nga katund ka të mbanj fjalët çë di, pra, Çivit le të thonë "ynë" e Allimar bën e thomë "jonë", se nëng i bëjim dëm mosnjeriu". M'erdhi ndë tru se nëng kishnja bërë mirë t'e korrexhirnja e i thash se ish vërtet si thoj ajo e për veshin e allimarrizët fjala "jonë" kuptohej si fjala çë thamë më parë "lipisi" dhe fjala "ynë" nëng kuptohej si nëng kuptohej fjala greke "eleison". E Mena qeshi me hare!

Kishim fërnuar të pijim kafeun kur erdhi i nali i Menës, Mikuci, një pjak i shëndoshtë, i gjallë e, më dukej një cik filozof nga ato pak fjalë çë tha. Sa na dha të falat zu e hiri ndë diskurs edhe ai me fjalë të matura e serje, po edhe çë na jipin një cik hare e bën e mbajim buzën mbë gaz. Kur mori vesh se ishim e fjitim për Don Andonit pati shumë hare e zu e tha: "Zotrote më permetin të thom edhe u gjë për Zotin tonë, Don Andonin, çë na shurbeu e na nderoi për më shumë se 20 vjet. Jam shumë kutiend të fjas për Don Andonin përçë kur ish këtu rrij ngaherë ndë mest gjindjes e kish na 'virtù' çë pak zotëra kanë. Don Andoni është një

Si e mbajin mend don Andonin...

njeri çë u, per sa di u, mund t'e rasomiljonj me Sokratin përçë ka virtutën çë kish Sokrati". E këtu mbeti qet e nëng tha më një fjalë ture na lënë me ngullìn të dijim cila ish virtuta e Sokratit. E e mbesa, Mena, i lipu: "Nanù, spiegaru më mirë, nani ka të na e thuash cila është kjo virtutë, përçë na e dimë se Don Andoni kish shumë virtù, po virtutën e Sokratit u, vurtet, nëng di cila është". Nanuc Mikuci, drodhi një cik musteqet, ruajti një cik shtrëmbur të mbesën, më bëri sythin mua e zu e tha: "Don Andoni nëng shaj maj mosnjeri, e thoj se nganjeri ka të jetë ai çë është, ka të njoh veten e ka të jetë si i llurtmi i katundit. Kur Don Andoni thoj këto fjalë, mua - thoj Mikuci - më bijin ndë vesh fjalët çë ndonjë herë kishnja gjegjur ndë qishë. Don Andoni ato fjalë jo vetëm i thoj, po i gjëllij çdo ditë me një sempliçität çë na ngitij zëmrën e trutë. Sod Zotrat tona kish t'ishin gjithë kështu: kish të xheshin sopranën e mandjelin me bisht e ka të vëjin të veshurat e çdoditje. E vutë re atë çë është e bën Papa Frangjisku? Vete i veshur si një zot i thjeshtë, nëng do apartamende lusuoze, thotë se zotrat ka të dalin nga qishat e ka të dinë e i thonë një fjalë të mirë gjithëve. Më duket se Papa Frangjisku – pa e ditur e pa e thënë – është e sillet – pa shih një cik – propiu si Don Andoni. Po nëng dua të thom se Papa Frangjisku kopiarti Don Andonin, po dua të thom vetëm se të dy – ec e mos e thuaj – kanë djovasur një libër çë i tha si ka të sillen. E ndëç e mbanj mend ky libër thërritet Vangjeli".

Këtu ju përgjegj Mena e i tha: "E theve vurtet mirë: u jam e e djovasinj këtë libër te gjuha jonë. Shih e kam këtu, ruaj e tradhuçirti arbërisht Zoti Emanuel Xhordani, ai zot i mirë nga Purçilli, propju te gjuha jonë. Është e më përqen vasà, pse Vangjeli thotë se gjithë gjindja kish të gjëllij si gjëllijim na këtu Allimarr: të thjeshtë, një cik të nëmur, me pak sollde, po me shumë miq. E kur mundim e kur na e ka ënda vemë edhe ndë qishë, sa të gjegjim e këndojim fjalën e Tin Zoti".

U gjegjnja e gjegjnja e më rritej harea për ato fjalë të mira e të bukura çë thojin. Qe për mua më mirë se predhika çë të diel gjegjinj ndë meshë, përçë ato ishin fjalë çë i dilin nga zëmra, ishin fjalë çë ata gjëllijin ditë për ditë: m'u duk se ishnja përpara dy të krështerë të shëjtë.

Kur Mena fërnoi frazën "sa të gjegjim e këndojim fjalën e Tin Zoti", u alla shehura vura dorën ndë kushall, shuajta rexhistratorin e vogël çë kishnja shehur ndë kushall e me nanuc Mikucin pitim një qelq verë për shëndetin tonë, të Don Andonit e të Papë Frangjiiskut.

ArbFestival dhe Kulturë 2014-16

I menduar ka ***Italo Elmo*** (drejtor organizativ) e ***Pino Cacozza*** (drejtor artistik) - me ndihmën e *Folk Studio Festival* (Lino Luzzi, Simona De Angelis e Rose Marie Surace) e të *Arbitalia*-s -, u hap

ArbFestival dhe Kulturë 2014-2016

(Kuvende Studimesh dhe Shfaqje)

Të parët dy Kuvende të programuar: **të diel 28 shëndrè 2014 dhe të diel 18 janar 2015**, mbi temën:
"**Folklor i gjallë, Folklor i riprodhuar**",
tek Salla e Qendrës Polifunxionale të Bashkisë së Shën Benedhitit, çë gjëndet te fracjona e saj, MARRI, te hera 16.00. Me Çmimin "Morea" për Folklorin e gjallë dhe Folklorin e riprodhuar.

I trejti takim kulturor i ArbFestival-it do të mbahet **ndë fjavar/shkurt 2015**, me titull:
"Arberia International Ethnografic Film Festival",
me Çmimin Ndërkombëtar "Morea" për më të mirin Film Etnografik Kombëtar i bënur e i xhirartur nd'Arbërì.

I katërti takim kulturor do të mbahet **ndë maj 2015,** me këtë titull:
"**Fjalët e zëmrës, Fjalët e artit**",
me Çmimin Ndërkombëtar "Morea" për Letërsinë Arbro/Shqiptare.

I pesti takim kulturor **ndë theristì/qershor 2015**, mbi këtë temë:
"Nusja dhe shoqet e saj",
me Çmimin Ndërkombëtar "Morea" për më të mirin ripropozim të cerimonisë së vjetër martesore nd'Arbërì

Tek e para pjesë e Kuvendit ("**Folklor i gjallë** - Folklor i riprodhuar"), ç'u mba ditën 28 shëndrè 2014, Shën Benedhit, bëri koordinatorin *Pino Cacozza;* muartin pjesë e foltin: kryetarja e Shën Benedhitit *Rosaria Amalia Capparelli*, Peshkopi *Donato Oliverio*, Ambasadori i Shqipërisë *Neritan Ceka*; *Italo Elmo; Nikola Dimitri Bellucci,* filolog; *Innocenzo De Gaudio, Antonio Gattabria*, *Oliver Gerlach,* etnomuzikologë; *Jessica Novello, Rose Marie Surace e Vincenzo Straticò,* drejtorë Grupesh Vjershtarësh. Pas Kuvendit kënduan vjershe popullorë dica pjesëtarë të këtyre Grupeve: "*Shpirti Arbëresh"* të Qanës, "*Moti i Parë*" të Ungrës dhe "*grupi i Vjershtarëvet"* të Shën Benedhitit.

Tek e dijta pjesë e Kuvendit ("Folklor i gjallë - **Folklor i riprodhuar**"), çë do të mbahet **të dielën 18 janar 2015**, Shën Benedhit, do t'bënjë koordinatoren *Simona De Angelis* (referent management culturale Arbfestival and Culture) e do të marrën pjesë: *Gennaro De Cicco,* anëtar i Shoqatës Kulturore "Festival Canzone Arbëreshe - Comitato Storico"; *Graziella Di Ciancio*, eksperte në valle etnike; *Ernesto Iannuzzi,* kantautor; *Angela Iusi*, kryetare e grupit folk Shqiponjat; *Marco Moccia,* kompozitor e këngëtar solist; *Lello Pagliaro,* kompozitor i C.M.A-së (Cooperativa Musicale Arbëreshe); *Peppa Marriti Band,* grup rok arbëresh; *Marco Sabato,* kompozitor e këngëtar solist; *Spasulati Band,* grup muzikor; *Ivia Tavolaro,* drejtore artistike e "Grupit Folk Ullania". Punimet e Kuvendit do t'i hapënj *Pino Cacozza,* poet/kantautor.
Kur mbarojën gjithë fjalimet, do të paraqitet një audio-video e-book: "I tesori della Cooperativa Musicale Arbëreshe".

Për gjithë ata çë do të dinë më shumë për **ArbFestival dhe Kulturë 2014-2016** mund t'informohen këtu:

Cultural referents:
Folk Studio Festival: A.L.Luzzi (320-4856527), S.De Angelis (328-6443300), R.M.Surace (349-5559219)

XXII Shfaqje Kulturore-Folk për vlerësimin e Pakicavet Etnike

(Garrafë, 30 maj 2015)

Shfaqja XXII, e organizuar ka Instituti Mbledhës "G.Sabatini"-Borgia (Cz), - me ndihmën e Bashkisë së Garrafës dhe të Shoqatës Kulturore "Progetto Caraffa"(drejtuese Cettina Mazzei) - do të mbahet ditën 30 maj 2015 e do të ketë këtë temë: "**Historia jemi na**". Kuvendi është i programuar për herën 10,30, ndërsa Shfaqja Folkloristike do të mbahet tek hera 16,30.

Gjithë Shkollat Arbëreshe të interesuara kësaj Shfàqjeje, kanë dërgojën Kërkesën e Pjesëmarrjes mbrënda ditës 16 janar 2015, sipas këtij skemi:

Kërkesë Pjesëmarrjeje / Domanda di Adesione

Institutit Mbledhës të Borgia (Cz) / *All'Istituto Comprensivo di Borgia (Cz)*
(Skolla e Garrafës / *Scuola di Caraffa)*
email: czic839008@istruzione.it

Prot.n° _____ i ditës / *del* _____

Instituti Mbledhës Shtetëror i / *L'Istituto Comprensivo Statale di*

_____

udha / *Via*_____ Tel./Faks_____

do të marrë pjesë te "XXII Shfaqje Kulturore-Folkloristike për Vlerësimin e Pakicavet Etnike", e organizuar për ditën 30 maj 2015, tue pranuar format e treguara tek Rregullorja dhe zgjeth si përgjegjës të Skollës / *aderisce alla "XXII Rassegna Culturale-Folkloristica per la Valorizzazione delle Minoranze Etniche" indetta per il 30 maggio 2015, accettando le modalità indicate nel regolamento e designa quale referente della scuola*

_____-

mësuesin/mësuesen - *il/la docente* _____

Tel / e-mail _____

Drejtuesi i Shkollës / *Il Dirigente Scolastico*

_____

Te kjo Shfaqje mund marrën pjesë studentët e Shkollavet të Katundevet Arbëreshë, si edhe të tjerave Pakica Etnike Historike të Italisë. Edicjona XXII përmban: 1) një Kërkim-Konkurs; 2) një Kuvend Studimesh; 3) një Shfaqje Folkloristike. Nga Skollë ka të shkruanj një rrëfim dygjuhësh mbi këtë temë: "Historia jemi na", ku mund t'folet mbi vendin ku rrohet, si rrohet, çë kur rrohet; mbi fakte, personaxhe e kuriozitete te katundit.

Ky Rrëfim dygjuhësh
(bashkë me të tjerë shërbime artistikë e dokumente)
do dërguar mbrënda ditës 20-4-2015

Për Info: thërritni shpejt prof.shën Cettina Mazzei / email: mazzei.cettina@alice.it

Thuame ti, ku ishe...

Motimadh/Miracco Mario Giuseppe
ka Shën Sofia (Cs)

Ku ishe, kur përrallzit rrëfihçin tundu tundu vatres?
Ku ishe, kur gjitònia zëj e mirr dìallin e paraveres?
Ku ishe, kur pjaka e vajza, ka udha kroj, prisin kuken ç'i këndonij?
Pjaka lìpnij qet qet: "sa vjet më je' mua kjo jetë";
vashza me vuxhë të hollë, i thoj: "sa vjet dhëndrri të më martonjë".
Ku ishe, kur Njolla dhënderr këndonij Karmellinen nuse:
"E bukur si je ti nëng ësht ndonjèter,
ne Maq ne Vakaric, mëngu Shën Miter;
doja të bëghça mjeshter të t'mirrja meter.
e sherbëtor per tij u dua të shitem"?
Ku ishe, kur lalë Llixhi vëj kusìn nën suportit sa t'vrit kuralin - pse ai derkut i sërrit kural, se thoj se ai ishë rrëkica shpis, e 'derk' ish ëmer turpje -
tue kënduar: "Saucìca si dubica,
supsàta si gobaçe, ndula si kërsula,
hjiromeret si e doni,
te lalë Llixhi veni e çoni"?
Ku ishe, kur lalë Xhuzepa, kusturìar i madh, te ruga ndokndeles i këndonij një vjersh kunder nuses ç'i kish nxjerr çinëmrin 'gjon':
"Shal trasha e faqe guduruni
më ndrrove ëmërin e m'e vure gjoni:
kam të rrëmbenj te një spunduni
kam të puthinj e pra të t'dërgonj"?
Ku ishe, kur Anxhullmaria Bulari Shkaramàu, ngrënij qelqin te triesa e bënij trushenje, çë dhe sot ven për ndominàt:
"Ajri ngrin vorenë si bor mali,
e vera e mir vjen ka muskatjeli,
shkëlqen si bërllandi te krëstalli,
kurmin t'e ndrashen si rrësheli;
fjalë bi t'bëç sa papagàli,
e, kur e pì, bin e krëcèç si gjeli;
vera ë mir kur di e e pi,
e të fala gjithë kësaj miqëri!"?
Ku ishe, kur lalë Kandrani këndonij këngen bilëve:
"Ndoni, gjùsi gjoni, nga manat na tartanonij,
pra kallarej ka hjima e bi t'losej buracìna;
Rina, gjùsi zhgjeta, mbjedh ullinj pa fjeta;
Lluxhi, si gambiell, rri ngaher nd'at ullì vjerrë;
Kunxullata, si llugrua, gjithë panaret vë sarua"?
Ku ishe, kur Pedhikuni i bënij këngen Marianines:
"Sa e bukur Marianina se na vu kpucët të fina,
pra na veshi at xhipun e te praku atij purtun,
kur kikriki këndon gjeli Marianina te kanxheli,
ngrën lesht me llavur, bën një pordhë e ghin ndë shpi"?
Vëlla, s'ka t'e ndìeç ndë këta vjersh s'i gjegje me vesht tënde, të rrëfijtur ka një pjak me at buzëqeshur e at mall i vjeter çi shkëlkenjen sit, një kocë i vëghet te gola e di lot i dalin ndër sì.
Vëlla, ku ishe?

Finja

Carmine Stamile
ka Shën Japku (Cs)

Sod ndë gjithë shpit është llavatriçja çë lanë mbrojat llordu, po një herë si bëjin? Një herë tek shpit e tona nëng ish kroi çë sill ujë, nëng ish sapun si piuhur o i lëngëshëm si është nani e kur gruaja ki të laj mbrojat ish një probëllem i madh e një llavur shumë i rënd pëse ki të bëj finjën. Finja bëhej kështu: gruaja mbidh mbrojat llordu e vej tek kroi i katundit o ndë lum e i làgij e, ndëse kish ndonjë cik sapun shpije, i fërkoj. Pra vei ndë shpi, mirr kullaturin, një dërrasë e madhe e tundu e e vëj mbi dì kavaljete. Mbi kullatur vëj një shportë e madhe e mbrënda ndë shport shtroj gjithë mbrojat. Pra mirr kusin e madhe e e vëj mbi zjarr e e mbjoj me ujë. Ndë ujë vëj një katë me hi e bin e ziej. Kur ujët zihej bëhej llisi pse kish hit përmbrënda. Kur llisia ish gati, gruaja e mirr me pishatur e pakë e pakë e hollë e hollë e shtij gjithë mbi mbrojat çë ishin ndë shportë e bin e rrij sa të stohej. Tek jetra ditë gruaja ngrakoj shportën me mbroja e vej ndë lum sa të i laj: o bëj vapë o bëj tëtim, o ish moti i mirë o bij shi. Gruaja, pas çë laj mbrojat , i ndëj e bin e shutershin ndëse moti ish i mirë. Po ndëse moti ish vrëjtur e dielli nëng ish, i qellij të lagta ndë shpi e i shuterij afër zjarrit. Sa llavùr bëhej një herë!

IL BUCATO - Oggi in tutte le case c'è la lavatrice che lava i panni sporchi, ma una volta come facevano? Una volta nelle nostre case non c'era la fontana con l'acqua corrente, non c'era sapone in polvere o liquido come c'è adesso e quando la donna doveva lavare i panni doveva lavorare molto perché doveva fare il bucato a mano. Il bucato a mano si faceva così: la donna raccoglieva i panni sporchi e andava alla fontana del paese o al fiume e li bagnava e li strofinava con sapone di casa. Poi andava a casa, prendeva una tavola grande e rotonda, detta colatoio e la metteva su due cavalletti. Sopra il colatoio metteva una sporta grande e dentro la sporta sistemava tutti i panni. Poi prendeva una caldaia grande e la metteva sul fuoco e la riempiva di acqua. Nell'acqua versava un secchio di cenere e lo faceva bollire. Quando l'acqua bolliva insieme alla cenere si trasformava in liscivia. Quando la liscivia era pronta, la donna, la prendeva con l'orinale e un poco alla volta e piano piano la versava sui panni che erano dentro la sporta e la lasciava raffreddare. Il giorno dopo la donna caricava sulle spalle la sporta con i panni e andava al fiume per lavarli: o faceva caldo o faceva freddo, o c'era bel tempo o pioveva. La donna, dopo aver lavato i panni, li stendeva per farli asciugare, se c'era bel tempo. Ma se il cielo era nuvoloso e il sole non c'era, li portava bagnati a casa e li asciugava vicino al fuoco. Quanto lavoro si faceva una volta!

Me verë rron di herë

(e shkruar ka) **Gregorio Talò**
ka Shën Marcani (Ta)

Me verë rron di herë

Rit. Nga dita ka të kundomi
ta pirë një qerqë verë:
ki ishtë katundi joni,
katundi ku kimi lerë

Nuni Sepi ìti i lik
e u vuri nxitu ta pirë;
hàvi: ”Vera mua më ndih,
kushtu vet ièse mirë”

Rit. Nga dita ka të kundomi …

Kur shpie mushku jasht
nëng do fare të shurbei:
pinë verë e hanë kasht
e posht lis do vei e flei.

Rit. Nga dita ka të kundomi …

Më havi një herë tata
se gjith imi mjeshtrë
të mblomi vera kënata
e jo të punomi vreshtë.

Rit. Nga dita ka të kundomi …

Kur shumë më vjen etje
pinj vera pas pas:
jes mirë me shëndetje
e ndihcm si mbra parràs.

Rit. Nga dita ka të kundomi …

Çë duani të rroni shumë,
‘dìenie njetrë herë:
kur hani mirrni gjumë
e ndërrìni të pini verë.

Con il vino si vive due volte

Rit.: Ogni giorno dobbiamo cantare
bevendo un bicchiere di vino:
questo è il nostro paese,
il paese dove siamo nati.

Nonno Seppu stava male
e si mise subito a bere;
disse: “ Il vino a me mi aiuta,
solo così io sto bene”.

Rit.: Ogni giorno dobbiamo cantare....

Quando porto il mulo in campagna
non vuol per niente lavorare
beve vino e mangia la paglia
e sotto l’albero vuol andare a dormire

Rit.: Ogni giorno dobbiamo cantare....

Mi disse un giorno mio padre
che tutti siamo maestri
di riempire di vino la brocca
e non di lavorare le vigne.

Rit.: Ogni giorno dobbiamo cantare....

Quando troppo mi viene sete
bevo il vino passo passo:
sto bene con salute
e mi sento come in paradiso.

Rit.: Ogni giorno dobbiamo cantare....

Se volete vivere a lungo
sentitelo un’altra volta:
quando mangiate prendete sonno
e sognate di bere vino.

www. agm.calabria.it

Kostandini e ‘Urëndina

(Rrëfiar ka a zeza Maddalena Brunetti, pllatanjote, nj’ qind e nj’ vit)

(mbloth) **Kostandin Bellushi**
ka Pllatni (Cs)

Ish një grua e kish nënd bilë e i martoi gjithë me forestjera (t’huaja). Qo grua qindroi vetëm, qo e a bila. I vat nj’ forestjer (një i huaj) andi llargu e a doj t’ bilan; qo i vata pas (forestjerit) e a jëma nëng doj t’ a martoni t’ bilan e thoj se, poç u kishan martuar gjithë bilt, i kishan marr gjith forestjerë (t’huaj) e ni i jip dhe t’ bilan nj’ forestieri (një i huaj) e ajo qindroni vetam?

- “Jipja, martoja e nxira të t’ bil se u bë plak”, i thoj i biri (Kostandini).

-“Nëng a nxiar”! (thoj a jëma). Ajo nëng doj t’i jip forestierin (t’huajn) e Kostandini a kuraxhoj (a pasaudhirti) e ajo thoj:

“U nëng a qell llargu t’ima bilë se ndër bizonjat e t’ima kur t’a dua nëng a kam”. E ai i prometirti (taksi) se vej e a mirr e i tha:

“Kur t’a duash veta u e t’a marr”.

Psana ai vdiq, qo klanej e thoj:

“Kostandini biri im qo ë besa çë m’ dhe? Besa jota ë nën dhe! Të t’motar a kam llargu e nëng a shok”!. Ki, nëmos se ish i vdekur, mbajti fjalan e vata te katundi ç’ish a motra me nj’ kal e vata tek bëjan vallat, se qo vej vallvat (pe se nd’ katund thomi: “Vet si ‘Urëndina vallvat?). E vata tek a para valla: “Ju mos pat’tit ‘Urëndinan”?

“Ësht tek a dita vall”, i than. Vat tek a ditë:

“Ju mos pat’tit ‘Urëndinan”?

” Vat tek a treta vall”…

Vat e a gjet tek a pesta vall, e i tha:

“Ke t’vish me mua se t’ do mëma”.

A muar, hiptin te kali; ajo hipi vitha e ai m’ samar. I vrenij e a shik t’ vargarist tek misht pluhuruar. A kapirti (U ardinua) se nëng a kish gjustu (t’dret) misht, se a jëma s’ja kish thën (asaj) se kish vdekur Kostandini. E tue tirartur i piani:

“Kostandini, vllathi im, nj’ sinjall (nj’ shëngj) i keq t’ shok”.

- ’Urëndina, motra ima, ç’ësht ki sinjall (ki shëngj) çë m’ shek?”. I vreni ka xerku:

“Veshzit tënd jan t’pluhuruar”;

- ë pluhurthit e dheut, ë vapa!

- Kostandini vllathi im nj’ sinjall (nj’ shëngj) i keq t’ shok. “Çë m’ shek?”.

- Duarzit tënda jan t’thata”. E ai i thoj: “Ësht f’tiga çë m’ vret!”.

- Kostandini vllathi im nj’ sinjall (nj’ shëngj) i keq t’

COSTANTINO E JURENDINA - (narrata dalla defunta Brunetti Maddalena, platacese, anni 101) -

C’era una donna che aveva nove figli e li sposò tutti con delle straniere. Questa donna rimase sola, lei e l’unica figlia. Si presentò a lei un altro forestiero chiedendo la mano della figlia, ma la mamma non voleva maritarla dicendo che già aveva sposato tutti gli altri figli con delle forestiere e ora mica poteva dare la figlia ad un altro forestiere e rimanere da sola?

“Concedila, sposala e toglila tua figlia che è già matura”, le diceva il figlio.

“Non acconsento”, diceva la mamma. Lei non voleva darla in isposa a uno straniero. Costantino la incoraggiava e lei gli diceva:

“Io non la mando lontano mia figlia perché, se dovessi avere bisogno di lei, io non ce l’ho vicina”. E lui (Costantino) le promise che se lei avesse avuto bisogno di sua figlia lui sarebbe andato a prendergliela. Poi lui morì e la mamma lo piangeva dicendo:

“Costantino, figlio mio, dov’è la promessa (parola data) che mi hai fatto? La tua promessa è sottoterra con te: “Tua sorella è lontana da me e non la vedo”.

Costui, pur essendo defunto, mantenne la promessa (parola data) e andò, con un cavallo, nel paese dove si trovava la sorella, cercandola tra le danze, perché lei era una danzatrice/ballerina (in paese c’è anche il detto: “Vai come Jurendina delle danze/ridde/vallje”). Lui andò a cercarla nella prima vallja, chiedendo:

“Mica avete visto Jurendina?”. Gli risposero:

“È nella seconda vallja”. Di nuovo chiese:

“Avete mica visto Jurendina?”. Gli risposero:

“È nella terza vallja” e cosi via… Finalmente la trovò nella quinta vallja e le disse:

“Devi venire con me, ché ti vuole mamma”.

La prese con sé, salirono a cavallo, lui sulla sella e lei dietro. Lei lo osservava e vedeva la sua carne consumata, quasi polverizzata. Comprese che ciò che vedeva non era normale, anche perché la madre non le aveva detto che Costantino era morto. Lungo il cammino gli chiedeva:

“Costantino, fratello mio, noto in te un aspetto pietoso”.

- Jurendina, sorella mia, cosa noti in me?

Osservandolo sul collo, gli disse:

- “Le tue orecchie sono consunte”;

- E’ polvere di terra, è il caldo! - rispose

- Costantino, fratello mio, noto in te un aspetto pietoso. -

- Cos’è quel segno che noti in me?

- Le tue mani sono rinsecchite/disidratate;

- È il lavoro che mi consuma;

Kostandini e 'Urëndina

shok.
- Ç'ësht ki sinjall (ki shëngj) çë m' shek?
- Lesht e tënd i ke gjithë t'shkatarruar.
- Kle ajri…
Ngaherë ç' qo i piani ç' kish patur ai nàni i shtij nj' kazjun e nàni i shtij njetar… e ashtù njera ç' van nd' katund. Van te katundi e shkuan te dera klishës… "'Urëndina motra imë ti ec te mëma se u veta mb' klishë, falinj e psana vinj".
Ai vat e hiri m'klishë e s'duall më, ajo vata nd' shpit. Gjet t'jëman ç' klani tek glutha saj e a jëma i tha: "Kush je"?
- Hap deran, mëmë!
- Kush je?
- Jam Urëndina.
- Kush t'suall?
- Erdh Kostandini e m' muar.
Ajo thë: "Ah Kostandini biri im ku ë besa çë m' dhe, besa jota ë nën dhe"!
- 'Urëndinan m'a solla, po ti nëng erdha më, po vajta m'klisha e fala.
(E ahìarthin ja tha 'Urëndin's se kish vdekur i vllau).

- Costantino, fratello mio, noto in te un aspetto pietoso.
- Cos'è quel segno che noti in me?
- I tuoi capelli sono tutti arruffati
- È stato il vento…
Ogni volta che costei gli chiedeva cosa gli fosse successo, lui le trovava una scusa… E così finché non giunsero in paese. Arrivati in paese passarono davanti alla chiesa…
- Jurendina, sorella mia, tu vai da mamma, ché io vado in chiesa a ringraziare (il Signore) e poi ti raggiungo.
Lui entrò in chiesa e non ne uscì più; lei, invece, andò a casa della mamma. Trovò la madre che piangeva nella sua lingua. E la madre disse:
"Chi sei?"
- Aprimi la porta, mamma!
- Chi sei?
- Sono Jurendina.
- Chi ti ha portato?
- È venuto a prendermi Costantino.
Lei disse:
"Ah, Costantino, figlio mio, dov'è la parola che mi ha dato? La tua parola è sottoterra? Mi hai portato Jurendina, ma tu non sei tornato. Sei andato in chiesa a rendere grazie… ".
(E solo allora la mamma disse a Jurendina che suo fratello era morto).

Anita Markut, vjershtare

Anna Blaiotta
(ka Purçilli (Cs) /1919-2010)

Kënkez mbi motet ç'jem e shkomi

Jemi ndër nj'mil nëndqind shtatdhjet e tri
e u varesa u të rri
mbi këtjet ç'ë shum e shtrëmbur:
t'rreme e t'liga jan pa ëmer.
Kan turres sa më të duash,
kòmte kan sa s'kan të rrfier;
ma s'jan kutjend e rrin mushu
sikuna kan djallin te mushku!
Gjegjmni mua ç'ju mangon:
tek gjella ju mangon Inzot:
s'kini diellin ç'ju bën drit
t'ju dertonj juve at shpirt.
Popo ç'jan e vijen kto dit,
se bie kmbora e s'bëjen kriq;
e ndir t'diellat s'ven mbë qish
po kullurirjen buz e sit !
Ma kur t'i vinjë bzònja tire,
mbjatu ka Inzot priren:
lipjen luft t'i ndlenj
e t'i ruanj bashk me t'tjer.
Inzot, si tat i math,
dit për dit i je' t'han:
m'i je' diellin të m'i ngrohenj,
m'i je' mbsimet të m'e njohen!
Na, ç'besen e kemi t'fort
edhe lutemi Tënzot,
mos 'vijen më motra t'liq,
t'mos t'e bjermi na këtshpirt.
Si kem rrimi mir na pjeq
ç'shohmi gjindjen pa rrspjet:
pa rrspjet, pa lipisì,
mbi këtjet u si kam rri?
Mosnjarì të thot "Mir dit",
mosnjarì të thot "Mir mbrëma"!
Ecjen gjindjat si të marr,
sikuna buken nëng e kan!
E jan t'urt sot gjith guàllu,
ma urtsìn e vun nd'kushallet!

** Datë regjistrimi: 5-8-1973.*

Sëmundat e Shëndeta

Giuseppe Chaffitelli
ka Mashqiti (Pz)

Nanì çë u bëra plak (pleqëria isht një sëmundë: "senectus ipsa morbus est", si thon lëtirët), më vjen ndë mendë si një herë shërojan sëmundat o, më mirë, si nevra na dukij të i shërojam. Shumë sëmunda kishan emër arbëresh të fjeshti: fruthi, sinahji, kolla, ethja, uthi plënxit, lia qelbi, koklit, kula, purriq, koqëza, llavësia, ecc..Tjerat kishan emër grek o lëtir: epilessia (kumblisia), tizka, iterixja, ullçera, pullmunita, pleurita (pëndura), pendiçita ecc..; o nëng kishan emër, po na duhij një rreth fjalash që të i thërrisjam: bia tok (pika ghoça), ha kurmi, a marrë nga të rrarat, përvëlon syu, dhemb gluri, dhjet thatë, dhjet lëng, ecc… Lëmi sëmundat çë i shërojan ma mjekima (medhiçina) çë i bëj spixjalli o ma "operaciona" ta spitalli, e shohmi vetëm ato çë shërohshin ma motin e ma "ndihman" çë bëjan gratë "mazharë". "Omnia lenit tempus", si thoj një a thënie lëtirë: gjithësej shëron e zbutan moti. Kto gra i "ndihëjan" me fjala e parkalesma (racjuna), figura shejtrash, qirinj e kryqe si talismana; hërrisjan shejtra e engjël tura vënë, ku ish a keqja, një peshira argjëndi. Kur një kish koklit, vej ta shpia njëj gjitoni e thoj te dera, pë të ja lëj: "Ktu t'i lë" tre herë e ikij. Shumë të sëmura pa blerë mëdhëçina shërohshin ma tizana e dhëkote, mëllagë, kamumillë, papanj, mjerkot, verë e ëmbëlsuar ma mjalt, molla të ziar ma cukër, kataplazma e sinepime, bursa ma ujë të ngrohtë, hi të ngrohtë brënda një skamandil lidhur rreth kananoçit. Ndë një cënohij o pritij, pë të mbetij gjaku, vëj ta a prera bukzan a kallmit (salvelòksi i at'hershëm), o hit, mirimag o plëh karrarash. Nxitat (vaçinacjonat) pë sëmundat çë ngjitan i bëjan pë çë ishan urdhruar. Mbi purriqat shtrojan fleta ferrash sa ashtu hapshin më parë e dilij jasht kalbësi. "Ubi pus ibi evacua": ku isht kalbësì nga atej nxirra. Nëng blijan pomata ta spixjalli, po lyhshin ma val, lardh e të lyart derku. Për dredhjat e të çajturat ashti i ndreqij mirë cì Lena Sarçinallit. Shkuar sëmunda, i sëmuri ish ej i shëruar, po mbetij i lodhur, pa oreks e pa fuqi e kish mirrij pameta shëndeten. Nani duhij vuçìari, jo më spixjalli! Gjithë të fëmiles e parkalesjin të haj: lëng mishi e pastina, mucarele e gjizë, ca mish të pjekur, një kulaç, klumsht me cukar e mialt, dy nerënxa, molla, ca verë, një kafè e (fshehur) një sikaret. Ashtu ditëpërdita zëj fuqi, shëndet e oreks të math. Ata të fëmiles si shihjan sa haj gjithësej pa parkalesur, i nxirjan trastan e i thojen të haj e te shurbej si gjithë tjerat. I mjeri, i mësuar të bëj të sëmurin, klaj sëmunden, motin kur "rrij me mirë kur rrij me lig".

MALATTIE E SALUTE – Ora che sono vecchio (la vecchiaia è malattia, come dicono i latini), mi ricordo come una volta curavamo le malattie, o, meglio, ci sembrava di curarle. Molte malattie avevano uno schietto nome arbresh: morbillo, catarro, tosse, febbre, pirosi gastrica, pus, orticaria, ernia, pustola, foruncolo, pazzia. Altre avevano nome greco o latino: epilessia, tisi, ittero, ulcera, polmonite, pleurite, appendicite; o non avevano nome, ma occorreva indicarle con una perifrasi:apoplessia, prurito, ossessione, patofobia, artrosi del ginocchio, stitichezza, diarrea. Trascuriamo le malattie che si curano con le medicine del farmacista e con interventi in ospedale e consideriamo solo quelle che guariscono col tempo e l'"aiuto" fatto da donne fattucchiere'. Ogni cosa lenisce il tempo. Queste donne 'aiutavano' con sortilegi, giaculatorie, preghiere, figurine di santi, ceri e croci come talismani, invocazioni di santi e angeli, applicando sulla parte malata una moneta di cinque lire d'argento. Quando uno aveva l'orticaria, si recava in casa del vicino e sulla porta diceva, per lasciargliela:"Qui te la lascio" per tre volte e poi scappava. Molti malati senza comprare medicine si curavano con tisane e decotti, malve, camomille e papavero, mostocotto, vino addolcito con zucchero e miele, mele cotte e zuccherate, cataplasmi e sinopismi, borse con acqua calda, cenere calda in un fazzoletto avvolto attorno al collo. Se uno si feriva, per fermare il sangue metteva sulla ferita un fine velo che si trova all'interno delle canne (il salvelox di allora) o cenere, ragnatela o polvere di viottoli. Le vaccinazioni le facevano perchè erano obbligati. Sui foruncoli mettevano foglie di rovo perchè si aprissero subito e uscisse fuori il pus. Dove c'è pus, lì evacua. Non compravano pomate ma si ungevano con olio, lardo o sugna. Le distorsioni e le fratture le curava bene zia Lena Sarcinal. Passata la malattia, il malato era guarito ma debole, senza appetito e doveva riprendere la salute. C'era bisogno del macellaio e non del farmacista. Tutti lo pregavano di mangiare: brodo di carne e pastina, mozzarella e ricotta, carne arrostita. Taralli, latte zucchero e miele, arance, mele, vino e (di nascosto) una sigaretta. E così di giorno in giorno prendeva forza, appetito e salute. I familiari, come vedevano che mangiava tutto senza essere pregato, gli toglievano la mangiatoia e gli dicevano di mangiare e lavorare come tutti gli altri. Poveretto, abituato bene a fare il malato, rimpiangeva la malattia ed il tempo in cui "stava meglio quando stava peggio".

Maria Markut, vjershtare

(Maria Miranda / Purçill, 1918-1996)

Kënek djepje / Sime bilje

Krishti më m'e dha këtë bilez,
e rriten mëma e e bën kopilez.
Kur më erdhe te ki dhé,
m'u mbjua shpiza me haré:
sanënga ti ka jeta dolle,
nder duart mamìjes më ju shllove;
ajo, sa t'ruajti e na tha:
"Nj'vashez t'mirez Krishti ju dha!".
It at t'priti me shum amur,
mëma t'priti me shum dhullur.
Mamìeja mbjatu t'pastertoj,
i dham mbrolat e të fashqoj;
se Krishti xheshur të kriarti
ma mëma gjith t'i rrigamarti.
It at t'muar e të mbajti
e pir harè u vu e qajti;
mëma t'ruajti me hjidhì:
s't'mbajti se nëng kish fuqi;
sa të ngau e të la,
t'paren urat më t'e dha.
Pra bashk me mëmen t'vun mb'shtrat
e bëre një gjumith të gjat.
Pra bila u zgjua ture qar
e mëmza më u spamndàr.
U ngre mb'bisht e t'muar mb'dor
e te stamahji të afròj:
hapi gjin e të vu,
e bila mbjatu sisen zu.
Mëma zu e i këndoi:
thoj:"Bilez, kush të mbsoi?".
Pra erth ndrikulla e të mburllòi
e nd'ato dit të pagzoi.
Mëma kish pak qumesht te gjiri
e t'dha bukzen me val ulliri.
Pra kur muaji errù,
Mëma tek djepja të vu:
mëma shurbiset kish t'i bënej
e ndëpir shpi këndimin t'i zënej;
thoj:"Qetmu, bil, se vet nëng jé,
se ëngjllin tënd me tij e ke.
Oj bi' e oj bi',
ëngjlli tënd t'bën kumbanjì.
Sonde ke t'bësh nj'gjum të gjat:
s'ke t'qanjesh se ka t'fjër it at,
se menat ka t'ver t'shurbenj
se qunshtit s'biles ka t'ja bjenj".
Bila rritej dit pir dit
e prindit saj i qeshjen sit:
"Sprënxa mëmes nëng ka t'qanj,
se mëma skutinat ka t'ja lanj.
Qetmu mall e qetmu fat,
se nàni na mbjidhet it at".
Qanej e bila e nëng doj t'pij,
mëma ç'kish bënej nëng e dij.
Vajza ish smur e s'dij t'e thoj
e mëmza e qelli te jatroi.
"Qetmu se it at vet' e shurben
e jatrìzit më t'i bjen".
Vajza m'u shërua njenjè
e mëma e tata pjot haré.
"Oj bi' e oj bi',
mëma t'mban më se kta sì.
Ti je e vogel e s'e di,
më mir se mëma s't'do njarì.
Pra vjen hera ç'bëhe grua,
ahirna ti di e m'e thua.
It at më t'i bën shpit
e mëma më t'i bën stolìt.
Mëma e tata të marton
e Zoti Krisht të bekon.
Tata e mëma ka ti pret
vet sa t'i qellnjesh rrspjet.
Pra me mallin ka t'bësh jet
e kin gudhiri nj'milez vjet!
Oj bi' e oj bi',
drita tats e mëmes ti!
Lulurù e bën këtë mëma
nga menat edhe nga mbrëma".

* Datë regjistrimi: 20-5-1973.

Tim biri

Ti gjègjem, birith, çë t'thot mëma sot.
Tek deti vajte bëre një pasjàt:
pé nj'vashez çë për tij qe nj'ill me drit,
sa buza jote mbjatu "mall" i thrrit.
E zëmra tënde u hap si nj'arganèt
sa bilza mëmes time piç t'u ngjit.
Kur motra jote t'njohu at vullndàt,
at amiçixje vate e zu vet:
e braçarti mbjatu për kunat
me një haré të madhe si ish ai det.
Kur erdhe e m'e solle at novitàt,
hareza ime ndir qiell m'u ngjit.
T'thash: "Ki ësht një problem çë s'do ajùt
se ka t'e zgjidhenj kush ka t'bënj jet!
E u duhshi sembri mir si duhi sot,
se mëmzes tuaj i ndëndet zëmra e sìt.
Fërtùnzen ju e bekoftit Inzot
si ju e dishron ajo zëmra vet!
Garòful u lithshit t'diz te një macèt
e ju zgjithtit Krishti 'tu e nj'milez vjet"!

* Datë regjistrimi: 5-8-1973.

Nicola Mattinò

(Ungër 1914 - 1982)

Profesor letërsive klasike ndër shkollat e larta, poet, shkrimtar. Nikolla Matinò qe autor librash me poezi në gjuhë italiane (*Ritorno*, Mit, Cosenza 1965; *Musa vagabonda,* Mit, Cosenza 1970; *Parole...in versi,* 1971); autor romaxesh (*Il treno delle Calabrie*, Mit, Cosenza 1970); autor rrëfimesh (*La cartella di pezza,* Corigliano 1971); autor libresh skollje (*Sintassi del periodo italiano,* Mit, Cosenza 1960). Një intelektual me shumë kulturë e ironì ungirnjote; një burrë i lirë, çë rroi si dish, pa formalizme. Qe një ndër themeluesit e Shoqatës Kulturore Arbëreshe (Acia), (Purçill, 1972), ka duall pra rivista 'Zëri i Arbëreshvet' (1972-1982). Mbi faqet e Zërit botoi dy poezi arbërisht, çë këtu ri-botomi. **(D.)**

Nuk di *

Nuk di
ku vajta;
nuk kam
më tru.
Udha
ish
e gjatë.
E unë
veja
veja.
Nuk di
ku vete:
nuk di
ku ësht
dheu
im.
Nuk di
ku janë
miqtë
e mi.
Nuk di
ku ...
kam ' vete.
Dielli
ësht,
po
nuk
e shof.

Sot e dje **

Isha atë ditë
tek sheshi fagut:
një krua
shtynej ujë
pikë e pikë.
Kujtonja motin:
u gjënda
djalë...
Isha me mëmin
e me atin
e piva
tek ai krua.
Isha djalë
e shinja
një jetë të mirë
Tashti...
jam burrë i madh
e pé
jetin e ligë.
E shof gjithmonë
të ligë
e qanj pir mua
e pir gjithë.

* *Zëri i Arbëreshvet, 1972/1, faqe 15;*
** *Zëri i Arbëreshvet, 1972/2-3, faqe 17.*

Vincenzo Golletti Baffa

(Çivit 1924 -Heidelberg 2009)

Flavia D'Agostino
ka Çifti (Cs)

Një arbëresh ka Çifti

Më 16 të muajit të prillit 2009 vdis një nga vuxhat më të shquara të Arbërisë, prof. Viçenx Golletti Baffa: kish tetëdhjetepesë vjet. U le Çivit më 28 të gushtit 1924. Laureat në historì dhe filosofì, shkoj ndë Xhermaniet, ku mbësoj, në Francoforte, Filosofi e Historì. Autor me kulturë të madhe, krijues, mbajti të gjallë marrëdhëniet me jetën shqiptare, jo vetëm me bashkëpunimin aktiv me rivista të Shqiperisë dhe Arbërisë, po mësegjithë me botimet periodikë dhe libra, finalizuar për mësimin më të lehtë të gjuhës. Njera ndër vitet '70 u mba llargu ka arbërishtja, pra u bë më i çelur mbështetës i gjuhës arbëreshe. Kontributi çë i dha Arberisë kle i shquar; shkruajti artikul për 30 vjet. Krijoj një stil të tij çë dhezi kuriozitet dhe vlerësim për të shumtat vepra çë botoj, ture përdorur një gjuhë të thjeshtë e kuptueshme për të gjithë, edhe për ata çë nëng djovasjin arbërishtin dhe shqipen.Storjet e tij - të zbuluara gjithmonë, të frymëzuara ka fakte të verteta dhe me gjindë të njohura, jo vetëm të Arbërisë po edhe të katundit tij - ngjalltin kuriozitetin dhe interesin: përfaqësojën një arbërishte klasike, çë ish e folmja çivitjote përziar me pak fjalë shqipe. Çë ka viti 1974 bashkëpunoj me rivistën çivitjote Katundi Ynë.

Botimet e tij klenë botuar gjatë vitrat 1974-2000. Tek viti 1977 botoj "*Alfabeti shqip i programuar*", çë kle shumë i kirkuar dhe i botuar me shumë edicione. Botimet dhe bashkëpunimet u intensifikuan ndë Talljet dhe jashtë vendit. Trashëgimia intelektuale e tij ka vlerë të madhe. Drejtor i Rivistës "Arbëria", botoj: "*Flet Tirana…. Flet Tirana….*" 1976, "*Libër këndimi i programuar*", Klasa I Frankfurt mbi Main 1977; "*Gjuha jonë me hare",* Frankfurt 1982, botim i rivistës Katundi Ynë. *"Antologji e shkurtër",* Frankfurt 1980, botim i rivistës Katundi Ynë; "*Libri im i parë",* Frankfurt 1979; *"Kështu është jeta sot",* Frankfurt 1984; *"Ethja diplomatike ose djali me fantazi",* Frankfurt 1984; *"Fjalët janë si gërshi ose shpirti im poetik*", 1984; "*Plus uno maneat perenne saeclo-Pastë jetë të gjatë më se një shekull*", vëllimi i parë, Tiranë 1991;" *Plus uno maneat perenne saeclo"*, vëllimi i

Giuseppe Catapano

(San Giuseppe Vesuviano (Na) 1914 - Roma 2001)

Giuseppe Catapano u le lëtì; pra, kur kish 6 vjet, fëmila tij ndërroi katund e erth Frasnitë, ku mbet njetër 6 vjet. Prof. Catapano patë një jetë shumë e munduar, me helme e lipe të ndryshëm. Për 'të shkruajti Gaetano Passarelli, frasnjot, tek rivista çë drejton "Studi sull'Oriente Cristiano" (Roma), tek artikulli: 'Alcune note sulla cronologia della vita di Francesco Paolo Solano' (17/2-2013, pp.153-179); e tek numri i ardhshëm (19/1-2015) do të ngjatënj fjalimin mbi jetën e autorit tonë. Këto janë veprat e Zef Katapanit: *Come si risolvono i problemi di trigonometria – teoria e pratica / applicazioni topografiche* – Tipografia Rodia, Rodi (Egeo) 1937; *L'esaltazione della 'Besa' albanese nell'antica Rapsodia 'Costantino e Garentina',* Tip.del Senato del dr.G.Bardi, Roma 1943-XXI (ristampa Bardi Editore, Roma 1984); *Contestazione contestata,* Itec Milano 1971; *Menelau i lënë (Menelao abbandonato)*, edizioni Zëri i Arbëreshvet – Arti Grafiche del Pollino, Castrovillari 1982; *Gesù (I)*, Bardi Editore, Roma 1982; *Ideali,* Bardi Editore, Roma 1983; *Thot (Tat) parlava albanese,* Bardi Editore, Roma 1984; *Ricordando Michele,* Bardi Editore, Roma 1985; *Antichità della Lingua Albanese (anche Cristo parlò questo idioma)*, Bardi Editore, Roma 1986; *Nel ricordo di Enver Hoxha (II)*, Bardi Editore, Roma 1986**. (D.)**

Kujtime e Ndjenja të Menelaut *

(…) Menelau foli kështu:
"Të madhen turpë po s'e mbanj u!

31. "U këtë dhunë dua t'e shoshënj
me shumë gjak: do t'e dënosënj
atë çë qe shkaku i ftesës
gruas sime: arsyeja e jetës"!

32. E vërtet Elladha e tëre
armë po shumë i vu në dorë:
jo për Lenën – kështu mendoj –
po për vendin ç'kish nevojë.

Po sa shpejt i shkuan tërbimet,
Menelaun zunë mendimet:

33. "Lenë, si e munde t'lëje Spartën,
burrin, bilën, ikur natën?!
Humbe nderin si e pabesë,
grua e ligë, e shajtur llezë?!

34. "Ike natën kusareshë,
e harruar – sa mbjatu! – nesh.
qarjes s'bilës sonë Ermjonë,
nurrës sonë, s'ndien jehonë?

35. "E s'ke turpë për atë ç'bëre,
për vendimin ' ligë çë more?
Tek një çast gjithësej harrove,
të bardhin ligj në det e shëllove?!

36. "Ti ta zhyeje ish po hri
ëmrin ' bilës çë qelle në gji?
Mos magar t'suall lëng jatrije
e ti e pive pa ç'e dije?!

37. "Mos ti doje gjë çë s'kishe
e prandaj e nëmur ndihshe?
Mos doj' t'tngjitshe shumë më lart
se nëng ndihshe mjaft e bëgatë?

38. "Jo! Se qiellin pate në duar
e nën këmbë tërë botën shtruar:
atë ç'doje, mbjatu e kishe,
se për mua s'mund ish ndryshe; (...)

39. se kur asti është i vlerë
Faregjëut i bie në derë:
e ai ç'është ëndërr vjerrë
bëhet mbjatu send shkëlqyèr. (...)

*** Ka poemthi "Menealu i lënë", Zëri i Arbëreshvet, nr.15/1982, faqe 46-48.**

Vincenzo Golletti Baffa

(Çivit 1924 -Heidelberg 2009)

dytë, Heidelberg dhe Çivit 1994-1995; *"Plus uno maneat perenne saeclo*", vëllimi i tretë, Appendix Golettiana, Çivit 1996; *"Teoria e gërshisë"*, Heidelberg dhe Çivit 1997; *"Viti 1984 dhe Teatri Çivit"*, Heidelberg dhe Çivit 1996; "*Libër këndimi i programuar* " botimi i dytë, Heidelberg dhe Çivit 1997; "*Plus uno maneat perenne saeclo"I* Lezhë, *"Plus uno maneat perenne saeclo" II* Lezhë, *"Arbëreshi merret me politikë"*, Heidelberg dhe Çivit 1999; *Fjalët fluturake",* Lezhë 2000.
Tek viti 2005 Bashkia e Çiftit i dha një zmiralë ari për meritat kulturore.

Bernard Bilotta na mban mend kush jemi

120 vjet prapë (1894), poeti frasnjot Bernardo Bilotta (1843-1918) shkruan veprën "Zakonet e Frasnitës",çë në formën e saj origjinale pa dritën mbi këto faqe. Ndër pjesat, çë këtu ri-botomi, folet për 'Pashkët': ashtu si i kremtojin asimòti Arbëreshët e Frasnitës. *(*Shih *Jeta Arbëreshe/2003, nn.12/f.11, 13/f.11, 14/f.13).* **(D.)**

Pashkt, Frasnit

(...) Frasnjot't, mund thomi, vetem për trí dit
të mbajen Pashkzit shëjte, të kultojen
harét e nji Gavnjije me shúm drit

pasur ka Arbresht, kúr ishen po t'errëjen
Pashkt dashura shúm, Pashkzit e lutura,
çë zëmrat e kërshtér po dreq gëzojen.

Me qasur të kershtervet Pashkt e bukura,
llajé Turqish, sá s'und ishen me nëmruer,
u vrén, mbréj Arbreshvet èger sultura,

t'i digjjen, t'i skriàrjen ndonj çik hér.
Skanderbeku, çë s'fj̄ëj, e nat e dit
i ruenej mb'rahj, me shokt si vrundullér

ju zdroth, kúr shkojen udhes tek ai i prit.
Shúm vrau, shúm lavosi, shúm rrëmbeu
të gjáll, lidhur t'i qellnej pra t'i vrit,

ndë s'lëjen turres shúm t'prirshin te dheu
tire. Gavnjín, çë pat'tin nd'atë hér
Arbresht (të gzuer ka Inzot, çë s'i lireu

máj, se ruejen t'i bëjen ngahér ndér)
nderuen për trí dit si m̄ë t'i ngit
harés Pashkvet e Gavnjís me hjé të gjér

pasur ka Inzot, çë nd'krahut tire ngit. *(9/9/94)*

Pjelzit

(...) Pra çë hëngertin mír e me shëndet
ndër trí dit të Pashkvet, Frasënjot't
mbjidhen e veshen ndrishe mashkarèt,

të kultojen çë bën prindt tire nj'mot
ndër Pashk, kúr përposh vú aq llajé
Turqish, nënd Skanderbekun, t'tirin zot.

Ca pjelez veshen, ca cingar: gjith me hjé
qellen, Gavnjín e t'leshtvet të ndérojen,
te kopilet ndër vallet me drit t'ré

luejen ndëprë katund e ëmbel kndojen.
Trimat e shndosht e t'hjeshem pjelez veshen:
si luftarzit e lesht të zbukurojen.

Kán ksúl mbi krie e t'veshur çë t'i qeshen
njera ndër gjùnj me dhilpa, e ndër duer
me shpat të gjér e t'gjat si pjeqt e keshen.

Kështu pesdhjet e më trima të ndrruer
nisen ndëprë katund dí e di tue kcier,
e sheshëvet ç'qindrojen zën tue luer,

di e di, gjith sá më ján, për dicahér.
Gjitonivet ka shkojen, t'hán e t'pín
nganjë ndër shokt e tire m̄ë t'i nxier.

Kúr shohen pra se dielli z̄ë e të hín,
të nisen gjith tue kcier e tue kënduer
kënkat e Skanderbekut, çë gjith dín.

Kndojen kshtu shok-shok njera pérnduer
dielli, njera dál Hëna, njera çë lshuen
gjith vallet, çë së ndihen t'vén tue luer

m̄ë, se sosen sá katundin gjith gëzuen. *(10/9/18 94)*

Cìngarit

Ndër trimat e ndër burrat,dicà veshen
Cìngar: v̄ën një kmish me ca këmbór
lidhur për mesi. E kush ë çë s'qeshen

me shapk mbë krie të vjeter ata t'shór
me singa t'zeza ngriq e shkriq
ndë çeret? Ndër sá jan, kush mbán me dór

një hú të trash e t'gjat o nj'dhikoniq
o një tigan, të nxínj këdo i pilqen.
Mbajen me jatren dór litht si kaciq

një ç'zún ndë luft të gjáll, gjind t'Turkut qen.
Këtqelljen si t'e shesen e ja ndëjen
kuj ësht, çë do t'e bjénj për sá vëlen.

Te përpiqen ndonji ltiri, të qindrojen
me Turkun, mbajtur mbillur si pullár:
e zën mbjatu e të piejen ndë kirkojen

ndonj pullarith të mír; e atë ç'kán mbár
t'e piejen ndë do t'márr se ësht i mír
e bën për të t'e márr, se dí të hár

Bernard Bilotta na mban mend kush jemi

vet kasht e ujthit ronxevet do t'pír:
s'i do krunde, s'i do elp, e mbë karrér
ecen si djáll e máj do prapt të rrír.

Pra ç'kështu ja këndojen me të kciér,
i vëhen ngrah e bën e ecen si pik.
Gjith qeshjen tek të shohen këtë vrér.

Pra çë cingari kallaret Turkut lik,
kë ká lidhur të shés si një pullár,
lëtirit çë ká t'bjénj si bjehet nj'fik,

i hapen griken të shór se dhëmb të hár
të ká, se pjak së ësht, e bën e kcen
e shqelbe bën e shtie, ndë barkut ngár.

Te rrí fadhat lëtiri, e këtë të vren
me qeshurith vrér, pa adunartur,
e nxín e e lë të nxijtur, e tutjèn

shkon tue qeshur, me Turkun si ka ai mbajtur,
e i qaset njater ltiri papá t'bënj
ashtu vrerin me gas e pa të shajtur.

Kështu nga cingar shihet të kirkónj
kuj pullarin të shés, Turkun luftár,
e pra çeren t'i nxín e të qeshënj

mbi ltirin,çë qindron nxír si fraxhár.
Pra çë Cìngarit brothtin kshtu shúm hér
ndëpër katund, e qeshtin gjith pár-pár,

serpost, si Pjelzit, nisen ture knduer. *(11/9/1894)*

Mashkarèt't

Se t'bë t'dín Turqit luftár si kán t'e shkojen
ndë jet mbatán, ndë Pist, se s'ján t'kërshtér,
t'i veshjen t'zes Arbresht e t'i péngojen

për mesi me nj'tërkuz të gjat : pa ndér
kshtu vén si kush ndërrojen filaqí,
të qellur si të liq e t'egjer vrér.

Prapa katines lën një më t'zí,
gjims pénguer, çë, mund zgjidhet, fshehet.
Si Djalli t'litht nëmron e s'sheh t'jét kí,

niset me nxërr tue ruer ku mundë vrehet;
sa e çon, i bie kaluer e i bie të vér
ku Djalli math e pret, më keq ngaleset.

Sa kí t'i qaset dritht të ziut si vrér,
çë eger më t'e pret me sí si pik
te rrí kërrust, se ftesi e s'dí çë t'thér
për të, se mos ' jét rrahur keq e lik,
t'i strosen kater djél, çë nënd i rrin:
me dhihalet e zën e i bien një çik.

Pra çë "Sosen!" i thot, të prier gjetk sín;
kater djèlit e lën, si kater qen
të reshtur ka don shqeren me egersín

e tire, e mbjatu zë e t'i nëmren
e brevjaren: të liga shúm i thot;
te kí kshtu fjet, gjith shokt kán thón "Amèn".

Amen: ke liq si do atíj thua, zot".
Pra çë furrnon s'brevjarturi, t'e lë
ndër duer djelvet, çë prír e lidhjen fort.

Këtu Fanfarra Pis's mbjatu të zë:
bien kungulit e keq, çë djelit kán,
e shkojen gjetk ku t'bredhen shesh gjér ë:

atjè të bëjen ndrishe e edhe çë pám.
Qeshjen Arbresht kërshter se Turqit qajen
ashtu ndë Pist, se t'beses tire s'ján.

Pra çë njera serpost kështuna mbajen
mbë gas katundin rrzuerith, t'nderónj
Pashkt e Skanderbekun, me k' të çajen

çeren Turqvet si dojen, gjith shok zën
kangjelin e Skanderbekut tue këciér.
Ndë prë katund, ka shkojen, butet zën

për ta shokt: stjavuke e me bikjér
i presen. Pra çë gjith mír hán e pín,
i kndojen: "*Neve kush na bëri ndér*
me stjavuke e me bikjer,
akuavit na dha për vér:
shpia tij máj pastit vrér;
e si sot edhe ngamot
shpia shokut e gëzoft,
një mil vjet ai na rroft
e si sot kutjend e shkoft,
me gjith bilzit me shëndet
rroft e past sá dishron vet.
Këjo Pashk i dhëft një det
me të mira sa t'jét jet.
M'e furrnuemi kënkën:
shok, na zëmi jetrën,
jetrën e më të mír.
ç'ish, shok, t'ngrënit e tíj?
Mish kaponsh e lepurzish" etc...(...) **15/9/1894**

Visar Zhiti
nga Durrësi

Katundi Arbëresh

Në mëngjes herët, kur rrugët dalin
nga pylli i gjumit
e nëpër pragje, pranë veturave qëndron një mace si emblemë,
në mëngjes herët dëgjon shqip,
flasin gratë gjuhën e hershme
që u lind bashkë me diellin.

Fjalët e vjetra
u ngjanë gurëve të mureve, dritësorëve që s'lodhen
duke parë detin, u ngjajnë verës së vjetër
në një qelqe që dot s'e mbaruam mbrëmë.

Dhe kur vjen mbrëmja,
në stolat e parkut, nën shelgjet vajtues
si një kor vajtosash të blerta,
pranë ikonave të rrugës flasin shqip
çibuqet e vjetër, kapelet, këpucët e lodhura,
kuajt, kamerierët, ujët, dëshirat...

Ndërsa ditën, ah, ditën, hyn gjuha tjetër,
që s'është e huaj, gjuha e çmimeve, e largËsive,
e dashurisë, e punës, e Urës së Djallit.
Më magjepsin mëngjezet
dhe mbrëmjet në Arbëri
më shumë se flamurët në muzeumet e këtushëm
që s'kanë armë.

Rosa që çalon

Çalon një rosë
dhe pasqyrimi i saj dridhës
çalon në ujrat e blertë anash
brenda meje.

Çalojnë rrezet prej drite të mendimeve
si gishtat e një dore të çliruar
nga prangat e dikurshme
mbi tastjerë,
çalojnë këngët,
era.

Unë pres muzgun,
pres hënën të bjerë mes barit
si vezë e artë rose
që s'do të çalojë më.

Visar Zhiti
nga Durrësi

Vetëvrasja e Atdheut *

- triptik -

…ikin…po ikin, sepse diktatura e pati shndërruar Atdheun në vend çfardo. Dhe të mallkuar. Por po kthehen fantazmat… Të ringjallen patriotët… e njeriut!…

- nga bisedat në muzg brenda në një gomone -

1 - Qiell

A do të kemi më qiell mbi krye?
Ra tavani i kohës, këputen copra diejsh poshtë.
Me plumba e grinë njerëzit e mi të rebeluar. Qëllojnë
lart, pa ndërprerje. Pse? Pseeee? Zbrazin
zëmërimin e jetës? Që toka s'e mbante dot të gjithin.
Janë të lirë zjarret… me bajonetat e flakëve coptojnë
botën sipër.
Hovin hobe lemerirash, bie pluhur yjesh të vdekur,
trarë të djegur ylberesh dhe
përhidhen vetëtima të përgjakura ulërimash.
Shtangin të mallkuara retë e bardha të shpirtrave të vrarë.
Ç'pranverë do të zbresë kështu
sa për të mbledhur një dorë lulesh të zeza
mbi baltën e përgjakur
e t'i çojmë në varret e rinj!? Sa shumë janë shtuar! Oh,
si vërtiten nëpër erë… varret!

Po qiell a mbeti më? Qiell?
Më larg iku Zoti i plagosur
nga plumbat e çmendurisë së turmës. Rrokullisen
ëndrrat flatrathyer, përpëliten nën këmbët tona. Dhe
ëndërrojnë edhe një ëndërr -
atdheun sipër vetvetes – që
është koka e njerëzve, por pa qiell tani si pa brerore.
Ç'zbrazëtirë e hatashme dhe kaos! Bashkë me pëllumbat

dhe avionët kanë frikë mos i therin…

2 - Tokë

As tërmetet s'kanë bërë plojë kaq të madhe! Nuk duket
e gjitha rrënoja, është imazh brenda në kafka, ankth gurësh.
Dhe zjarri vazhdon të djegë çatitë e jetës tonë. Jemi
në luftë
pa luftë.
Me ushtarë të çmobilizuar dhe fëmijët me helmeta,
me automatik në dorë
si një lodër.

Visar Zhiti
nga Durrësi

Një shëtitje me tanks nëpër qytet
kushton sa një kafe.
Copën e bukës mund ta blesh me dy revole. Restoja
ca fishekë. Fshatari në rrethinë tërheq plugjet
në tokën gurishtë
me një autoblindë të rrëmbyer.
Ç'do të mbjellësh, o at,
mallkimin që s'na ndahet,
të kësaj toke?
Pse na kanë ndëshkuar kaq gjatë? Por me sa bomba
merr një fustan të kuq?
E për të bërë dashuri?… Që
të botosh një libër me poezi, se edhe ti je i çmendur,
e shoh, duhen tre kallashë. Romani kushton më shumë,
pesë topa malorë a mortaja. Mortja, që s'ju bie!

Dhe nusen
e së dielës më të afërt e çuam me tanks,
ndërsa dasmorët e fantaksur atje rrëmbyen armët.
Velloja
si flamur i bardhë
mbi kullën e çelniktë
solli paqen mes egërsisë dhe absurdit.

Ç'po bëjmë? Ç'është ky fat kështu?!
Më therrin plagët e tokës time. Ndjej
i tmerruar se duan të më ndajnë
edhe më
si në fillim të shekullit
edhe në mbarim.

3 - Det

- Oh-tranto! -

Elegji për të mbyturit e të Premtes para pashkëve.

Dallgët e tmerrit i afrohen bregut,
kuja qull këmbët e mia
e më futet në trup,
ma lëkundin zemrën si varkë e goditur që po mbytet.

Tej, në mes të detit,
mbetën fëmijët – engjëj
dhe gratë – sirena tragjedie.
Ranë në fundin e zi të ujit
si në fund të botës.
Shkumbëzojnë mallkimet,
vorbulla krahësh dhe flokësh,
braktisja e njelmët dhe harrimi

Visar Zhiti
nga Durrësi

si një përndritje, njollë e madhe dielli të vrarë.
Anija u godit bashkë me atdheun. E përmbysur
u kthye në arkmort.
Deti – varr.

Ishin nisur për në bregun e shpresës
dhe ranë në hum(b)nerat e thella,
të turbullta dhe të frikshme si
makthet e përbindshave.
Gratë e kishin lënë të zbrazët shtratin e natës – gomone
bosh e fatit nëpër erëra. Dhe qirinjtë
e pashkëve u bënë yje të çoroditur që shuhen mbi dallgë.
Ah, fëmijët e mbytur
me lodrat që pluskojnë përsipër!
Kush do të luajë me pafajsitë e tyre,
me skeletet prej rrezesh të dritës. Ah,
fundoset një bebe e porsalindur nën ujë, doli
nga mitra e gjëmës, ja kordoni, që bashkon kërthizat, vetëm
me jetën s'lidhet dot më. Tallaziten
nëpër barkun e hatashëm të detit të vdekjes! Ngadalë…
Nga dal? Dil! Si po ma-vij-o-se-mi! Hatá…
Po zbardhëllehemi. Ujë… rrë-m-ujë…Lëvrijnë plogët
leshrat amë, të shpërndara si meduzë, si leshterikë, doçkat
e fryra të foshnjës, yje deti të brejtura. Qajnë delfinët,
peshqit ndalin si shirita zije.
Gojët e ulërimave
i mbush ujana
e apokalipsit…
Dhe ulërimat po mbyten.

Vajton era përgjithmonë - vazhdim i floknajës së dashurisë
së lebetitur. Kripë dhe jod për plagët djegëse të vajtimit.
Mallkon era dallgët... Gjeratoret
duan të nxjerrin në breg një kukull jetime. Vetëm kaq?
një libër përrallash të qullura, të mundur në përleshje. Vetëm Kaq?!
një krëhër si një skërmitje… Vetëm kaq?!! Një kufomë kitare
të mufatur… Kush do ta ngjallë? Dhe s'ka më? Asgjë pastaj,
zbrazëtirë, breg i përhumbur
paqeje të zezë!

Por dhe atëhere,
kur u përmbyt bota,
Arka e Nojes i shpëtoi rrëmetit,
vetëm njerëzit e mi duhej të binin në fundin më të zi
të botës pa botë.

Ç'hapësira t(m)erri, me-det(!),
ku tallazitet fatkobi ynë
kemi krijuar me lotët!

Visar Zhiti
nga Durrësi

Epilog

Në plazhin e nxirë,
nën shkulmet e dhëmbjes më të madhe,
nxjerr kufomat e mia të jetës, një nga një mbart
ditët e mia të mbytura,
u varen krahët si epilogë të lagur flamurësh të asgjëse,
i vë me radhë mbi zallin e shkretë si mëshira, rrëzohem dhe vetë.

Eja, Botë,
futna frymë nga gojët e tua, sa pa u bërë vonë,
ndërsa agimi na perlëzohet në ninëzat e ngrira e të hapura
që kurrë s'mbyllen më! Si zgavrat bosh të syve të kafkës.
Si deti? Si deti…
Si toka? Si toka…
Si qielli? Si qielli…

…datë e ronitur: R…m… prill… 97

***** *Triptiku "Vetëvrasja e Atdheut" është botuar italisht më parë në vëllimin poetik të autorit "Croce di carne", ("Kryqi prej mishi"), nga Shtëpia Botuese "Oxiana", Napoli, 1997, përgatitur dhe përkthyer nga studiuesi i letërsisë shqipe Elio Miracco.*
Gjithashtu është ribotuar nëpër gazeta dhe revista të ndryshme, recituar në poeteka dhe në Teatro të Poezisë në shumë qytete të Italisë si në Romë, Kozencë, Salerno, Bari, Napoli, Palermo, Bolonjë, Firence, Torino, etj, nga radio-televizioni RAI, në dokumentarë filmikë, është dramatizuar dhe muzikuar, madje është dhënë dhe temë hartimi në gjimnaze të Romës.
Pjesa e tretë e triptikut, "Det, Ohtranto" me "Epilogun", u bë dhe fletë-palosje nga botuesi italian D'Agostino, u shpërnda nëpër njerëz rrugëve dhe bashkë me lulet, në nderim të atyre që pësuan atë tragjedi aq të madhe, si shprehje e dhëmbjes, u hodh mbi dallgë në brigjet e Brindisit dhe të Vlorës. ***(shën. i botuesit)***

Nji herë

Isha një fëmi
një herë
po
nji herë
një çamarrok i vogël
ndër shumë çamarrokë
që e donte jetën
që i donte lojnat
i gëzueshëm
i gjallë
që nuk njihte trishtim

por
jeta
nuk shpërdanë ma dhurata
kopshtët kanë humbun lulet
rruga ka mbete e shkretë

askush
nuk mund të me bajë me
qeshë
askush
nuk mund të më baje me kja
kam mbetun vetëm
shokët e mi
vijnë vërdallë
si hije
e kanë humbun
përbamjen e tyne
mbi këtë tokë.

Lek Pervizi
nga Kurbini, rron në Bruksel

Pyetje

Si mundet me çelë nji lule
mbi telat e ndryskun me gjemba ?

Si mundet me mbi nji fije bar
mbi tokën e djegun e të shkelun ?

Si mundet me fluturue nji pellumbeshë
mbi qiellin e errësuem të luftës ?

Si mundet me këndue bilbili
mbi degën e ngrime të një lisi ?

Si mundet me buzëqeshë një femijë
i varun pas gjinit t'përtham të nanës ?

Si mundet me shpresue një njeri
i prangosun në qelinë e një burgu ?

Si mundet me besue një i gjallë në jetën
kur gjendet në kthetrat e vdekjes ?

Si mundet…. ? Si mundet…. ?

Alla mia amata moglie, Beba

Era fragile
piccolina, un bebé.
Uno dei pochi bambini
scampati all'eccidio degli innocenti
nel campo di Tepelena
in Albania, creato dalla dittatura
comunista, dove in una sola notte
morirono 33 bimbi ancora attaccati
al seno delle loro madri derelitte,
madri dolorose.
Salvatasi da quel massacro di bebé
le rimase il nome di Beba.
Una leggenda.

(Shih: **Lek Pervizi**, *Petalo di rosa* - poesie in lingua albanese e italiana - Edizioni "Lampi di Stampa" Milano, 2009)

Zef Beccia
nga Kazallveqi (Fg)

Lulë i jimë

Lulë, lulë i jimë,
lulë të zëmbras t'jimë,
ta një natë dhë hënza a plot
më ljura gjith një bòt
ta nji det dhë ljòt.
U ngreva pë t'shihja motin
e si vëhshja ta shtrati
peva faqen jota a bardha.
Të thërrita pë të t'sgjoja,
ma kurmi jot ishi i ftofti si gjall bora.
Më ljura gjithnjëhèrë, pa thëndrë një fjalë.
U qëllova e ngë u sgjova më.
Lulë i jimë u thah, e nanì ngë isht më.

IL MIO FIORE - Fiore, mio fiore, / fiore del mio cuore, / in una notte di luna piena / mi hai lasciato all'improvviso / in un mare di lacrime./ Mi ero alzato per osservare il cielo / e mentre mi rimettevo a letto / ho visto il tuo viso pallido./ Ti ho chiamata per svegliarti,/ ma il tuo corpo era freddo come la neve./ Mi hai lasciato all'improvviso, senza dirmi una parola./ Ti sei addormentata e non ti sei svegliata più./ Il mio fiore si è appassito e ora non c'è più.

Qetësi

Sod dielli ngë u duh pë dhë fàre,
moti isht i keq edhe i zezë shum.
Varèja a ftofta faqën pret,
zu fill ma shiun e pas borën teq.
Bora vjen posht a dale a dale.
Ta nga një shpì gjith tëcònjn zjarrin.
Udhet të zeza jan gjith të bardha.
Shkon nji qen, ká ta grika nji asht,
kërkon nji vend ku mund të a har.
Mbrënda më ke ndo një shpì
vënjn poçën mbaqa zjarrit
pë t'zìenjn groshët, qiqërat edhe bathët.
Ta një parathila di grà bënjn kufeqat
dhe kur sheshi i bardhi ka gjith një faq.
Gjith rrinjën qetu.
Si bora vjen posht,
nji pullar rraljòn ndën një shpì,
thërret katundarin psè do jetrë qavarisër.

IL SILENZIO - Oggi il sole non si è visto per niente,/ il cielo è triste e molto nero. / la bora fredda il viso taglia, / è incominciato con la pioggia e poi si tira la neve./ La neve vien giù piano piano./ In ogni casa tutti attizzano il fuoco./ Le strade nere sono già tutte bianche./ Passa un cane, ha un osso in bocca, / cerca un posto dove poterlo mangiare./ In più di una casa / mettono la pignatta vicino al fuoco, / per cuocere le cicerchie, i ceci od anche le fave./ Ad una finestra due donne fanno pettegolezzi / anche quando la piazza bianca ha una sola faccia./ Tutti tacciono./ Mentre la neve viene giù, / un asinello raglia in un sottano, / chiama il contadino per essere governato.

Marg Scilippa
nga Hora e Arbëreshëvet (Pa)

Kufiri

Një bllok i errët
matanë rrugës gjithë pluhur
një tra hekuri
një rojë e armatosur.
Shi' kufiri! Kufiri…sosje o fillim
i lirisë tënde.
Mendonj: i lënë*
kush shpresoi të ikëj
dëshmor kush derdhi gjakun më kot
renegat a hero në provoi
e mundi.
Një ushtar afrohet
të vrejturit depërtues
i ftohtë te zëri.
Mbaj frymën. Koha duket se qëndroi.
Në mbarim trau ngrëhet
kufiri hapet,
shkojëm!
Punë e lehtë për ne çë jemi të pritur
për ne unazë ndërlidhëse me kohën e shkuar
për ne paralajmëtare
të njëi endërrje të pashprehur.
Punë e lehtë për ne!
(1985)

Dua...

Dua botën
çë më lindi,
dua gurët
çë kam shkelur,
nga fill bari
çë kam mbledhur,
nga të gdhirë
çë më ka zgjuar.

(Poezi të nxjerra nga libri: **Marg Scilippa,** *Re me rreze dielli – poezi dygjuhësh / Nuvole con raggi di sole – poesia bilingue,* Pitti Edizioni, Collana Arbër 2, Palermo 2010.

Ali Podrimja
poet-shkrimtar nga Gjakova (1942-2012)

Ese

Albani

Dyer të panjohura m'u hapën. Qartaqefas e piva kafenë. Nuk di kur do te kthehem në shtëpi. Në këtë kullë prej gurit do të banoni, më thanë. Pasi u rashë poshtë e lart kateve, u ndala në dhomën mbi bibliotekën e Belëve. Hapa dritaren në anën veriore. Shikimin përqendrova në majë të Katedrales. Venerova se ajo ngacmonte qiellin vazhdimisht.

Tek bëja gjumin e parë, ra telefoni: Trimat lidhen për Atdhe, do të thotë, atdheun duhet dashur edhe kur nuk të jep asgjë. Zëri kumbues u fik në anën tjetër. Lëshova dorëzën e telefonit dhe nuk më zu gjumi më. Para dritares dridhet një gjeth, në pjergullën e zgjatur telart murit. Mund ta rrëzojë edhe puhiza. Ma kujtonte një tregim të Hivzi Sulejmanit, që as përsëvdekuri nuk e lanë të qetë. Një zot e mbron gjethin. Nxjerr dorën jashtë dhe ndiej fërkimin e lirisë.

Ditëve të para miku ma shpëloi një krah të qytetit. Tjetrin, tha, zbuloje vetë. Po deshe humb në turmë ose mbytu në Reiner. Shoh se njerëzit u ngjajnë ngapak guacave. Më të shurdhët janë. T'u nxjerrësh ndonjë fjalë, duhet thyer me çekiç ato. Në mes meje e Arbërisë, diku aty nën dritën e fortë të neonit ose pranë grumbujve të hekurishteve, shtohen dhe ngulfasin ato. Europa krijon membranën e vet mbrojtëse. Por lakuriqët ballkanas nuk e lanë të qetë. E shoh: ndryshe kupton dhe e ndërton lirinë dhe shtetin. Nëpër gjësende grith vetminë. Përpiqem të krijoj fytyrën e engjëllit tim.

Bisedën e djeshme e nis në krye të rrugës me mikun tim të ri.

- Alban, nga je?
- Nuk e di.
- Kë ke baba e nënë?
- As këtë nuk e di.
- Emrin kush ta vuri?
- Ai.
- Si ia thonë emrin?

Biseda këputet. Shikohemi çuditshëm. Errësira e syve të tij më kapërdin të tërin. Fryma gati nuk e lëshon. E kap për krahu. Nga prehëri im më shikon ai. I shpëlon dhëmbët. Pakëz më vonë çilet.

- Nuk e njoh – përgjigjet preras.
- Ashtu!
- Nëna më thoshte se ka qenë tepër i bukur... Pakëz i ngjaj unë.
- Dhe?
- Një ditë kishte ikur ai. As nëna nuk e kishte ditur pse. Pas një kohe shkoi edhe ajo. Nuk di a janë takuar më... Unë rri te gjyshja.

Rruga e Hajnrih Belit mbaron në udhëkryq. Nga aty derdhen rrugët e tjera. Lëvizet çmendurisht. Në anën tjetër, afër një bange të gjelbër, ndalen autobusët urbanë. Edhe ai nr. 1, nga i cili miku im i vogël zbret çdo ditë në orë të caktuar. Nja dhjetë metra larg e pret një grua e shtyrë në moshë, ulur mu në atë bangë. Ajo është gjyshja e tij. Sapo takohen qafohen. Rrugës së ngushtë nisen dorë për dore. Ajo bie përskaj shtëpisë së rrethuar me gjelbrim.

Takimi i parë me vogëlushin ndodhi rastësisht. Në krye të rrugës kryesore gjendesha sapo zbrisnin fëmijët nga autobusi urban nr.1. E kisha vënë hapin në shkallën e parë kur dëgjova: Alban! Alban! Ktheva kokën nga zëri gati i shtjerrë. Gruaja e shtyrë në moshë afër bangës priste vogëlushin e veshur në blu, i cili u nda nga turma. Me çantë në shpinë e me një qese sportive kaloi zebrën. U puthën dhe dorë për dore u nisën rrugicës që shpiente atje në krye të rrugës.

Para meje u ndal një ditë autobusi nr.1. Zbriti vogëlushi, fytyra e të cilit më ishte vijëzuar në kujtesë. As vetë nuk e di, në gaz i thashë: Ku je, more Alban? Ai ktheu kokën. Më shikoi me habi befasuese; kush isha

unë vallë! Në dyshim përvoli buzën. U zhduk pas drunjve, duke kthyer kokën disa herë pas autobusit, i cili rrëshqiste ngadalë. Pas tri ditësh e njëjta skenë: tek hyja, vogëlushi zbriste. Më shikoi fëmijërisht. Sytë i kishte të kaltër, plot dritë qiellore. Nuk e mbaj mend cili më parë buzëqeshi. Ky ishte takimi ynë i dytë.
Më vonë mësova se Albani kishte lindur nga një dashuri e rastësishme e dy bredhacakëve të takuar rastësisht në Këln. Babai i tij, të cilit nuk di pse nuk ia thotë emrin, një ditë me shi tek kishte shkelur rrëzë Katedrales, ishte bërë qull tek e shikonte atë nga poshtë-lart. Ishte sjellë rreth saj përderisa një dorë vashe kishte hapur çadrën. Ai nuk e kishte veneruar fare atë. Sytë i kishin mbetur në majë të Katedrales. I bëhej se ajo ishte nja tri herë më e lartë se xhamia e Sinan Pashës. Nuk kishte kaluar as një muaj dhe prapë ishin takuar. Ajo shiste lule pranë Urës Lëvizëse. Nëse dëshiron të të shkojë puna mbarë, duhet përzier gjakrat, i kishte pëshëpritur ajo. Dhe kishin rënë në dashuri. Pra, nuk mund të thuhet se Albani është kopil.

Sapo zbritja një paradite në stacionin tim, më doli përpara me biçikletë ai. Nuk më kishte harruar edhe pse nuk ishim parë me ditë.

- Ç'bën, Alban? – e pyeta në hap.

Rrudhí krahët. Nuk më kishte dëgjuar ndoshta.

- E di ç'do të thotë emri yt?

Lëvizi kokën. Mezi dikur shqiptoi: Jo.

- Mirë që nuk e di… E di ku gjendet Kosova?

Dy çuka iu thelluan në faqe.

- Mirë që nuk e ditke as këtë.

Ika në shtëpi. Në krye të rrugës, nën kurorën e një pishe, qëndronte ai. Nuk lëvizi vendit derisa mbylla portën e jashtme. Nga këndi i dritares pashë kur rreptas pastaj i grahu biçikletës.

Lexoja faqet e fundit të një libri kur dëgjova trokitje të lehtë në derë. Hapa atë dhe brenda u rrokullis buzëqeshja e vogëlushit. Ishte koha kur ai kthehej nga shkolla. Zuri vend. Përpara ia vura një gotë lëng dhe çokollatën. Ballë meje përbihej njëri nga tragjikët e kohëve moderne të popullit tim, që në mënyrë të dhembshme sajonin Librin e asimilimeve. Një orë gati kishte kaluar kur më tha se ndodh ta kërkojë gjyshja edhe në polici. Mos u bë merak, i thashë. Të përcjell unë. M'i tregoi librat. Autorët e tyre ishin emra.
- Di kush është xhaxhi Naim? – e pyeta befas. Ngriti vetullat. Me fund zbrazi gotën. Prapë e grisi çokollatën me dhëmbë të imët. Fill e për pe zura t'i tregoj për çdo gjë, që kishte të bëjë edhe me atë që nuk dinte asgjë. Dikur më pyeti: Ku gjendet Tomorri? Po pse pyet për Tomorrin, desha t'i them. Aty rrijnë perënditë tona. Por këtë emër disa herë e pështëriti. Në mënyrë karakteristike e theksonte germën rr. Më bëhej se këtë e bënte më tepër për vete, ose përpiqej të grithte diçka nga kujtesa e tij. M'i nguli sytë dhe nuk pyeti asgjë më. Hapi çantën. Me kujdes vuri librat. Por ç'libër t'i dhuroja unë? Ato mbi tavolinë ishin edhe për mua të rënda. U vinte era kazamate, lagështi; pikonin gjak, ofshamë e vdekje. Megjithatë, vendosa t'ia fal ca. Ia vura përpara. I shikoi me kureshtje. Shpejt e shpejt i vendosi në çantë. Pak pa rënë muzgu e përcolla deri te shtëpia. Tërë rrugës nuk m'i hoqi sytë. Nuk di në kë i përngjaja. Në të ndarë edhe një herë m'i shkundi kaçurrelat. Gjyshja e shqetësuar zbriti shkallëve. Më shikoi me dyshim dhe ikën brenda. Në dritare lëvizte dorën ai.

Në fund të kopshtit të Belëve këputja një mollë kur pashë mikun me Albanin nën sjetull. Ua bëra me dorë. Më kishin kërkuar gjatë.

- Atdheu e ka një motër – pakëz në gaz e i dehur tha gadimsi, që më kishte bezdisur rreth atdheut që nga nata e parë.

Albani nuk bënte vër me gojë. Nuk e kisha parë të tillë. Nga maja e kokës deri në thembër i kishte rënë një hije pikëlluese. Dikur m'u bë se plasi.

- I pe librat? – e pyeta ngadalë – Herën tjetër t'i sjell të xhaxhit Naim. Aty e ke edhe Tomorrin.

Ai fare nuk dëgjonte. Bënte ca lëvizje jo të zakonshme. Më vonë ato u bënë më të rënda tek grimconte thonjtë. Nga dora e gadimsit u shkëput dhe vrapoi livadhit. Nën një hije peme gjëregjatë u shtri. Dëneste. Mes dhëmbëve më ishin ngrirë fjalët. Për herë të parë e shihja të përlotur Albanin.

- Ç'ke vogëlush? E pyeta i trandur.

Flokët e verdhë ia përkëdhelja tek ia puthja. Ai vazhdonte kafshimin e gishtërinjve. Nuk prante. Përjargej. Në mes shuplakave të duarve fshihte fytyrën. Më vonë drejtoi shikimin nga unë. Mezi u dëgjua:

- Nuk di të lexoj shqip. Unë nuk jam fajtor.

- Oh, Zot!

Ula kokën i turpëruar më tepër nga vetja. Nuk desha të m'i shihte sytë e lagur. Më vinte inat të m'i shihte ai që qante për fatin e vet...

Shumë vjet më parë udhëtoja për në Paris. Diku mbi Alpet e Europës stjuardesa kishte alarmuar: Ju lutem, lidhuni! Nuk punon një motor. Për herë të parë e kisha uruar Zotin të bëja udhën bashkë me Lumin edhe në Hade. Kisha shpërthyer në gaz dhe i kisha tmerruar njerëzit, që fshiheshin nga hija e vdekjes. Po Albani, ku shpie? Librin e asimilimeve e lexoja, apo teksa fillova ta shfletoja.

Rashë në gjunj, nën qiellin e zymtë midis livadhit. Futa kokën mes duarve plot dhé. Miku im i vogël ishte larguar pa nxjerr zë. Adheu, si duket, iu kishte pëshurrur. Aty afër m'i kishte lënë librat. Fërfllizë shiu ishte derdhur mbi mua. Për diçka që dhemb nuk është turp të qash. Albani nuk ishte i vetmi nga Libri i asimilimeve të popullit tim. **(*)**

(*) *Këta dy shkrime* - Ese-*në këtu sipër dhe* Reflekse *çë vjen pas - m'i kish dërguar i ndjeri* ***Ali Podrimja*** *për botim, gjatë vitit 2007, po qëndruan të pabotuar.* ***(Drejtori)***

Reflekse

Gjergji nga Temali

Sapo dielli pikte tej Qafës së Prushit, e lija pas Gjirin e Jahocit. Rrëze faqes së zhveshur të Çabratit bëja udhë gati një gjysmë ore. Te kthesa e parë e Rripës, atje lart ia lëshoja sytë shkurrës së frikshme. Në mes të saj ngritej një cung i madh, hakaret. Askush nuk e mban mend sa vjeç ishte. Nëna më thoshte se ekzistonte aty shumë më heret se flitej në lagjen tonë. Sipas të gjitha gjasave cungu kishte qenë një dru i lartë dhe i bukur. Nën kurorën e tij ishte freskuar shumëkush. Edhe tani hija e tij bie në udhë, më e cunguar. Te shkurra e mistershme, në midis të faqes së zhveshur të Çabratit, ku me perëndim të diellit thyheshin dritat e reflektuara nga valët e Erenikut, u ngjita një pasdite të vonë. Kur i afrohesha, ndijeja praninë e mbretërisë së cungut, flladin e tij të përzier me shkrumbin e vjetëve dhe gjymtyrëve të vdekura.

Cungu ishte gati i derdhur, i pashpirt; ashtu siç tregonin në lagje. I ngjante një krijese pikëlluese; i burgosur në vetminë e merimangave, këpurdhave helmuese, myshkut. As në Makondon e Markezit nuk do gjeje një cung kaq të vetmuar. Nëpër trupin e tij të zhveshur, të nxirë futë nga shirat e erërat, lëviznin kushedi sa gjarpërinj. Ca prej tyre, atje në majë katullaqë bënin gjumë të mirë; ca humbnin vrimave të thella duke ndjekur ndonjë mi ose insekt, që guxonin t'u prishte qetësinë. Rrallë mbi të fluturonte ndonjë laraskë.

Qëndroja nja pesë metra larg. I bëra dikur dy rrathë rreth tij dhe u lëshova faqes së Rripës pasi dëgjova fishkëllimën e një verdhushke. Shumë vjet më vonë në kujtesën time, në mënyrë të çuditshme, hetoja formësimin e asaj kreature trishtuese, e cila zgjonte në mua asociacione të llojllojshme deri te ajo nama e popullit, e cila i rrëshqiste nganjëherë edhe nënës: U bëfsh cung! Në fillim prania e tij ishte e zakonshme. Ato vija të rënda e gjymtyrë të vdekura i shikoja me një dhimbsuri. Një natë, kur ndjeva peshën e tij, shqetësimi kishte lëshuar rrënjë në shpirtin tim. Cungu nuk ishte më vetëm cung i vetmuar në mes të një shkurre, por pjesë e pandashme e ligjërimit tim. Ishte e pamundshme të lirohesha nga hija e tij.

Në Ulpianë, nga kati i katërt, derisa më rrëshqitnin sytë në terrin frikësues një natë vjeshte, diçka e zezë ngrihej para dritares sime. Dhe kur zu të shkundet si ai mani i Nunit buzëqesha. Ishte cungu. Pritja dënimin se kur do të më nxirrte edhe jashtë dhome. Unë ende nuk e kisha kryer poezinë për të. Vëreja se ishte nxirë edhe më shumë, me gjymtyrë gati të thyera, me nej të frikshëm.

Dhe kur mendoja se isha liruar nga zymtësia e tij, pas shumë vjetësh në Frankfurt, në një kënd, ku, siç thoshte nëna, qosheve ruhen gjërat më të vlefshme, vizuelisht lexoja "Mbijetesën shqiptare", kapur nga Jetta Benzenberg.

Kisha lexuar e dëgjuar shumëçka për kampet e përqendrimit në Shqipëri, për atë majën e tmerrshme ideologjike, që kishte rrënuar edhe koka të kombit, por kurajoja kishte munguar. Ndaj diktaturës ishim treguar qyqarë. E donim Shqipërinë se te ajo na dukej e bukur edhe vdekja. Tani atë turp nacional e shihja varur në mur përmes fotografive të pastra, që lexoheshin si tekste lemeritëse. Jeta ishte zhveshur deri në asht. Ishin shpëluar krimi, mjerimi, revolta, viktima dhe gogoli i zymtë i diktaturës. Fotografi e mesazhe ishin shkrirë në një përmbajtje: tragjedi njerëzore. Aty zbuloja edhe një plagë të re të Gjergj Elez Alisë. Nuk ishte e vërtetë se ai na i kishte vetëm nëntë plagë...

Ca dridhma ma kishin përshkuar trupin. Në sfond portreti i shqiptarit në moshë të thyer: me ballë të gjerë e mollëza të dala e të rjepura, me duar të paluara mbi gjunj të cullakosur, me gishtërinj të shkurtuar e neje të ënjtura, që hynë edhe në një poezi timen. Tronditës ishte shikimi pikëllues, akuzues, që e kishte mbështjellë hija e rëndë e që e vijëzonte dhunën. Fatkeqësisht, para meje ishte njeriucung, i dalë nga dheu arbëror, që nuk dallonte fare nga cungu im atje në Çabrat, i cili më vizitonte shpesh.

Papritmas më kishte zgjuar një zonjë gjermane, e cila qëndronte përballë portretit rrënqethës. Kishte sharë në gjuhën e vet dhe në syrin e saj të kaltërt pashë lotin. Kishte hequr pastaj shallin nga qafa e vet. Me kujdes e kishte mbuluar fotografinë dhe ishte larguar, duke mos i shkoqur sytë derisa ishte zhdukur nga salla. Fotografia fliste shumë. Nuk kishe të bësh me fantastikën, por me një realitet të hidhur që i afrohej fantastikës.

Ula turpshëm dikur shikimin. Lexova: Gjergji. Gjergj quhej cungu im, ai i Camajve nga Temali. Në mbretërinë e tij, më në fund e kisha zbuluar poshtërimin njerëzor, por nuk di a kishte marrë fund udhëtimi. U bëfsh cung more, mbasi nuk e vrave qenin, m'u bë se dëgjoja nënën nga bota e tejme...

(Ali Podrimja)

Jeronim De Rada, personalitet i Botës Arbëreshe

dr. Denisa Tare
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

(2 - vjen ka nr. 77)

Jeta politike e De Radës dhe publicistike

De Rada njihet si një figurë e madhe në opinionin publik evropian. Ai njihet jo vetëm si shkrimtar me një kulturë të gjerë po njëkohësisht si lëvrues i palodhur i gjuhës shqipe e si personalitet politik, publicist me një dinjitet kombëtar. Studiues të dëgjuar të kohës, si Nikolla Tomazeo, Çesare Kantu, Herman Boholc, Dora D'Istria, Anton Simagoi, Gustav Majer e mjaft të tjerë, kanë shprehur mendime për të duke e quajtur si pionier i shtypit shqiptar[1]. De Rada nisi të merret me gazetari që në moshë të re, që në vitet e para të krijimtarisë së tij letrare. Prirjet e De Radës u panë që në rini, kur Instituti Kozentin, duke vlerësuar meritën e tij letrare, e emëron , në sesionin e 11 prillit të vitit 1839, si antar korrespondent. De Rada nisi të bëjë emër në rrethët intelektuale të kohës. Më 1 korrik 1842, Jeronimi bëhet korrespondent i Ankarasë në Napoli[2]. Më 1878, De Rada ngriti zërin në mbështetje të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, duke protestuar me forcë kundër cënimit të tërësisë tokësore të Shqipërisë. De Rada ishte mbrojtës i flaktë i lirisë dhe pavarësisë së Shqipërisë, për këtë arsye rimerr pozitën e tij si gazetar për t'ju bërë thirrje botës se shqiptarët do të luftonin për të fituar të drejtat e popullit shqiptar si dhe pavarësinë dhe bashkimin kombëtar. Kjo e nxit që të botojë dhe një ndër përkohëshmet më të dëgjuara të kohës "Fiamuri Arbërit" apo "La Bandiera Albanese"[3]. Titulli i revistës qe mjaft kuptimplotë për t'i treguar Evropës se ky flamur asnjëherë është përkulur e as do të përkulet. Përmes kësaj reviste mujore mund të thuhet se ka origjinën fillimi i shtypit shqiptar; njëkohësisht De Rada përmes saj i bëri të njohur Evropës se ekziston një popull shqiptar që ka një histori, një gjuhë dhe tradita të forta e cila mund të aspironte pa frikë lirinë dhe pavarësinë[4]. Kjo revistë u themelua në 20 korrik 1883, në Koriliano Kalabro. Duke filluar nga 20 shtatori 1885, e përkohëshmja vazhdoi të botoet në Kozencë. Prej saj dolën 31 numra. Në këtë revistë bashkëpunuan shqiptarë dhe arbëreshë të ndryshëm (si Dara i Ri dhe Mitkoja) [5].

De Rada e shfrytëzoi këtë të përkohëshmen për një mision fisnik për të pasqyruar me të gjitha format dëshirën e tij dhe të shqiptarëve të kudondodhur në botë për të siguruar pavarësinë e Shqipërisë.Per sa kohë qarkulloi kjo revistë u prit me shumë ngrohtësi nga arbëreshët.
Arbëreshi G.B. Kadikamo i drejtohej më këto fjalë inkurajuese themeluesit të saj, Jeronim De Radës: *"Me ndërmarrjen tuaj fisnike ne të rinjtë arbëreshë presim, në çdo çast, të tingëllojë kambana e kryengritjes kombëtare në Shqipërinë tonë, sepse dëshirojmë të derdhim edhe pikën e fundit të gjakut për të mirën e atdheut tonë të dashur"* [6].
Përgëzime De Rada për themelimin e "Flamurit të Arbrit" merr dhe nga Dora D'Istria. Ja si e përgëzon ajo De Radën në një ndër letërkëmbimet e tyre të shumta.

Firence, 5 shtator 1883

Zotëri,

Po matesha t'ju shkruaja se me sa kënaqësi e kam marrë numrin e parë të "Flamuri i Arbrit" dhe se nëpërmjet letrës tuaj mësova që edhe të tjerë veç meje e kanë vlersuar drejt fletoren tuaj patriotike dhe i kanë çmuar siç duhet përpjekjet tuaja fisnike. Mesa dukët se në fillim dhe numri i pajtimeve është i kënaqshëm. Dua të besoj se flamuri i Shqiptarëve ka për të marshuar triumfues dhe ka për tu ngritur një ditë mbi majat e Shkodrës, fitimtar dhe udhëheqës i të mirash. Besoni zotëri se askush më shumë se unë nuk e uron këtë gjë dhe kini mirësinë të pranoni të falat e mia vllazërore [7].

*Dora D'Istri*a

Jeronim De Rada, personalitet i Botës Arbëreshe

Më 15 janar të 1844, në artikullin me titull *E përkohëshme botërore*, De Rada shkruan këto: "Ndjejmë gëzim t"ju njoftojmë se Flamuri ynë, i sapolindur, ka nisur të bëhet një e përkohëshme botërore. Duke u kërkuar në Francë, në Gjermani, në Austri; prej saj, tashmë, shkojnë 12 kopje në Amërikë, 3 në Azi, 12 në Rumani, 35 në Turqi, 11 në Greqi, 50 në Egjipt..." [8]. Të njëjtën fakt e konfirmon dhe Oreste Camillo Mandalari në veprën e tij, i cili thekson se e përkohëshmja u prit mjaft mirë në Evropë dhe kishte abonentë njerëz të shquar të letërsisë, kulturës, shkencës dhe politikës. Rreth 300 abonentë në Itali, Francë, Gjermani, Austri, Hungari, Greqi, Turqi, Rumani, Egjipt, Shqipëri, ShBA, Argjentinë, Azi etj. ..[9] Në 5 qershor 1884, revista " Melusine" e Parisit, një nga të përkohëshmet më të përmendura të Evropës, nën titullin " Organ Kombëtar" Ja si e recensonte " Fjamurin e Arbrit": "Në një koloni shiptare të Italisë del fletorja e zotni De Radës". Ajo është një organ kombëtar, jo vetëm i ngulmimeve arbëreshe të Italisë, por dhe i Shqipërisë së mirfilltë, që sot është ende nën turkun". Revista nga numri në numër tërhiqte me vete mjaft lexues dhe studiues nga më të ndryshmit: arbëreshë, shqiptarë dhe të huaj.

Më maj 1885, Tomazo Kanifero shënonte se " Flamuri i Arbrit", është një botim që pritet me interes nga një skaj i Evropës në tjetrin". Kjo revistë u jepte një vend të dobishëm krijimeve letrare, sidomos atyre të të rinjve arbëreshë. Aty u botuan tri aktet e para të dramës "Emira" [10] të Santorit. Megjithatë kjo revistë nuk pati jetë të gjatë, qoftë për mungesë fondesh financiare, qoftë për arsye të pengesave që i nxirrte çensura turke, madje dhe ajo greke; megjithatë dobia e saj për çështjen shqipatre qe e madhe.

Pengesat nisën të shkaktoheshin nga njëkohsisht dhe nga politika antishqiptare e Turqisë, Austrisë, Italisë, Serbisë, Bullgarisë, Malit të Zi. Përdoreshin lloj-lloj mënyrash dhe formash për të penguar botimin, shpërndarjen, shftytëzimin e së përkohëshmes. Por sërisht Dora D"Istria e këshillonte të ishte i duruar. Në letrën e 18 prillit të 1844 ajo shkruante : *"Kam parë me dëshpërim letrën tuaj, se ju kanë dalë telashe për botimin e një vepre aq të dobishme si " Fjamuri i Arbrit". Është për të ardhur keq, që shpeshherë hasim pengesa në punë që përpiqemi ti bëjmë vetëm me devotshmëri dhe dashuri. Por durimi është i domosdoshëm dhe ne duhet të jemi gjithnjë këmbëngulës për të marshuar përpara"* [11].
Pavarsisht përpjekjeve për ta mbajtuar në jetë këtë të përkohëshme, De Rada nuk ja arriti qëllimit. Sidoqoftë e përkohëshmja " Fiamuri Arbërit" qe një flamur dhe nje flakë e gjallë atdhedashurie e një shqiptarizmi të kulluar. Në këtë organ De Rada shtroi me forcë çështjen politike të kombit duke mbrojtur të drejtat e popullit tonë, duke e bërë të njohur çështjen shqiptare në Evropë. Kjo revistë i dha të kuptojë diplomacisë evropiane se në bregun lindor të Adriatikut kishte lindur një çështje tjetër, çështja shqiptare. Nëpërmjet kësaj të përkohëshme De Rada krijoi marrëdhënie mes arbëreshëve të Italisë dhe arbëreshëve të Shqipërisë si dhe atyre që gjënden në vise të huaja, si Turqi, Egjipt, Greqi, Rumani etj... Kjo revistë luftoi me patriotizmin më të madh pushtuesit osman si dhe synimet e huaja në vendin tonë. Ai demaskoi qëllimet e shovinistëve fqinj në Ballkan, serbë, malazezë, grekë, si dhe politikën ekspansioniste italiane dhe austriake. Mund të thuhet se " Fiamuri Arbërit" është i vetmi organ i parë i shtypit periodik shqiptar që bashkoi inteligjencën shqiptare të asaj kohe, të shpërndarë në katër anët e botës. Në faqet e kësaj reviste De Rada mbrojti me zjarr para opinionit evropian çështjen e ekzistencës së kombit shqiptar, duke provuar se shqiptarët kishin një gjuhë të tyre, historinë e tyre të lashtë, letërsinë, folklorin dhe shtpypin periodik.[12] "Fiamuri Arbërit" u bë me të vertëtë flamur e trumbetë që thërriste shqiptarët për çlirimin e mëmëdheut. "Suksesi i rezistës – thoshte studiuesi i mirnjohur Mikele Markianò - i detyrohej, në dy fusha të ndryshme, dy arsyejeve po aq të ndryshme: idesë së kombësisë shqipatre që për herë të parë u formulua nga De Rada si një kërkesë drejtësie drejtuar diplomacisë evropiane, dhe përhapjes së lëtërsisë shqiptare....".[13]

Megjithëse dëshirën e madhe, mbas katër vitesh lufte dhe përpjekjesh, mes mundimesh, hidhërimesh e mërzitjesh të shumta, për arsye ekonomike dhe nga censura të mëdha u shua flaka e "Flamurit të Arbrit".
Duke i munguar dhe përkrahja e pajtimtarëve, De Rada u detyrua të mbyllë redaksinë e revistës. Lidhur me shkaqet e mbylljes së saj flet vetë De Rada në një letër që i dërgon Gustav Majerit. Ja çfar i shkruan atdhetari

i shquar këtij albanologu: " Flamuri i Arbrit" pushoi së qarkulluari pas numrit të shtatë të vitit të tretë. Më erdhi keq sepse u ndërpre botimi i dramës së Anton Santorit dhe sepse pushoi një dëshmitar tjetër i thjeshtë dhe i vërtetë i qënies sonë në mërgimin e trashëguar. Por ç'ti bësh? Mua më mbeti një kredi e humbur prej 2400 lireta, nga pajtimtarë detyrues të vonuar. Nuk pata më nga të miat për t'i përdorur si paradhënie.
I zënë ngushtë nga huadhënësit kam shitur me humbje grigjën. Dhe tash tri javë më kot po përpiqem të shes një copë tokë....". Sidoqoftë [14] e përkohëshmja "Flamuri i Arbrit" hyri në historinë e shtypit shqiptar si revista e parë letraro-politike. Ajo bëri shërbime të mëdha për njohjen e Shqipërisë në opinionin publik evropian, si vend i një populli të lashtë e me tradita, që ruajti me krenari tiparet e tij të veçanta, duke qëndruar me armë në dorë për të fituar lirinë dhe pavarsinë kombëtare. Në plan të parë në këtë revistë vihet ana politike e pastaj ajo letrare. Ndonse qe e njohur si e përkohëshme letraro-politike, ana politike zë një vend më të gjërë në të. Kjo ndodh ngaqë çështja shqiptare në atë kohë ngjall një interes të veçantë në opinionin publik evropian. Në artikujt e kësaj të përkohëshme shihet forca goditëse kundër prapaskenave dhe planeve të shteteve fqinje. Të cilët përpiqeshin në të gjitha mënyrat të copëtonin Shqipërinë. Ajo përçoi, jo vetëm zërin e popullit shqiptar e arbëresh por ndihmoi në afrimin e lidhjeve ndërmjet tyre si popuj të cilët kishin një gjuhë të përbashkët, por diti të bëjë për vete shumë lexues të huaj, të cilët shprehnin ndjenjën e nderimit dhe dashurisë ndaj popullit shqiptar.[15]

Ajo që i rriti vlerën De Radës nga pikpamja e rrugës që ndoqi si publicist, është gazeta "L'Albanese d'Italia" apo "Arbëreshi i Italisë".[16] De Rada tashmë përmes kësaj të përkohëshme shihet si një gazetar me një pjekuri më të madhe politike. Ai e nxorri këtë gazetë në kushte të vështira ekonomike dhe politike, sepse viti 1848 ishte viti i ngjarjeve të rëndësishme politike në shtetet evropiane dhe ballkanike. Në Shqipëri , më 1848, kishte filluar lufta për autonominë kombëtare. Që prej shumë vitesh është pranuar zyrtarisht fakti se organi i parë i shtypit shqiptar është një gazetë e vogël e botuar në verë të 1848, nga Jeronim De Rada, në Napoli. Kjo gazetë është pikërisht "Arbëreshi i Italisë" prej të cilës dolën në botim 27 numra deri në verën e vitit 1849.[17] Numri i parë i revistës doli në Napoli më 23 shkurt 1848 dhe shënon një datë të shënuar sepse përmes saj nis në Itali një lëvizje e njohur si 'lëvizja Pro-Albania'. Një lëvizje e cila do të mbronte fuqishëm çështjen shqiptare.
Si fillim kjo gazetë doli në një format të vogël, me katër faqe dhe me një letër të dobët. Kështu shkruan vetë De Rada në veprën e tij " Autobiografia". Ai citon: "Kisha pak të holla - thotë por, sidoqoftë, atë ditë bëra kontratën me shtypshkronjën "Trani" dhe kështu doli me një letër të varfër e me një karakter të vjetër "Arbëreshi i Italisë".[18] Në Napoli ajo pati pak lexues, por në krahinën e Kozencës u abonuan 150 veta. Shumë shpejt gazeta fitoi popullaritet në masën e gjerë të lexuesve arbëresh dhe shtoi tirazhin e saj. De Rada tashmë fillloi të njihet në rrethet intelektuale të Napolit përmes kësaj të përkohëshme.
Aty ai shkroi mbi lavdinë historike të popullit shqiptar. Në gazetë krahas ngjarjeve politike të botuara në gjuhën italiane, janë shkruar dhe artikuj në të folmen arbërishte, e kjo e bën atë të quhet gazeta e parë shqiptare.[19] Shumë shkrimtarë janë shprehur në forma të ndryshme rreth rëndësisë së kësaj të përkohëshme. Shkrimtari A.Gikosi në 1896 në gazetën "MESSAGERUL" në Bukuresht, shkruan rreth kësaj çështje: " Patrioti i madh Jeronim De Rada, poet dhe profesor i gjuhës shqipe, nxorri në botim në 1848 gazetën "L'Albanese d'Italia".[20] Fillimet e diskutimeve rreth çështjes shqiptare thuhet se kanë nisur në Itali dhe pikërisht në këtë vend kanë lulëzuar dhe shoqëritë e para kulturore." Ndjenja e atdhedashurisë u përçua në të gjitha shkrimet që u botuan në këtë të përkohëshme. Shumë atdhetarë shkruanin të mallëngjyer për vlerat që solli botimi i kësaj reviste. Më 3 mars 1848, Gaetan Kantisani nga San Marko i shkruan me fjalë prekëse De Radës: "Kam marrë dy numrat e parë të gazetës "Arbëreshi i Italisë" dhe pothuaj shpesh herë i kam lexuar dhe rilexuar duke qarë... Nuk ka shqiptar të mos ushqejë ndjenja të tilla për një ndërmarrje që nderon gjuhën e Epirit....".[21] Në faqet e kësaj gazete janë botuar mjaft shkrime dhe madje dhe pjesë nga poema të ndryshme. Përveç pjesë nga poema "Vallja e Haresë së madhe" e Anton Santorit, u botuan në disa numra me rradhë edhe disa pjesë nga poema e Serafinës. Si përfundim përmes këtyre burimeve të ndryshme mësohet se De Rada e nisi veprimtarinë publicistike nga viti 40 i shek XIX si bashkëpunëtor dhe drejtues

në shtyp, duke patur në qëndër të vëmëndjes së tij çështjen shqiptare dhe të kaluarën historike të popullit shqiptar. Pavarsisht vështirësive që lidheshin me ngjarjet në Itali, De Rada e çoi më tej punën në fushën e shtypit, duke mos qëndruar larg luftës së popullit shqiptar për liri kombëtare. Gazeta 'L'Albanese d'Italia' qe një tribunë e fuqishme që kërkonte ringjalljen e atdheut të robëruar dhe pavarsinë e tij. Një vend me rëndësi në këtë të përkohëshme zënë dhe botimi i këngëve dhe folklorit arbëresh, si një pjësë e ndërgjegjes së këtij ngulimi të vendosur atje 400 vjet më parë.

Gazeta "Arbëreshi i Italisë" mund të kishte vazhduar të qëndronte në qarkullim më gjatë nëse De Rada nuk do të kishte patur zhgënjimin e parë politik të jetës së tij.
Si i ri liberal ai qe angazhuar në jetën politik dhe pati marrë pjesë në revolucionin e po atij viti, i cili kërkonte të adaptonte Mbretërinë e Napolit me idetë e revolucionit francez të korrikut të 1848. Pas dështimit të revolucionit ai u burgos së bashku me shumë të rinj të tjerë arbëreshë dhe nuk u lejua të largohet nga fshati tij Maki. Ky internim i parë do të bëhej shkak për mbylljen e gazetës së tij dhe të parës në historinë e saponisur të shtypit shqiptar.
Që nga ajo kohë e deri në 1861 askush nuk do të dëgjonte më për De Radën. Dihet se jetoi në Maki po nuk dihen impenjimet e tij. Mendohet se mund të jetë marrë me poezi pasi në 1936 pati botuar "Këngët e Milosaos" dhe, më 1843, "Serafina Topinë". Aktiviteti i De Radës pas kësaj kohe është i njohur. Ai iu kushtua tërësisht çështjes shqiptare. Vendosi korrispondencë me shumë personalitetet politike dhe avokatë të çështjes shqiptare. Njohu dhe bashkëpunoi ngushtë me disa emara të shquar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Në vitin e parë të rikthimit në qytet botoi veprën " Parimet e estetikës", tre vjet më vonë veprën " Lashtësia e Kombit Shqiptar" dhe në 1866 " Rapsodia e një poeme arbëreshe". Kontibuti i tij gazetaresk siç e kemi trajtuar dhe më lart nuk u mbyll me kaq. Ai botoi nga viti 1883-1887 revistën "Flamuri i Arbrit".[22] De Rada nuk e mësoi kurrë, deri në fund të jetës së tij, më 1903, se gazeta që ai botoi për 27 numra më vitin 1848 qe gazeta e parë në historinë e Shqipërisë.[23] Vitet e fundit të jetës së tij, ndonse të shoqëruara nga varfëria dhe vetmia, nuk e shteruan vrullin krijues të shkrimtarit të madh. Ai botoi dy librat e fundit të " Skëndërbeu i Pafanë" dhe vepra të ndryshme historike, gjuhësore, letrare si "Pellazgë e shqiptarë", " Konferenca mbi gjuhën shqipe" (1894), një pjesë jetëshkrimi me titull "Autobiologjia", ripërpunon veprën " Numidët" me subjekt nga luftrat e Romës me Kartagjenën. Në këtë kohë poeti ripërpunon rrënjësisht " Këngët e Serafina Topisë" dhe kurorëzimin e punës vet të gjatë krijuese me botimin e poemës nën titullin e ri "Një pasqyrë e jëtës njërzore"(1908). Gjithashtu De Rada merr përsipër të organizojë dy Kongrese Linguistike Gjuhësore Arbëreshe, një më 1895 dhe një në 1897. Në vitet e fundit të jetës De Rada ishte prapë mësues i shqipes në Kollexhin Shën Adrian. Pesë muaj parë vdekjes, më 1902, De Rada boton veprën e vet të fundit " Testamenti Politik". Po atë vit botohet nga kritiku i shquar, Mikel Markianoi, dhe kushëriri i tij, një monografi për jetën dhe veprimtarinë e De Radës. Jeta e De Radës shuhet më 28 shkurt 1903.[24] Mendimi i tij i fundit dhe fjalët e tij të fundit ishin për Shqipërinë dhe fatin e hidhur të arbëreshëve.

Shënime : 1) A.Kondo, vep e cit, f.13; 2) Po aty, vep e cit, f.14; 3) Oreste Camillo Mandalari, Girolamo De Rada precursore della Nuova Albania, Archivio Storico dei Reduci di Guerra, Roma, 1939, f.15; 4) Po aty; 5) K.Kodra, vep e cit, f.75; 6) J.Kastrati, vep e cit, f.164; 7) A.Kondo, vep e cit, f.212; 8) J.Kastrati, vep e cit, f.165; 9) O.C.Mandalari, vep e cit, f.15; 10) K.Kodra, vep e cit, f.75; 11) Po aty; 12) J.Kastrati, vep e cit, f.170; 13) Dr.M.Marchianò, L'Albania e l'opera di Girolamo De Rada, Trani, 19, f.23; 14) J.Kastrati, vep e cit, f.171; 15) A.Kondo, Flamuri i Arbrit, (Çështja kombëtare), Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1967, f.60; 16) A.Kondo, vep e cit, f.17; 17) Blendi Fevziu, Historia e Shtypit shqiptar 1848-2005, Tiranë:Onufri, 2005, f.7 e cit, f.17; 18) Po aty; 19) O.C.Mandalari, vep e cit, f.10; 20) A.Kondo, vep e cit, f.18; 21) B.Fevziu, vep e cit, f.108; 22) Po aty, f.11; 23) K.Kodra, vep e cit, f.76.

Në poemën "Këngët e Milosaut"

Lirika Deradiane dhe ajo e Letërsisë Gojore Arbëreshe

prof. dr. Vebi Bexheti
Faculty of Languages, Cultures and Communication
South East European University, Tetovo

Edhe në këtë vit jubilar të 200 vjetorit të lindjes së poetit të madh arbëresh, Jeronim De Radës, vepra, ndër më të rëndësishmet e krijimtarisë aq të gjithanshme të tij, ''Këngët e Milosaut", na vjen ashtu, me bukurinë e saj të pashoqe poetike, me freskinë, rininë dhe vitalitetin, siç thotë Ismail Kadare, por jo më e ndrojtur, me fat të keq, e belbër dhe nga një vend i humbur. Kur e kemi parasysh vitin e largët 1963, ky mendim i shprehur i Kadaresë në atë kohë në gazetën ''Drita'', ndoshta ishte i drejtë dhe domethënës, edhe nga fakti se ashtu si shumë vepra të tjera të letërsisë së arbëreshëve të Italisë, edhe poema ''Këngët e Milosaut ''vinte nga një vend që për Shqipërinë e kohës konsiderohej si i humbur. Vendi ku lindi, u rrit e jetoi De Rada, konsiderohej si i tillë, ndoshta edhe në mungesë të njohurive të gjithanshme që kemi sot për botën arbëreshe, jetën e tyre dhe letërsinë që u krijua atje, nga ajo më e vjetra deri në këtë të sotmen. Edhe pjesa e këtij mendimi, se kjo vajzë e bukur dhe e freskët hyri në pallatin e poezisë shqipe si e belbër, e ka shpjegimin e vet, sepse e folmja arbëreshe si varianti i vjetër i gjuhës shqipe që e ruajti formën e saj deri në ditët e sotme, ishte e pakuptueshme për lexuesin shqiptar, madje edhe për disa studiues. Kjo gjuhë mbeti e tillë edhe sot, por falë studiuesve të shumtë të letërsisë shqipe, e sidomos atyre arbëreshë, që këtë gjuhë e përdorin në familje dhe në mjedise tjerë, dhe shumë të tjerëve që e njohën këtë të folme, angazhimet e studiuesve të këtij krahu të letërsisë shqipe, nuk kanë munguar, që nga koha e botimit. Studiues të huaj, arbëreshë dhe të tjerë shqiptarë, këtë vepër e studiuan në aspekte të gjithanshme, edhe pse në disa raste, lirizmi i veprës si elementi më i fuqishëm dhe si përbërës më i rëndësishëm (R. Qosja:108) mbeti nën hijen e analizës së rrafshit të rrëfimit epik, apo edhe të karakterit të fragmentarimit të veprës. Është fakt i pamohueshëm se vepra ka edhe karakter epik, por epizmi i rrëfimit të ngjarjes na vjen pa ndonjë lidhshmëri të mirëfilltë, nga fillimi deri në fund, ngase personazhet e veprës përmes gjuhës, dialogut dhe veprimit, përmes nuancash, tingujsh e emocionesh, veprojnë sipas modelit krijues lirik. Me të drejtë Prof. Rexhep Qosja për fenomenin e karakterit liriko-epik të veprës shprehet: lirizmi i De Radës në paraqitjen e tij është pak a shumë specifik edhe për shkak se përmbushet në kuadrin e strukturave që janë apo hiqen të jenë para se gjithash epike (Po aty, f. 113)

Edhe pse veprimi i personazheve dhe ndërtimi i ngjarjes së veprës që ka synim ndriçimin dhe bëmat e personaliteteve të kohës së ''Motit të Madh" dhe dashurinë e arbëreshit për atdheun e tyre m'atanë detit, elementi epik i veprës, që përmes ngjarjesh historike tenton ta sjell të kaluarën, në kohën kur u shkrua kjo poemë, na vjen më i zbehtë, ndërsa ngjarja, e turbullt e pa ndonjë kontinuitet. Kur dihet se elementi lirik i veprës është shprehje e karakterit të brendshëm shpirtëror, e në këtë rast ashtu është, nuk ka nevojë që për momentet më të errësuara të ngjarjes, fajin ta kërkojmë nga vet autori, i cili në parathënien e veprës së botimit të parë e pat sqaruar se si lindi kjo vepër: Unë derdha në të shumë ëmbëlsi dhe mallëngjim, mbi gjithë të vërtetën duke përshkruar kryesisht ngjarje tamam të mija, pa lexuar asgjë n'atë kohë (Jeronim de Rada, Vepra, Prishtinë 1969, f.42). Ky mendim i De Radës që edhe përputhet me moshën e tij të re, pa ia mohuar edhe talentin e madh dhe gjithsesi edhe njohuritë paraprake të fituara gjatë shkollimit, duhej të shërbente si bazë e shëndoshë për t'i hyrë studimit të poemës, duke u përqendruar fillimisht në konceptimin aq të pasur e të sinqertë me nuanca ngjyrash, tingujsh dhe emocionesh (Po aty,f.43). Nga vet fakti se në këtë mendim të De Radës për veprën e vet, nuk përmendet emri i ndonjë shkrimtari të kohës, apo të më hershëm dhe i veprave të tyre, që ka mundur të jetë inspirues i drejtpërdrejtë për veprën, del se elementi lirik, si shpërthim emocional i botës së tij të brendshme është bazamenti i tij më fuqishëm, mbi të cilin mori shtat kjo vepër, që edhe sot konsiderohet si më e mira e De Radës. Këtë origjinalitet të veprës, që përmes personazhit të Milosaut, Rinës dhe të tjerëve, tregon mes tjerash edhe një të vërtetë historike për fatin e kombit, në një farë mënyre e paraqet edhe Lamartini, i cili pasi e kishte lexuar veprën, i shkroi De Radës se poezia ka lindur në brigjet tuaja dhe po aty duhet të kthehet. Ky mendim, që pothuaj është përmendur

Lirika Deradiane dhe ajo e Letërsisë Gojore Arbëreshe

në çdo studim për këtë vepër, e që jo rastësisht po e përmendim edhe në këtë rast, pa i harruar edhe ato të Hugojt, Mistralit dhe të ndonjë tjetri, duhet shikuar edhe në aspektin nëntekstual. Një vepër që lind në truallin e kombit, si rezultat i frymëzimit të një poeti, që me kohë është larguar nga gjiri i tij, është vetëm rezultat frymëzimi lirik që buron nga thellësia e shpirtit nostalgjik, mbi të cilin vendoset edhe ngjarja e rrëfimit epik. Kjo vepër nga disa studiu¬es u vlerësua si më specifike se të tjerat, edhe nga shkaku se u botua e para, kur poeti ishte i ri, vetëm 22 vjeçar, nga format e komunikimit të personazheve që karakterizohen para se gjithash nga lirizmi i fuqishëm, si rezultat i ndjenjës së dashurisë ndaj atdheut të largët e të robëruar dhe dashurisë si përjetim personal ndaj një vajze të fshatit. Ky gërshetim motivesh që përmes kryepersonazhit Milosau, përcillet te lexuesi, nuk do ishte i plotë, edhe pa gërshetimin e lirizmit të poetit De Rada, dhe atij që vjen përmes vargut popullor arbëresh. Edhe pse autori nuk e përmend në fjalën e vet hyrëse të veprës, ndikimin dhe frymëzimin nga kënga popullore, kjo nënkuptohet kur dihet se De Rada para se ta botoi veprën, u mor me mbledhjen e këtyre vlerave të mirëfillta shpirtërore, që dëshmohet edhe me dorëshkrimet paratekstuale të pjesëve të veprave që u botuan para ''Milosaos'', bashkë me vargjet e shumta popullore arbëreshe, që tanimë i kemi në dorë, të botuara nga prof. Altimari, me titull, ''Këngët e para Milosaut''. Bota poetike e De Radës që përmes fuqisë lirike të tij në vepër, sjell edhe ngjarje me ngjyrim epik, nuk do ishte aq me vlera artistike pa praninë e lirikës popullore, vargjet e së cilës në disa raste i bën pjesë të poemës apo romanit lirik në vargje, siç shpesh quhet poema ''Këngët e Milosaut''.

Disa nga studiuesit e shumtë të kësaj vepre, më tepër merreshin me karakterin epik dhe narracionin e rrëfimit, duke u bazuar në problemin e ndasive klasore dhe tërmetin shkatërrimtar të Shkodrës, përmes të cilit De Rada, siç është thënë shpesh, në "mënyrë' artificiale" ka tentuar t'i zhdukë klasat për t'ua mundësuar martesën e Rinës dhe Milosaut. Ky segment, që gjithsesi zë një vend të rëndësishëm në vepër, mendoj se nuk meriton aq vëmendje, edhe nga shkaku se martesa e dy kryepersonazhëve, para se gjithash, duhej të ishte rezultat i një dashurie të pastër e të sinqertë, që edhe pa tërmetin e përfolur aq shumë, duhej të realizohej, me gjithë pengesat që vinin nga nëna e Milosaut, Zonja e madhe, fundja, një familje e pasur e shtresës së lartë shoqërore, si dukej ajo e Milosaut, princit të Shkodrës, nuk mund ta kishte shtëpinë, sa do e madhe të ishte, të vetmen pasuri. Tendenca për qasje të këtillë pa depërtuar në lirizmin si shenjë funksionale e prirjes së tij (R. Qosja: 107.) poetike nuk i shërben poetit të madh dhe veprës së tij. Edhe dilema se a është Shkodra e sotme qyteti në rajonin e të cilit zhvillohen ngjarjet, apo ndonjë vend tjetër në jug të Shqipërisë, siç duket nuk është me ndonjë interes të një studimit të mirëfilltë shkencor, për ta njohur këtë vepër, që në zanafillën e vet si lirike, e të ndërtuar në mjediset e fshatit të lindjes, Maki. Frymëzimet e poetit nuk do e kishin atë fuqi gati se magjike e as mrekullinë për ndërtimin e ngjarjeve e veprimeve të personazheve të vet lirik, në ambiente të panjohura dhe të pa përjetuara në moshën e fëmijërisë dhe të rinisë. Është e vërtetë se vepra ngërthen në vete ngjarje nga koha e ''Motit të madh'' dhe i kushtohet atdheut të braktisur, tanimë për shkaqe të njohura, por s'duhet harruar se zhvillimet e ngjarjeve bëhen në vende që emërtohen edhe me emra real sipas imazhit të fshatit të tij të lindjes dhe të viseve arbëreshe përreth (M. Mandala, koha, 25 gusht 2014). Arat e kodrinave të buta me vreshta, elbnaja, e ullinj, janë ambienti i vendlindjes së tij, ku poeti e kaloi fëmijërinë. Nostalgjia e studentit të ri për këtë ambient të ngrohtë, kur kthehej në pushimet verore nga Napoli, ku studionte, dhe kujtimet që lidhen me të, janë edhe një dëshmi që e vërtetojnë elementin autobiografik të veprës. Këtë ambient idilik, ku nuk mungon edhe ndonjë toponim, si bie fjala fshati Mbuzat, poeti e përshkruan edhe me vargjet kur flet për natën e mrekullueshme brenda një atmosfere të qetë e të këndshme që poetin nuk e le të qetë edhe në gjumë:

Herë e parë çë u zgjova;
Nga Mbuzati hënza
Mbi det po shkëlqente.
Për së dyti kur u zgjova
Njerëz e kafshë të përgjumur
Ylli s'i vështronte,

Lirika Deradiane dhe ajo e Letërsisë Gojore Arbëreshe

Por premtonte sy për delesh
Netë me fate të mbëdha.
Për së treti kur u zgjova
Hëna kishte rënë, kulloste
Ndonjë ka aty këtu,
Kodrave gjysëm të bardha.
Për së katërti kur u zgjova
Delet tona qenë përhapur
Lumenjve të kaltër.
Mua më zu malli katundit.

Me kësisoj përshkrimesh, vepra përshkohet fund e krye. Takimi i Milosaut në krua me Rinën, dialogu i parë ku lindi dashuria e tyre, dhe shumë momente tjera të ngjarjeve nuk zhvillohen në asnjë vend tjetër, përveç ambienteve arbëreshe. Në mjedise të këtilla gjallëron jeta, vërehen dridhërimat e shpirtit që fshihen prapa tyre, ashtu si edhe ajo botë e madhe pasionesh, ndjenjash, veprimesh e fatesh njerëzore, që flasin për një poezi që vjen nga shpirti i artistit, për një poezi ndjenjash me manifestime të fuqishme lirike. (J. De Rada,Vepra: 38) Ashtu si shumë shkrimtarë të romantizmit shqiptar, edhe De Rada në veprat e veta, e sidomos te "Milosau", është më tepër poet lirik se sa epik, madje edhe atëherë kur temat që i trajton janë epike, shprehet Rexhep Qosja (R.Qosja:108) Rrëfimi në poemat e De Radës, me theks më të madh në ''Këngët e Milosaut'', nuk e tregon botën por Unin. Bota në këto poema në radhë të parë është botë që shihet me sytë e zemrës, shton ai.
Edhe përkimet e elementit të këngës popullore arbëreshe në këtë poemë, së pari duhet shikuar në aspektin e gërshetimit të lirizmit të këtij vargu popullor, me atë të poetit De Rada. Përmes këtij harmonizimi, vepra e tij poetike duket më burimore e autoktone, më e ndjeshme. Personazhët lirikë të poemës dhe ata të poezisë gojore arbëreshe, kanë ngjashmëri në veprimet e tyre, në atmosferën fshatare të dasmës, punimet në vreshta, mbledhjes së ullinjve etj. Edhe në lirikën gojore, ndjenjat e fuqishme të personazheve që shprehen përmes takimeve, frikës se dashuria e tyre do kuptohet në fshat, droja se prindërit nuk do pajtohen për martesë, përgojimet e ndryshme etj., ngjasojnë me lirikën e vargut deradian. Edhe dialogu në krua, mes Milosaut dhe Rinës zhvillohet në këtë frymë:

- Vajzë, më jep ti një pik ujë?
- Sa të duash, ti bir zoti.
- Kuj e bila je ti vashë?
(Këngët e Milosaut)

Siç vërehet, këto vargje ngjajnë me vargun popullor. Togfjalëshin ''një pikë ujë'', me kuptimin e ndajfoljes së sasisë (pak)apo, trajtën e shkurtër të përemrit vetor ''më '', te fjalia: ''bijë e kujt më je ti '', shpesh i hasim edhe në këngët popullore. Të këtilla fjalë dhe shprehje me ngjyrime lirike, të ngjashme me ato gojore, shtrihen në tërë poemën ''Këngët e Milosaut ''. Përmes rrëfimit lirik të vargut të autorit, që shpeshherë na vjen me frymën popullore dhe atij që e sjell vet vargu popullor arbëresh, De Rada e krijon shijen e artit të fjalës të vet poetike, duke bërë që lexuesi, para se ta kuptojë, ta shijojë atë. Këtu edhe qëndron dallimi i kësaj vepre me të tjerat, me përjashtim të ''Serafina Topisë '', edhe pse jo me aq lirizëm të shprehur si te "Milosau" . Përkimet e vargut të De Radës me poezinë gojore shtrihen në rrafshe tematike, strukturore e gjuhësore (R.Qosja: 456) madje, shpeshherë këto ngjashmëri paraqiten si variante me dallime të padukshme. Kënga XXV e botimit të vitit 1847, është gati se identike me një këngë të ''Rapsodive'' të De Radës, të përshtatura në gjuhën letrare nga Zijaudin Kodra më 1957. Në vargjet autoriale të poetit tonë, ashtu rrjedhshëm dhe me tone lirike përmes metaforave të shumta, krahasimit dhe figurave tjera stilistike, ai e

paraqet këngën e vajzave, kushtuar shoqes nuse, në këtë rast Rinës:

Atje lart, kreshtës mbi mal,
atje ish një shesh i madh
ku na kullotnin thëllëzat.
M'u lëshua një petrit,
mori më të bukurën
që nga mesi i shoqeve.

De Rada si një romantik i madh, me përmasë edhe evropiane, përmes subjektit lirik e përshkruan atmosferën kur në shtëpinë e dhëndrit i këndohet nuses, që e krahason me thëllëzën. I tërë ky episod i ardhjes së nuses, paraqitet në mënyrë poetike, përmes kuptimit metaforik të petritit që u lëshua atje ku kullotnin thëllëzat për ta marrë më të bukurën. Ja si duken vargjet e këngës popullore arbëreshe, botuar në ''rapsoditë'' e De Radës :

Këtje lart, këtje për mal
Atje ish një sheshi i madh
tek kullotënjin thëllëzat;
m'u lëshua te një petrit.
Më të hijeshmen e zgjodhi
m'e ngrëjti për qielli.

Siç shihet, nga këto krahasime të lirikës së De Radës dhe të asaj të vargut popullor, autori i kësaj poemë diti të zgjedh vlerat e larta të poezisë popu¬llore për t'i bërë, me shumë pak ndryshime, pjesë e veprës së vet. Vetëm poetët e mëdhenj, siç është edhe, De Rada këto vlera të rralla të shprehura me gju¬hë aq të bukur poetike, i bëjnë për vete dhe bashkë me krijimin e vet në këtë frymë, e ndërtojnë vargun e bukur estetik që reflekton aq shumë efekte poetike dhe lirike njëkohësisht. Përveç përmasës së lirikës në artin e kësaj poeme, të një rëndësie të vecantë për veprën janë edhe figurat artistike,si figura mendimi, rrëfimi epik dhe shtrirja e ngjarjeve me përmasën e kohës dhe hapësirës.(Shih te E. Kabashi:189)

Literatura

-Rexhep Qosja, Romantizmi II, Prishtinë 1984
-Jeronim de Rada, Vepra 1969, Prishtinë 1969
-Jeronim de Rada, Kompleti i veprave, Prishtinë 1980
-Emin Kabashi, De Rada, Poetika e poemave, Prishtinë 2003

Kontributi i Jeronim De Radës në lëmin folkloristik shqiptar

Alma Dema
kandidate për Gradën Doktor në fushën e Antropologjisë

Epoka e Rilindjes shënon pasurim të folklorit, rritje cilësore si në përmbajtje, ashtu edhe në konceptimin e dukurive shoqërore-politike.
Ndonëse fillimet e folkloristikës shqiptare shënohen me botimin e një numri fjalësh të urta nga Frang Bardhi më 1635, është kryesisht gjysma e dytë e shekullit XIX periudha, në të cilën u bë i mundur publikimi i shumë përmbledhjeve me krijime folklorike, të mbledhësve të ndryshëm shqiptarë, por edhe të huaj.
Shqiptarët që u morën me mbledhjen dhe me botimin e folklorit u nisën për vepra të tilla të nxitur kryesisht nga motive atdhetare. Ndër ta përmendim Thimi Mitkon me përmbledhjen folklorike "Bëleta shqiptare", Spiro Dinen me "Valët e detit", Vinçenc Prenushin me "Kangë popullore gegënishte", por edhe Zef Jubani, Shtjefen Gjecovi, Elena Gjika dhe De Rada.
Gjatë periudhës së Rilindjes u shtrua edhe nevoja e njohjes dhe e botimit të kulturës popullore në përgjithësi e të folklorit në veçanti, si lëndë e parë për ndriçimin e shumë problemeve nga e shkuara dhe nga e tashmja. Mbledhja e botimi i folklorit, sipas tyre, do t'i shërbente për të pohuar gjenezën e lashtë e të përbashkët të shqiptarëve si edhe për ruajtjen e vlerave më të qenësishme brenda njësisë etnike.
Nga ana tjetër, sipas rilindësve, folklori ndihmonte në bashkimin kombëtar, zgjonte ndërgjegjen e ronitur, duke e shtyrë popullin në veprime për çlirim nga pushtuesit. Po kështu, folklori shërbente edhe për krijimin e kulturës së re që i duhej atdheut për të arritur çlirimin kombëtar, ashtu edhe për të formuar një shtet të pavarur.
Duke u nisur nga konceptime të tilla, rilindësit e sipërpërmendur jo vetëm që mblodhën nga mjedise të ndryshme, por edhe botuan krijime e vëllime të veçanta folklorike. Ndonjë prej tyre, si De Rada, hartuan edhe trajtesa shkencore me nivel të lartë për kohën. Për herë të parë në historinë e folkloristikës shqiptare u bënë botime të veçanta folklorike. Dolën përmbledhjet e para të folklorit shqiptar, të cilat iluministët e Rilindjes i çmonin jo vetëm për vlerat artistike letrare, por edhe si mjete për mësimin e lëvrimin e gjuhës amtare, për afirmimin e kulturës kombëtare shqiptare dhe për ngritjen e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve. Kështu, Jeronim De Rada, është ndër ata arbëreshë, që është ndalur kryesisht në mbledhjen, seleksionimin dhe botimin e përrallave arbëreshe të transportuara nga ta pas "braktisjes" së atdheut e të ruajtura me fanatizëm, sidomos nga gjyshet. Njëra nga to ishte edhe gjyshja e De Radës, e cila jo vetëm e brumosi me idealet kombëtare ndërmjet personazheve shqiptarë e toponimisë shqiptare, por edhe e ushqeu me ndjenjën e estetikes, të së bukurës. De Rada, në veprën Antologji shqipe (1895), flet për rëndësinë e përrallave në zhvillimin e fantazisë së fëmijëve, për përmbajtjen si pasqyrim i jetës dhe shpirtit të popullit. (Sipas N. Berisha, Anton, Parathënia e Antologji e Përrallës Shqipe, Rilindje, Prishtinë, 1982, fq. 7).
Për De Radën, disa nga përrallat janë vlera të rralla artistike të fantazisë popullore, janë drama të vërteta, përmes të cilave gjeniu popullor pasqyron për bukuri marrëdhëniet njerëzore e fisnore, reflekton psikën dhe botëkuptimin e njeriut tonë në periudhat më të lashta, luftën e tij gjatë shekujsh kundër fuqive regresive natyrore dhe shoqërore. Lloji kryesor i bukurisë është drejtësia (e dreqja), e cila i përngjan dritës, që shtrihet pa caktime e kufi dhe përhap kudo gëzim. (De Rada, Jeronim, Parime të Estetikës, përgatitur për botim Uçi Alfred, Globus R, 2003, fq. 70)
Zef Skiroi, Jeronim De Rada, Spiro Dine, por edhe Thimi Mitko, si edhe shumë patriotë e studiues të tjerë, i kanë mbledhur përrallat e vëllimeve e të studimeve të tyre, jo drejtpërdrejt në terren, por të treguara nga persona të dytë apo të tretë, në një vend tjetër larg Shqipërisë, arsye kjo e krijuar për shkaqe ekonomike apo politike, ashtu si rasti i gjyshes së De Radës. Kam përshtypjen që një veprim i tillë, diku mund të ketë lënë vend edhe për ndonjë devijim të autoktonitetit dhe të përshtatjes me vendin apo kohën ku është treguar. Si shembull të kësaj mund të sjellim materialet e mbledhura nga Dine.
Në përmbledhjet e De Radës, janë botuar përralla shqipe autoktone si edhe italo-arbëreshe. "La Calabria", e kishte qendrën e saj në Monteleone dhe ka qarkulluar në shtyp mes viteve 1888 – 1897. Gjithashtu përmendim, "Vëlla(??)nëria", e cila botohej në Vjenë në vitet e para të nëntëqindës dhe "Fiamuri Arbërit", e drejtuar nga Jeronim De Rada, në të cilën botohej rregullisht rubrika Folklore Albanese. Kryeredaktori i kësaj reviste, A. Kinigo, kujdesej edhe për rubrikën e sipërcituar.
"Fiamuri Arbërit", është revista e parë folklorike shqiptare. Nga 20 korriku i vitit 1883 deri më 15 nëntor 1887, dolën dymbëdhjetë numra të kësaj reviste. I vetëdijshëm për rëndësinë e folklorit, për kulturën e

Kontributi i Jeronim De Radës në lëmin folkloristik shqiptar

popullit dhe për vlerat e tij estetike në përmasa evropiane De Rada, të gjitha materialet folklorike që u botuan në këtë revistë, i përkthente edhe në italisht. (Pllana, Shefqet, Gjurmime albanologjike, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 14 – 1984, Prishtinë, 1985, fq. 11) Në këtë mënyrë i jepte mundësinë e një frymëmarrje tjetër, krijimtarisë së popullit së vet. Një tjetër burim nga ku Ai i mblodhi përrallat ishin gratë dhe plakat e fshatit të tij dhe të fshatrave përreth.

Në vitin 1896, De Rada, do të nxjerrë në botim Antologia Albanese, ku ndër të tjera mes tyre gjejmë disa përralla, të cilat ashtu siç shkruhet në nëntitull (përgjithësisht si në të gjithë punimet e studiuesve arbëreshë, apo të atyre që punuan me arbëreshët) janë të përkthyera edhe në gjuhën italiane. Në parathënie, ai do të shprehet:

"I lëshojmë vendin e parë Përrâlesvet që vijnë nga lashtësia e kohërave, duke sjellë gjurmët e shpirtit të pavdekshëm të popullit, gojët e të cilit kanë bërë që të transmetohen e të tingëllojnë deri në ditët tona. (De Rada, Girolamo, Antologia albanese, Tradotta fedelmente in italiano, Napoli, 1896, Hyrja, fq. 3)

A. Kjinigò, si redaktor i "Fiamuri Arbërit", jep informacione të mëtejshme për mbledhësit, duke respektuar në këtë mënyrë pasaportën e tregimtarit. Përrallat janë përkthyer, besnikërisht, edhe në gjuhën italiane.

Në vitet 1888-1897, revista, "La Calabria, Revista di Cultura Popolare", e drejtuar nga Luigi Bruzzano, në Monteleone, edhe ajo si revista e De Radës, merret edhe me botimin e përrallave arbëreshe.

De Rada dha një kontribut të rëndësishëm e të padiskutueshëm në të gjithë artin dhe kulturën shqiptare, duke vënë themele të forta e domethënëse në filologji, themele që edhe sot e kësaj dite merren si referentë kryesorë në gjykime e analiza me karakter shkencor filologjik.

Dy shekuj me Poetin e Madh Arbëresh

dr. Greta Jani
pedagoge e gjuhës shqipe në Univ. e Durrësit

2014-a me të drejtë është quajtur viti i De Radës, këtij personaliteti e rilindasi të shquar të letërsisë shqiptare që gjithë jetën ia kushtoi çlirimit të atdheut e përparimit të tij. De Rada studiohet në shkollat shqiptare për kontributin e tij në fushën e letërsisë dhe jo vetëm. Në shkollat e mesme ky shkrimtar studiohet e vlerësohet, pasi programet shkollore në lëndën e gjuhës shqipe e të letërsisë parashikojnë analiza letrare e gjuhësore të veprave të tij, veçanërisht të poemave "Këngët e Milosaos" dhe "Serafina Topia".

Mesazhet patriotike të veprave të tij janë tepër brilante, këto jo vetëm për kohën e largët kur janë shkruar veprat , por edhe për faktin, që edhe pse jetoi larg atdheut, ai ndihet aq i afërt e i lidhur me hallet e problemet e tij, gjë që shprehet qartë në vargjet e këtyre poemave.

"Erdh dit'e Arbrit!",- është ky varg i famshëm i kangjelit të pestë të poemës "Këngët e Milosaos", që shekuj më parë De Rada shkroi duke ndezur shpresën e duke ngjallur optimizmin e popullit shqiptar për t'i dhënë fund një jete nën zgjedhë e fillimit të një jete në liri.

De Rada me kontributet e tij jo vetëm në letërsi, por edhe në folkloristikë, gjuhësi e publicistikë shënoi kthesën e madhe, kalimin nga mesjeta në botën moderne, por në Shqipërinë e lënguar e të drobitur nga zgjedha e huaj ai nuk u lexua e u kuptua siç duhej. Ata pak që lexuan veprën e De Radës kuptuan se ajo ishte e ushqyer me gjak arbëresh e luftë në përpjekje për t'i hapur sytë popullit që të mos i dorëzohej të huajit, por të luftonte deri në fund.

Poeti i madh arbëresh qe i pari që i fali gjuhës shqipe një vepër me vlerë poetike të vërtetë. Ai u përkujdes për këtë gjuhë të lënë pas dore, shekuj me radhë të palëvruar, e përpoq që dialektin arbëresh ta ngrejë në lartësinë e një gjuhe letrare. Kjo "përkujdesje" e dëmtoi mjaft veprën e tij, sepse herë-herë mbyti ndjenjën e frymëzimin e bashkë me to edhe thjeshtësinë e spontanitetin. Vetë De Rada e ka pranuar që stili i tij u bë i vështirë.[1]

Poezia lirike ishte më e lëvruara në kohën kur shkroi Jeronim De Rada, pasi ky lloj i përshtatej më shumë gjendjes shpirtërore të njeriut në atë kohë. Ishte shtrati më i mirë ku do të rridhte lumi i ndjenjave të poetëve, për të shprehur përjetimet e brendshme, idealet, brengat dhe ngazëllimin për të ardhmen.[2]

"Këngët e Milosaos" është një nga krijimet më të bukura të poetit, atë e shquan një ekuilibër i brendshëm midis brendisë dhe formës.[3] Po kështu, vargjet e "Serafinës", "Skënderbeut", përmes ritmeve herë të rrëmbyera e herë të shtruara, vijnë e na prekin edhe sot me forcën e ndjenjës së tyre. Me këto vepra De Rada u afirmua si një zë i fuqishëm e i veçantë në letërsinë shqiptare të rilindjes.

Në hyrjen e veprës "Këngët e Milosaos", e shkruar italisht, kushtuar Rafael Zagaresë, miku më i ngushtë i De Radës gjatë kohës që kaloi në kolegj, autori shprehet: *Mora zemër dhe shestova romanin tim dyfish lirik. Unë në të derdha shumë ambëlsi e mallëngjim, mbi të gjitha të vërtetën, tue pas përshkrue, në pjesën më të madhe ngjarje tamam të mija: as kam lexuar kurrnjë gja aso dore* .[4]

Poezia e tij u ndikua nga poezia popullore, por njëherazi edhe nga poezia romantike, ndaj vargjet e "Milosaos", "Serafinës"e "Skënderbeut" mbartin një figuracion të pasur e shumë shprehës.

Metaforat janë mjete të fuqishme stilistike që autori përdor, kur përshkruan natyrën apo gjendjen e personazheve të cilat shkojnë paralelisht me njëra-tjetrën në vargjet e poemës. P.sh.: *nata e zezë, zemrat u drodhën, fytyrat u errën, shiu i butë, mbiu një re manushaqesh* etj.

Figura e krahasimit e ndërtuar me elemente nga natyra shqiptare arbëreshe i ka dhënë një bukuri e shprehësi të veçantë vargjeve të poemave deradiane. P.sh.: *si ato lule qielli, si thëllëza te foleja etj.* Jo rrallë në vargje hasim dhe similitudën apo krahasimin e zgjatur. P.sh.: *Një hare më rodhi kurmit/ si hareja kur te shtrati,mbrëmanet/vajza e ngrohtë ndien për të parëzën sisët që m'i fryhen.*

Edhe oksimoroni është një figurë që kur përdoret nga poeti krijon efekte të bukura poetike, si p.sh.: *zhurmërimë e shurdhër etj.*

Elipsa është një figurë që haset shpesh në vargje. Përdorimi i saj është kthyer në tipar stilformues të autorit. P.sh.: *Gjaku im te Lumi i Vodhit etj.*

Dy shekuj me Poetin e Madh Arbëresh

Një tonalitet e emocion ndryshe i jep vargjeve të De Radës edhe përdorimi i pasthirrmës, si p.sh.: *O qipariz bujarësh!O i bardhë bir bujari!etj.*

Një figurë tjetër mjaft interesante që përfohet në vargjet e De Radës është edhe *paronomazia*. Fjalë që kanë kuptim të ndryshëm, por kanë përbërje tingujsh të njëjtë janë vendosur afër në një varg, si p.sh.: *ndihej, po s'dihej nga ç'anë; yjet e hijet; etj.*

Arti i De Radës nuk është analitik, po sintetik, e që me fare pak kërkon të japë shumë , të bëjë përgjithësime të mëdha figurative dhe ideore, një art që sugjeron më shumë se shfaq.[5] Stili konçiz i tij nuk pranoi mbingarkesat, teprimet. Ai u dallua për një figuracion të zakonshëm të zhveshur nga stolisjet dhe fantazia e tepruar. Me intuitë artistike, thjeshtësi e sinqeritet ai ndërtoi epitete të bukura, si p.sh.: *valët kreshtërore etj*. Specifika apo individualiteti krijues i stilit shfaqet para së gjithash në sintaksë. Mënyra e strukturimit të tekstit, zgjedhja e ndërtimeve, shpërndarja e tyre në njësi kumtuese të qëndrueshme, përbëjnë origjinalitetin dhe individualitetin e atij që shkruan.[6]

Nga zhvendosja sintaksore e gjymtyrëve në vargje është përftuar edhe figura e anasjellës ose inversionit, e cila është në funksion të theksimit të cilësive të sendeve a gjendjeve shpirtërore të personazheve të poemave të tij, Rinës, Milosaos, Serafinës etj. P.sh.: *e bardha shtëpia ime, me të lodhurat të bijat etj.*

Përderisa "Këngët e Milosaos" lindi nga dy pasione të kundërta në vetëdijen e poetit: nga njëra anë dashuria dhe admirimi për bukurinë e atdheut dhe virtytet e bijve të tij, nga ana tjetër dhimbja për robërinë e këtij atdheu të dashur dhe për pabarazinë midis njerëzve, është e natyrshme që një vend të gjerë do të zërë përdorimi i figurës së antitezës. P.sh.: *i lumë - i mjerë, bie, po s'dua të fle,* një nga ndërtimet më të bukura antonimike që shpjegon ndjenjën e madhe të lumturisë e gëzimit të jetës familjare të Milosaos.

Jo vetëm poemat e De Radës, por e gjithë letërsia shqipe e periudhës së Rilindjes ka një ton emocional të ngritur, ndjenjat estetike që e frymëzojnë atë janë të larta.

Ligjërimi poetik i De Radës dallon për një gjuhë të pasur në mjete shprehëse e figura stilistike. Kanë kaluar plot dy shekuj nga lindja e De Radës e ky kolos i letërsisë arbëreshe lexohet me ëndje në gjuhën e dashur shqipe, pasi mesazhet që përcjellin veprat e tij janë tepër frymëzuese.

Ne i jemi mirënjohës këtij njeriu që jetën e punën e tij ia kushtoi zhvillimit e përparimit të popullit arbëresh, të cilin më së shumti e vlerëson si burimin kryesor që ushqeu veprën e tij të madhe, ndaj e nderojmë e vlerësojmë në këtë përvjetor e besoj se kështu do ta vlerësojnë edhe pasardhësit tanë në shekuj.

Shënime : 1) Shuteriqi, Dhimitër, 'Nëpër shekujt letrarë", Në 150-vjetorin e lindjes së Jeronim De Radës, "Naim Frashëri", Tiranë, 1973, f. 158; 2) Shapllo, Dalan, Studime filologjike 4, Disa tipare të romantizmit në letërsinë shqipe të Rilindjes Kombëtare, Tiranë, 1970, f. 63; 3) Kodra, Klara, "Studime për letërsinë shqiptare I", Poemat e De Radës, Tiranë, 1981, f. 196; 4) Kastrati, Jup, Parathënie, "Poezi shqipe të shekullit XV", Kangë të Milosaut bir i sundimtarit të Shkodrës,Tiranë 1956, f. 13; 5) Shuteriqi, Dhimitër, 'Nëpër shekujt letrarë", Në 150-vjetorin e lindjes së Jeronim De Radës, "Naim Frashëri", Tiranë, 1973, f. 157;; 6) Shkurtaj, Gjovalin, "Pesha e fjalës shqipe", UFO Press,Tiranë, 2009, f. 19.

Shenja të paramodernizmit në "Këngët e Milosao-s"

dr. Alisa Velaj
Universiteti "A.Moisiu", Durrës

Termi 'modernizëm' mendohet se ka origjinën në shekullin e 17-të në mesjetë, ku zhvillohej një debat midis asaj që quhej "antike" dhe asaj që quhej "moderne" në Angli, apo midis klasikes e romantikes në Francë e Gjermani.[1] Prej atëherë ky term është përdorur në konotacione të ndryshme dhe është trajtuar në këndvështrime befasuese. Poeti Jeronim de Rada është bir natyral i komunitetit të vogël arbëresh Maki të Kalabrisë, që kishte tradita, doke e zakone të ruajtura plot fanatizëm prej shekullit të 15-të. Njëkohësisht, ai ishte bir kulturor i Italisë në kohën e Rilindjes së dytë (1815-1871), kur një lëvizje politike e sociale do të konsolidonte shtete të ndryshme të gadishullit Apenin në një shtet të vetëm të Mbretërisë së Italisë.
Në studimet e deritanishme poema *"Këngët e Milosaos"*, vepra më e njohur e De Radës, është parë thjesht në një këndvështrim romantik, si në suazën e romantizmit shqiptar, ashtu edhe në atë të romantizmit europian. Krahas romantizmit, do të kërkojmë edhe shenja të modernizmit në poemën epiko-lirike, ose në këtë roman *"dyfish lirik"*, siç e cilëson vetë De Rada. Pranimi i romantizmit "nuk cënon aspak" zbulimin e shenjave të modernitetit nëpër tridhjetë këngët e kësaj poeme, sepse, siç shprehet nobelisti Oktavio Paz: "*mes traditës dhe modernitetit ekziston një urë, kur ato janë reciprokisht të izoluara: tradita amullon dhe moderniteti avullon; kur ato lidhen me njëra-tjetrën, moderniteti i jep jetë traditës, ndërsa kjo e fundit i përgjigjet me thellësi e rëndesë"*.[2]

Ndikimet letrare te De Rada

Poeti më madhor i Rilindjes sonë e boton për herë të parë veprën më 1835, ndërsa e risjell të përpunuar më vonë edhe në tri variante të tjera. Romantizmi italian ishte në këtë periudhë në kulmin e tij. Dy përfaqësuesit më të mëdhenj të këtij romantizmi, Giacomo Leopardi dhe Alessandro Manzoni, ishin njëri në fundin e krijimtarisë së tij (Leopardi shuhet në Recanati më 1837) dhe tjetri Manzoni në kulmin e krijimtarisë së tij letrare.
De Rada, krahas ndikimit prej folklorit e kulturës arbëreshe, ndikohet gjithashtu fuqishëm edhe nga krijimtaria letrare e këtyre dy poetëve të mëdhenj. Nëpër vargjet e poemës "*Këngët e Milosaos*" ndihet fryma kristiane, që vjen më tepër si një frymë e thellë humanizmi dhe aspak dogmatike, me ndryshim rrënjësor nga "*kultura dhe morali i kohës që kishin mbetur të palëvizshëm përreth një morali katolik, pa mundur të ndante kulturën (sipas modelit të pjesës tjetër europiane) nga letërsia e katolicizmit, duke iu nënshtruar një trashëgimie dogmatike dhe e vendosur të refuzojë çdo lloj ndyshimi të bashkëkohësisë, çdo eksplorim në fusha të reja kërkimi, të misterit, të panjohshmes, inkonshi*t.[3]
Kjo frymë kristiane nëpër vargje me këtë lloj ngjizjeje e afron së tepërmi De Radën me Manzonin.
Tek Alessandro Manzoni, "Dhurojua të tjerëve":
"*Dhurojua të tjerëve dritën që nuk ke,/forcën që nuk zotëron,/shpresën që ndjen të luhatet në ty,/besimin që të mungon./Ndriçoi nga errësira jote./Pasuroji me varfërinë tënde./Dhuro një buzëqeshje kur ke dëshirë të qash./Prodho harenë e stuhinë qe ke Brenda./"Ja, atë që s'kam ta dhuroj"./Kjo është parajsa jote…*".
Në poemën e De Radës:
"*Si ajo që iku/edhe rron përtej,/kështu rrojmë ne pas vdekjes."*(Kënga XIII)
"*Si ai që një yll të qetë/sheh e zemrën ia ngroh,/yll që thotë: "Vështromni dritën,/bota nuk do të shkallmohet-,bardhëllore unë e pashë.*"(Kënga XX)
"*O! Gjer t'ikin këto ditë/e të hyj ndër yjet,/të të shquaj e përdorëz,/larg prej shpitrave të tjerë/më ne të mos ndahemi?"*.(Kënga XXV)
Nga vargjet e mësipërme krishtërimi nuk ka kurrfarë lidhje me dogmën, ai vjen si humanizëm i thellë, dashuri e pafund dhe shpresë për njeriun e zhytur në errësirën e jetës dhe të fatit të tij. Përtëritja ose rilindja e çdo gjëje që mbaron njëherë e mandej shfaqet sërish është e pranishme që në tri vargjet e para të Këngës së parë të Milosaos ("*Bota kish ndërruar lisa/uji i ri në det/kaltëronte/n'ditn e re"*) dhe del herë pas herë në

vazhdimin e këngëve, ku shumica e ngjarjeve ndodhin *të dielën menatë, mbrëmjen e Shën Mërisë ose natën e Pashkëve.*

Giacomo Leopardi është poeti i dytë, prej të cilit De Rada është ndikuar edhe më tepër, por jo në kuptimin e krishterë, pasi Leopardi vjen si një mohues i qiellit dhe një pesimist i pandreqshëm. Leopardi ishte një përjashtim i kohës së tij. Ai sjell një lloj poezie me një gjuhë të thukët, ku çdo varg ndihmon në procesin e krijimit *të imazheve të zhveshura të pikëllimit*, ose si do të shkruante një shekull më vonë Ezra Paundi në manifestin e tij në formë nenesh: "*Shmangia e fjalëve që nuk ndihmojnë paraqitjen e imazhit*".[4]

Imazhet moderne poetike

Krijimi i imazheve në poezi e bën Jeronim De Radën një modernist të vërtetë në letërsinë shqipe. Studiuesja Helena Grillo nënvizon praninë e narracionit lirik në poezinë e poetit arbëresh: "*...Te Këngët e Milosaos përshkrimi poetik, ndonëse hëna e ylli marrin statusin e simbolit, vjen i ndryshëm në rrjedhën e ngadaltë të natës, si rezultat i aktit soditës dhe të lëvizjes kohore"*.[5] Krijimi i imazheve dhe akti soditës justifikojnë kështu plotësisht fragmentarizimin e poemës në 30 këngë, të cilat nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën, edhe pse personazhet janë të njëjta. Përshkrimi në këto këngë shndërrohet (krahas përshkrimeve romantike) jo rrallë herë në përshkrime simbolike. Ndaj dhe gjuha është tepër eliptike dhe poema vjen e fragmentarizuar, pasi ajo rrok si në poezinë simboliste dhe më pas në lirikën moderne, thelbet e dukurive, ngjarjeve e veprimeve.

Kjo shihet në "*Këngët e Milosaos*":

"*Luleja e çelur/një të hëne plot hare,/t'enjten, duke u bërë e bardhë,/ku ta dish a e sheh të dielën*". (Kënga VIII)

"*se ti dole në katund/posi vera në tryezë/e mbi dhe njeriu me fjalë"*(Kënga XIX)

"*vafsh si një yll që dritën/nuk e bjerr udhës së tij*" Kënga XIII)

Poezia moderne ka zanafillën në letërsinë e vjetër greke e romake dhe në Bibël, psalme. Psalmet janë himne kushtuar Zotit dhe jo rrallë poezia e kësaj poeme ofron adhurime të Hyjnisë, edhe në çastet e humbjeve familjare (*në vdekjen e djalit e të Rinës*). Përveç këtij ndikimi poezia e De Radës ka edhe një lloj mahnitje ndaj botës apo *jetës* , sikurse quhet në gjuhën arbëreshe. Këto mahnitje janë ndikime të një romantizmi të pastër, por njëkohësisht edhe të poezisë antike greko-romake, ku njerëzimi në kohën e fëmijërisë shpreh një lloj mahnitje ndaj dukurive të pashpjeguara dot me logjikën e njeriut bashkëkohor. Mirëpo "*kjo pataksje*" në poemën "*Këngët e Milosaos*" e ka burimin në procesin e soditjes, një tjetër shenjë e modernizmit te ky poet, me rrënjë në klasiken greko- romake dhe në traditën arbëreshe. Kjo vërehet edhe në paralajmërimet e ëndrrave ose në pikturimin e peizazheve të natës, të pranishme sa në romantizëm, aq edhe në lirikën moderne. "*U pataksa e ruajta jashtë:/rusht', pak aguridhe, dheut tonë i kishin hie/lule liu të hapura/n'I tund era e i përzien,/në atë ninullë qeshin;/si ato lule-qielli"*. (Kënga I)

De Rada te poetët e sotëm

Jeromin de Rada është prijatar i lirikës sonë moderne dhe ndikimi i tij vërehet te poetët bashkëkohorë arbëreshë, si Buzëdhelpri, Belmonte, Cukaro, Di Modika, sidomos te një poete e shkëlqyer e narracionit lirik Enza Skutari.

De Rada:

"*Fryu era e maleve/dhe rrëzoi hijen e lisit*"

Enza Skutari:

"*Do t'isha/ si dheu/ i lagur ka shiu/çë buron ahten/me lule e dushk të njomth"*.

Metafora brilante e hijes së lisit, me dramën e humbjeve dhe gazin e përtëritjeve, ndikon drejtpërsëdrejti në poezinë e Skutarit, si trup a asht. Kjo hije ndikimi e Jeronim de Radës në rrokjen e thelbeve të dukurive, përmes fare pak vargjeve, me shfrytëzim maksimal të nëntekstit, *por jo në frymën kristiane,* ngërthen pjesën më të mirë të lirikës shqiptare të arbëresheve të Italisë që nga botimi i librit "*Bubuqe t'egra*" të Dushko

Shenja të paramodernizmit në "Këngët e Milosao-s"

Vetmos deri në ditët e sotme. Tek kjo prurje, pajtimi me humbjen, si kalim i jetës në një tjetër dimension në poemën deradiane, shndërrohet te brezinia e ardhshme e poetëve në dramën e kontrasteve, ose siç e quan studiuesi Sadik Bejko " *ankthi si në prag apokalipsi*".[6] Bashkëkohësia solli kriza të thella në identitetin e qenies, ku jo rrallë hapësirat qiellore blasfemohen hapur. Në këtë kontekst ngre krye hija e poezisë leopardiane.

Ky ndikim i De Radës vërehet edhe te një tjetër lirik tejet modern si Frederik Rreshpja, ku soditja përmes mahnitjes dhe roli i imazheve plazmohen në një mrekulli, sa lexuesit i faniten fluturimet flurore të Lumbardhës së Anakreontit, pa hetuar në është në ëndërr apo në zgjëndërr.

"*Flenë fluturimet mbi drurë/flenë rrufetë në thellësi të reve;/Fusha ul supin te era.Gjithkush e ka një dhembje ku të mbështesë kryet./Gjithkush e ka një mall që vizatohet si vinjete mbi gjumin e botës"*.(Natë)

Si përfundim, të citojmë sërish poetin meksikan Oktavio Paz: "*Ne e ndjekim modernen në metamorfozat e saj të pafundme dhe përsëri nuk arrijmë ta fusim në kurth. Ajo na ikën gjithmonë: çdo takim me të përfundon në arrati.*"

Kështu e përjetojmë ne sot edhe hijen e lisit arbëror të De Radës.

Shënime: 1) "Eksperimentalizmi dhe modernizmi", në "Rrugëtim në letërsinë e unit në krizë", leksione për letërsinë e huaj të shekullit të njëzetë, pj.1, përgatitur nga Natasha Lushaj, SHB "Albas", Tiranë 2009, f.30; 2) Oktavio Paz, "Ç'është moderniteti?", revista letrare "Metafora", nr 2, LSHK, Prishtinë, 2013, f.34; 3) "Poezia italiane, gjysma e parë e shekullit të njëzetë", në "Rrugëtim në letërsinë e unit në krizë", leksione për letërsinë e huaj të shekullit të njëzetë, pj. 1, përgatitur nga Natasha Lushaj, SHB"Albas", Tiranë 2009, f.145-146; 4) Po aty, f.265; 5) Helena Grillo,"Metafora konceptuale në poezinë e Esad Mekulit", kumtesë në takimin letrar "Esad Mekuli", LSHK, Prishtinë, 17 dhjetor 2014; studiuesja Helena Grillo arrin në këtë përfundim teksa analizon të tilla vargje në poemën "Këngët e Milosaos"; 6) Sadik Bejko, Përtej një apokalipsi, SHB "Panteon", Tiranë, 1999, f.13.

Gramatika e De Radës e publikuar me autorësinë e Zef de Radës

dr. prof. Imri Badallaj
Universiteti i Prishtinës

De Rada - përveç kontributeve të mëdha në krijimtarinë letrare, në publicistikë, në përpjekjet e pandërprera në zgjidhjen e alfabetit të shqipes, në filologji, në mbledhjen e folklorit dhe publikimin e tij - edhe në historinë e gramatologjisë shqiptare zë një vend të rëndësishëm. Sidomos me studimet: *Gramatika shqipe (1847)* në emrin e Kamil de Radës-vëllaut të tij, *Vërejtje gramatikore (1866), Gramatikë e gjuhës shqipe (1870)* në emrin e Zef de Radës (të birit të tij), *Shënime gramatikore (1883), Vëzhgime gramatikore (1884), Vërejtje gjuhësore (1885), Përparime në klasifikimin e gjuhës shqipe (1886), Tipare të gramatikës së gjuhës shqipe (1894)*, *Fryn erë e mirë (1886)* etj., lë të kuptojmë se De Rada pati veprimtari të frytshme edhe në fushën e studimeve gjuhësore. Në këtë segment gjuhësor, ai u kushtoi vëmendje edhe çështjeve të prejardhjes së gjuhës shqipe, duke mbrojtur me argumente shkencore lashtësinë e saj.

De Rada është nga të parët studiues i strukturës gramatikore të shqipes [1]. Në tri veprat gramatikore që hartoi (1847, 1870, 1894) vuri në dukje aspekte të patheksuara dhe të pashkruara më parë nga gjuhëtarë shqiptarë dhe albanologë të huaj. Në veprat e tij gjuhësore shtrohen dhe shpjegohen të dhëna me interes për të folmet arbëreshe. Gjithashtu, bëri përpjekje të pandërprera edhe për një alfabet të përbashkët për mbarë arbërishten.

Në veprimtarinë gjuhësore të De Radës duhet përmendur edhe organizimin e mbajtjes së dy kongreseve gjuhësore të shqipes: i pari më 1895 në Koriljano Kalabro dhe i dyti më 1897 në Ungër.

Duke mos prekur fare segmentet e krijimtarisë letrare dhe të dijes së tij me përmasa të mëdha, në tri gramatikat që ai i shkroi, po ndalemi në pika të shkurtra vetëm në njërën, të cilën e publikoi në emrin e të birit të tij – Zefit, të titulluar: *Grammatica della lingua albanese* me autor *Giuseppe De Rada, Firenze 1870*.

I biri i tij - Zefi, i cili u dallua si poet, De Radës nuk i mjaftonte, ngase shpresonte ta bëjë edhe gjuhëtar, kur dihej fare mirë se ai ishte 17-18 vjeçar dhe në këtë moshë nuk kishte mundësi ta hartojë një gramatikë të tillë. Ç'farë do të thotë, se autorësia s'ka mundësi të mos jetë e vetë De Radës. Këtë gjest ky e bëri për shkak se emrat në gjuhësinë shqiptare ishin shumë të pakët. Prandaj, me emrin e të birit – Zefit, dëshironte ta shtojë edhe një gjuhëtar në filologjinë arbëreshe.

Botimi i kësaj vepre gjuhësore bëri bujë të madhe, që me këtë rast autorit i arritën shumë letra, ku e pagëzonin për një vepër të tillë dhe e kërkonin dijetarë të kohës, që ta kenë sa më parë në tryezën e punës, si: Dhimitër Kamarda, Vinçenc Dorsa, Dora d'Distria, Sami Frashëri, Pjetër Kjara, Hudo Shuhard, Teofil Shtir, Maks Myler, Franc Mikloshiç, Gustav Majer etj.. Pra, kjo *Gramatikë* tërhoqi kërshërinë e autoriteteve më të mëdha shkencore të albanologjisë, të indoevropianistikës dhe të gjuhësisë në përgjithësi.

Libri hapet me një përkushtim për Elena Gjikën, ku shtjellon nevojën që arbërishtja, gjegjësisht shqipja ta ketë një gramatikë, me qëllim të ngritjes së saj përkrah niveleve të gjuhëve të tjera të cilat gjallojnë në Evropë.

Gramatika është e ndërtuar mbi bazën e variantit popullor të arbërishtes, kryesisht mbi të folmet e katundeve: Shën Mitër, Shën Sofi, Maki, Strigari, Vakaric e Mbuzat. Materia e eksploruar nga rapsoditë popullore nga veprat artistike të kohës, siç ishin veprat e Jul Varobobës , të Vinçenc Dorsës, Anton Santorit, Dhimitër Kamardës, Kosta Belushit, Shtjefën Bafës, Grigor Gjirokastritit,, Vangjel Meksit, Rejnholdit etj., nuk mungon, por nga veprat e vetë De Radës dukshëm dominojnë shembujt e vendosur në brendinë e librit. Gjithë kjo literaturë e përdorur me kujdesin më të madh, tregon qartë se mundi i madh, që bëri autori në hartimin e gramatikës, na bindë për seriozitetin dhe kriteret shkencore të ndjekura gjatë hartimit të kësaj vepre gjuhësore. Ajo që bie në sy më së tepërmi, është shfrytëzimi i poezisë popullore anë e kënd ngulimeve arbëreshe.

Gramatika që në parathënien e saj pasqyron idetë dhe motivet që e shtyjnë hartuesin për ta shkruar këtë libër. Kjo parathënie, që shtrihet në dy faqe tregon drejtimet e gjuhësisë shqiptare në kohën e fillimit të Rilindjes Kombëtare, horizontin gjuhësor të hartuesit si dhe prirjet që dominonin në këtë kohë në fushat gjuhësore, të cilat Jeronim De Rada i njihte jashtëzakonisht mirë.

Gramatika e De Radës e publikuar me autorësinë e Zef de Radës

Që në fillim të tekstit, autori i drejtohet lexuesve dhe përdoruesve të librit me këto fjalë: *"Kjo gramatikë e gjuhës sonë, që unë u përpoqa ta hartoj nën drejtimin e tim et., është një përmbledhje e thjeshtë dhe besnike e ligjeve gjuhësore ku vetë kjo gjuhë mbështetet në të folmen popullore të Kolonisë arbëreshe, në të cilat kam lindur. Megjithatë, shpresoj se nëpërmjet saj të dalin në dukje tri gjëra:*

1. Në të folmet e katundeve: Shën Sofi, Maki, Shën Mitër,, Strigari, Vakarico e Mbuzat kemi vërejtur se tiparet më qenësore të italo-arbërishtes janë ruajtur më së miri dhe si të tilla mund ta përfaqësojnë në tërësi arbërishten.

2. Këto tipare tregojnë qartë se mund të vendosen si prijëse për një rregullësi, që çojnë drejt shpjegimeve, që në të shkruar duhet të kemi një variant të arbërishtes, që na duket sa më konsolidues.

3. Përmbajtja e të folmeve të këtyre katundeve ka trashëguar një pasuri gjuhësore shumë më të lashtë se shumë të folme arbërore, të cilat shtrihet në shtatë regjonet e Italisë" [2].

Siç shihet, De Rada mendon se e folmja e këtij regjoni arbëresh gjithsesi duhet të vihet si bazë e gjuhës së shkruar kombëtare. Mirëpo, kundër këtij mendimi është shprehur Pjetër Kjara – një arbëresh fort i ditur, i cili me profesion ishte jurist, por në të njëjtën kohë suksesshëm merrej edhe me publicistikë, histori e veprimtari të mbarë kulturës arbëreshe.

Ky, më 1 maj 1870, i dërgon De Radës një letër, që gjithsesi kjo letër përfaqëson recesionin kritik më të rreptë për këtë *Gramatikë.* Në fillim Kjara e përgëzon De Radën për hartimin e saj, por më poshtë merr lejen t'i bëjë disa vërejtje për idetë e shprehura në të.

Pa dyshim kjo kritikë duhet të kualifikohet si fort parimore kundër mendimit të gabuar të De Radës, që për bazë të gjuhës letrare të merrej varianti i arbërishtes së katundeve të përmendura më sipër. Shkruesi i letrës mendon se kjo e folme me gjithë avantazhet, që mund t'i ketë, nuk është në gjendje të ngjallë tek të gjithë shqiptarët ndërgjegjen kombëtare për t'i bashkuar, sepse ai variant dialektor i arbërishtes, të cilin e propozon De Rada, mund edhe mos të kuptohen në trevat e tjera shqiptare (në Shqipëri e më gjerë).

Së dyti, Kjara nxirrte në dritë një çështje me shumë rëndësi: karakterin luftarak të letërsisë artistike. Së treti, Kjara është ngritur edhe kundër sistemit linguistik të zbatuar nga Dhimitër Kamarda (*Saggio di Grammatologia comporata sulla lingua albanese* e *Appendice al saggio di grammatologia comporata sulla lingua albanese – Sprovë gramatologjie krahasuese mbi gjuhën shqipen* dhe *Shtojcë e Gramatikës krahasuese të gjuhës shqipe*).

Nga gjithë kjo kritikë, Kjara *Gramatikën e De Radës* e cilëson "*si vepër kombëtare e destinuar që të shërbejë si bazë e letërsisë sonë", ndërsa autorin e quan "...kampion të inteligjencës dhe si i tillë me këtë vepër gjuhësore e ka fisnikëruar gjuhën arbëreshe*" [3].

Në *Gramatikën* e vitit 1870, autori bën fjalë për alfabetin, që këtë e ka bërë më së miri te *Abetari*, i cili nuk është libër mësimi për fillestar, por në te jep sugjerime dhe propozime mbi alfabetin, të cilin shqipja në përgjithësi nuk e kishte unik.

Librin e fillon me sistemin vokalik dhe konsonantik dhe me tiparet e tjera të sistemit fonetik të arbërishtes. Është i pari që përdori metodën statistikore, zbatuar kjo mbi shtatë faqe të tekstit. Ky kapitull i Gramatikës lë të kuptojmë se theksat grek nuk janë mjete të mjaftueshme për të shënuar intonacionet e ndryshme, që e njëjta zanore jep në shqipen.

Kuantitetin e vokaleve e vështron edhe si vlerë fonologjike, ngase në italo-arbërishten është e shtrirë në të gjitha të folmet, që sipas nesh kjo është një vlerë e veçantë për mbarë gjuhën shqipe, që për fat të lig, shqipja standarde sot nuk e përfill këtë tipar fonologjik.

Morfologjia zë 85 faqe, që niset me shqyrtimin e emrave, që vëren dy trajta të emrit, njëra që shpreh idenë në vetvete, pa mbarim dhe tjetra që ka vështrimin e shquarsisë dhe e dallon prej tjerash të së njëjtës farë. Për De Radën çdo emër ka dy lakime: trajtën e shquar dhe të pashquarën.

De Rada në këtë *Gramatikë* si njësi një njërrokëshe vë në mënyrën urdhërore foljet: *nga, ec, shko, ha, dil* etj. Për ta mbrojtur tezën e tij të monosilabizmit, ai shtron një varg foljesh njërrokëshe, si: *bar, burr, mish; mat, vesh, vë* etj, që mendojmë se kjo teori e monosilabizmit nuk qëndron për gjuhën shqipe dhe si e tillë

Gramatika e De Radës e publikuar me autorësinë e Zef de Radës

është e lajthitur.

Emrat e pashquar shënojnë llojin e vet dhe janë tema të thjeshta, pa mbaresa karakteristike të nominativit. Klasifikimin e mashkullorëve e komplikon shumë, si kur merre i shpjegon disa emra të cilët marrin mbaresën *–a: ka,* disa të tjerë *–ua: thua,* disa marrin *–mb: krimb,* disa marrin *–k: dushk,* disa *–q: kariq,* disa *–d: grazhd,* disa të tjerë *–r: sqepar* etj.

Të njëjtin kriter e ka ndjekur edhe për klasifikimin e emrave të gjinisë femërore: me *– ua: grua,* me *–e: dele,* me *–i: dhri,* me *-m: frim,* me *–z: miz* etj.

Sistemi rasor përbëhet nga 7 rasa: nominativ, vokativ, gjenitiv, dativ, akuzativ, lokativ dhe ablativ. Emrat mashkullor të pashquar i klasifikon në tri klasa: klasa e parë përmbledh emrat që mbarojnë në *k, g, h: ulk, shtog, krah* etj., si dhe ata emra që mbarojnë me *–a, -e, -i: dra, shi, dhe* etj. Te këta emra zanorja është e gjatë dhe ka vlerë fonologjike, që ky tipar tregon qartë afrinë e gjuhës së autorëve të vjetër gegë.

Klasa e dytë përfshin emrat që mbarojnë me çfarëdo zanore të dyfishuar: *druu, gjii (gjiri)* etj..

De Rada shënon se "pjesëzat: *të, së* përpara emrave dhe përemrave, sikurse edhe përpara mbiemrave me të cilët përshtatet, janë parafjalë, që kanë një kuptim të njëjtë me *di* të italishtes". Mirëpo, në arbërishten e De Radës kjo të elidohet. *Biu ndë zallt detit* (*Mbi një breg të detit* [4]). Sipas kësaj *Gramatike,* emërorja e emrave mashkullorë në trajtën e shquar i ngjason gjinores së saj të pashquar: *vëlla-a*, emërore shquar *vëlla-u*.

De Rada është ndër ata gjuhëtarë që e pranon ekzistimin e gjinisë asnjanëse në gjuhën shqipe,që para tij asnjanësin e pranonin edhe Da Leçe, Ksilanderi, Rejnholdi, Kamarda; kurse, pa të drejtë, e mohonin: Liku, Hahni, Bopi e ndonjë tjetër.

Për këtë segment nominal De Rada shkruan: "Në këtë gjuhë çdo lëndë në sasinë e saj të pambarimtë dallohet me trajtat e tjera të emrave mashkullorë e femërorë, ndërsa: *ujët, valjt, misht* janë asnjanës. Të tillë janë edhe emrat e tipit *të dhiovasurit (të lexuarit), të bardhët*, por edhe *hekur*t [5] "etj.). Emrat diminutiv të gjinisë mashkullore karakterizohen me sufiksin *–th: barith, kripth, pipth, krimbth, mith* etj., ndërsa të gjinisë femërore me *–z: dorëz , delez, vashëz* etj.

Paraqesin interes shkencor edhe shënimet sqaruese të bëra nga autori mbi nyjat në togfjalësha të ndryshëm. Ndërsa, sa i përket përemrave, i kushton vëmendje trajtës së shkurtër përemërore *më* dhe shton: " mund t'i prapashtesohet foljes në mënyrën urdhërore: *Sillmë këtu tim bir (më sjell këtu birin tim)*. Këtë trajtë të shkurtër përemërore e hasim edhe midis rrënjës dhe prapashtesave foljore: *Bëmëni një dhokaniqe (Më bëni një patericë – shkop udhëtarësh*)".

Për sa u takon foljeve, për kohën e ardhme thotë se nuk ekziston, pastaj jep trajtën *kam të ljaanj = kam me la.* Këtë ai e shpjegon me formën: *do të laj,* që nuk është tjetër, veçse një perifrazë, e cila i afrohet së ardhmes. *Gramatika shqipe* e De Radës e botuar më *1870* duhej t'i tejkalonte gramatikat e mëparshme, por kjo ka mbetur më tepër si tekst praktik, sepse klasifikimi i njësive dhe shpjegimet për to, është mjaft i komplikuar, që si duket De Rada, edhe pse poet e shkrimtar fort i madh, si linguist, përkrah vullnetit të mirë i mungonte formimi i duhur gjuhësor.

Shihet qartë, se që në fillim të tekstit nuk figuron alfabeti i përdorur, kur dihet se edhe ky vetë praktikoi disa variante të alfabetit në krijimtarinë e tij të shumëfishtë. Shpeshherë i ngatërron klasifikimet e njësive gjuhësore. Shënimet e shumta në fusnota për një gramatikë, e cila është përdorur edhe për qëllime të mësimit të gjuhës në kohën e tij, nuk të kënaqin. Teoria e monosilabizmit, si argument i lashtësisë, nuk është i qëlluar. Prandaj, me të drejt interpretimet e De Radës në këtë *Gramatikë* Jup Kastrati [5] e konsideron më tepër si lëndë e disiplinës *'Hyrje në shkencën e gjuhësisë'*, se sa një gramatikë që u dedikohet atyre që dëshirojnë dhe kanë vullnet ta ruajnë dhe ta mirësojnë arbërishten.

Shënime: 1) Jup Kastrati, Histori e gramatologjisë shqiptare (1635-1944), Prishtinë, 1980, f. 87; 2) Po aty; 3) Po aty, f. 91; 4) Jup Kaszrati, Studime për De Radën, New York, 2003, fq. 86; 5) Jup Kastrati, Historia e gramatologjisë shqiptare, (1635-1944), 1980, f.91.

Telat e zemrës dhe kandili i shpresës

dr. prof. Agim Vinca
Universiteti i Prishtinës

Buzëdhelpri (Agostino Giordano), Telet e zëmrës. Poezi. "Faik Konica", Prishtinë 2013.

Agostino Giordano, ose Gustin Jordani, i lindur në vitin 1950, në katundin Purçill/ Ejaninë, është njëri nga poetët më të njohur bashkëkohorë arbëreshë. Është autor i disa vëllimeve me poezi, të botuara në Kalabri, në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni, që do të thotë në tërë hapësirën kulturore shqiptare. Librat e tij me poezi Agostini i nënshkruan me pseudonimin "Buzëdhelpri", që është emër letrar i tij. Sikurse pararendësi i tij, bardi i poezisë së sotme arbëreshe, Vorea Ujko, edhe ky zgjodhi si emër letrar një emërtim nga bota shtazore e vendlindjes – katundeve arbëreshe të Kalabrisë.

Gustin Jordani është një poet i veçantë, subtil, lirik, refleksiv, por edhe i angazhuar, kritik e satirik. Ai është njëkohësisht edhe studiues, botues dhe publicist; është njëri nga mbledhësit dhe kultivuesit më të pasionuar të thesarit shpirtëror të arbëreshëve të Italisë, vëllezërve tanë nga gjaku e gjuha, të cilët, edhe pas më se 500 vjetësh vazhdojnë ta ruajnë gjuhën, folklorin, kulturën, traditën dhe kujtesën historike, me një fjalë identitetin e tyre etnik, kulturor dhe shpirtëror.

Nip i Emanuel Jordanit, autorit të "Fjalorit të Arbëreshëve t'Italisë" e i shumë veprave të tjera dhe stërnip i poetit Binard Bilota (1843-1918), Gustini ka vazhduar të ecë me ngulm e krenari gjurmëve të të parëve të tij dhe të traditës së madhe të Rilindjes arbëreshe në përgjithësi, që i dha letërsisë dhe kulturës shqiptare kolosë të tillë, si: De Rada, Dara i Ri, Serembe, Skiroi, Santori e shumë të tjerë; traditë kjo, e cila ende nuk njihet në tërësi dhe që po zbulohet nga dita në ditë, nga studiuesit arbëreshë e të tjerë, në tërë përmasat dhe shkëlqimin e saj.

Nuk mund të mos theksojmë me këtë rast se miku dhe vëllai ynë, Agostini, ka qenë plot dhjetë vjet (1972-1982) kryeredaktor i revistës "Zëri i Arbëreshëvet", kurse nga viti 2002 boton rregullisht revistën kulturore "Jeta arbëreshe", drejtor i së cilës është. Kur përmendim fjalën "drejtor" (italisht: direttore) rëndom na krijohet ideja e një burokrati, që asgjë nuk bën, por vetëm urdhëron dhe që të gjitha punët ia kryejnë të tjerët. Por, jo. Në këtë rast, në rastin e Gustin Jordanit, është krejt e kundërta: ai i bën vetë të gjitha, nga mbledhja dhe redaktimi i materialeve, te përgatitja e revistës për çdo numër me të gjitha rubrikat (poezi, prozë, kritikë letrare, këngë e rrëfenja popullore, fjalor i fjalëve arbërisht etj.) e deri te shpërndarja e revistës te arbëreshët e Kalabrisë e të Sicilisë, por edhe te shqiptarët këndej Adriatikut: në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoni e gjetkë, përfshirë edhe diasporën. Nëpërmjet internetit, por edhe postës klasike.

Nuk është vështirë të konstatohet se kjo është një punë tejet e vështirë, titanike, që kërkon kohë, durim, energji, përkushtim.

Le ta përgëzojmë e falënderojmë, prandaj, mikun e vëllain tonë arbëresh, për punën që bën për të mirën e kulturës arbëreshe dhe shqiptare në përgjithësi.

Dhe tani të kthehemi te poezia, më saktësisht te libri me poezi "Telet e zëmrës", që është temë e kësaj mbrëmjeje. Është një libër me poezi të zgjedhura, në të cilin autori ka përfshirë vjershat e tij të shkruara në një periudhë të gjatë kohore, më se dyzetvjeçare, nga viti 1971 e deri në ditët e sotme. Në këtë libër janë përfshirë poezi nga përmbledhjet: "Hroaza", Castrovillari, 1971, "Hapa mbi kalldrëm", Shkup, 1976 dhe "Bota arbëreshe", Tiranë, 1997; por edhe poezi të tjera, të shkruara më vonë, nën titullin TELET E ZËMRËS, që shkoqitet në ciklet: "Në tregun e gazevet", "Sheshi i heronjvet", "Arbëreshë" dhe "Sytë e prindëvet".

Libri hapet me një fjalë hyrëse të autorit dhe me një parathënie të shkruar nga studiuesi K. Rrahmani; në ballinë ka një pikturë të mrekullueshme surreale të piktorit Mark Shagall, kurse menjëherë në faqen vijuese kushtimin: "Sime shoqe, Terezes / T'mi bilve, Vitorit e Ndonit".

Ky është, të dashur miq, informacioni që m'u duk i nevojshëm ta jap në fillim të këtij promovimi, për autorin dhe librin e tij, për të cilin do të flasin më gjerësisht, në tekstin e tyre të shkruar bashkërisht, studiueset nga Vlora: Helena Grillo dhe Alisa Velaj.

Gjuha paraqet, siç dihet, një nga esencat e poezisë. Gjuha, fjala, ritmi, rima, figura, tingulli, imazhi… S'ka poezi pa gjuhë të kultivuar poetike, të ngjeshur me kuptim deri në shkallën më të lartë të mundshme.

Telat e zemrës dhe kandili i shpresës

Augustin Jordani, ndryshe nga një pjesë e poetëve të sotëm arbëreshë, ka zgjedhur të shkruajë jo në gjuhën standarde shqipe, por në idiomin arbëresh, të pleksur aty-këtu edhe me trajta të shqipes letrare. Edhe pse në rrugën e tij krijuese, shikuar nga ky aspekt, ai ka pasur luhatje, arsyet pse vendos t'i kthehet plotësisht kodit gjuhësor arbëresh, i shpjegon qartë në hyrje të librit: *"Unë zura e botova poezi në fund të vitevet '60 të shekullit të shkuar. Arbërisht. Pastaj provova edhe formën e shqipes së sotme. Gjatë viteve të sprasëm, u prora tek forma arbëreshe, një formë standarde. Sepse kam besë se gjuha e Arbëreshëvet t'Italisë, çë folet ka pesë shekuj e gjymës, është edhe e bëgatë. Dhe shpëtohet mësegjithë ture e shkruar. Jo vetëm ture e folur"*.[1]

Prof. Dhimitër S. Shuteriqi, në pasthënien e veprës "Mili e Haidhia" të Zef Skiroit (botim i vitit 1992), një kopje të së cilës Shuteriqët e trashëguan nga Gurakuqi, evokon fjalët e babait të tij, Simon Shuteriqi, "mësues i shqipes", profesor në Normalen e Elbasanit: *"Lexoje arbërishten, bir. Është si të kuvendosh me Skënderbeun"* .[2]

Përcaktimi i autorit të këtij libri për idiomin gjuhësor të vendlindjes ndodh për arsye letrare dhe socio-kulturore, që lidhen me vazhdimin e traditës së madhe të letërsisë arbëreshe të së kaluarës dhe me dëshirën për të komunikuar më lehtë me arbëreshët e sotëm, sado të paktë që mund të jenë lexuesit e poezisë në radhët e tyre.

Por nuk duhet harruar se duke shkruar në të folme e dialekt, kufizohet numri i lexuesve dhe se në këtë mënyrë privohen nga mundësia e komunikimit me veprat letrare shqipfolësit që nuk e njohin idiomën përkatëse. Të mos përmendim, pastaj, rrezikun e një lloj fosilizimi, për të cilin fliste Gramshi në kohën e vet: kush flet dhe shkruan vetëm në dialekt e jo edhe gjuhën letrare kombëtare "e kupton botën në mënyrë të kufizuar, të fosilizuar e provinciale".

T'i dridhë telat e zemrës dhe ta mbajë gjallë kandilin e shpresës! Kjo është dëshirë dhe ëndërr sipërore e poetit Augustin Jordani.

---

1) Buzëdhelpri/ Agostino Giordano, Dy fjalë të autorit, Telet e zëmrës, f. 5; 2) Dh. S. Shuteriqi, Pasthënie, Mili e Hajdhia, "Buzuku", Prishtinë 1992, f. 109.

Prishtinë, 28. 8. 2014 / Fjalim-paraqitje, me rastin e Promovimit të librit të Buzëdhelprit.

Rreth shumësit të pashquar të emrave në Arbërishte

Manjola Lubishtani, Msc.
Universiteti AAB, Prishtinë

Shumësi i pashquar i emrave në Arbërishte, e cila ngërthen në vete një numër të folmesh që shfaqin ndërmjet tyre variante të ndryshme fonetike, morfologjike, leksikore e sintaksore (Giordano, 2005:9) është konsideruar nga shumë gramatikanë arbëreshë si mjaft i larmishëm. Kryesisht, shumësi i këtyre emrave formohet me anë të prapashtesave dhe ndërrimit të tingujve

Kështu, në *Caratteri e grammatica della lingua Albanese* (1894) **Jeronim de Rada** e klasifikon formimin e shumësit në dy kategori, të bazuara në gjininë e emrave. Ai e sheh formimin e shumësit të emrave mashkullorë më të larmishëm, duke renditur shtatë mënyra të përftimit të këtyre trajtave. Kryesisht, si prapashtesa dominuese të klasës së emrave mashkullorë, De Rada paraqet prapashtesat: **-ra** (*ši-šira, ljuum-ljumëra, miš-mišëra*); **-a** (*dem- dema, krëghër- krëghëra*); **-e** (*diep-djepe*).Përveç këtyre prapashtesave, si një nga mënyrat e formimit të shumësit, autori përmend edhe ndërrimet e tingujve *a* në *e*, *g* në *gj* dhe *k* në *q*, të shfaqura më vete ose njëkohësisht, si p.sh.: *daš-deš, zog-zogj, plak-plekj* etj.; ndërsa emrat, tema e të cilëve mbaron me *–ua,* e formojnë shumësin duke marrë prapashtesën **-ñ** (*-nj): thua-thoñ*.Një klasë të veçantë përbëjnë edhe disa emra (*vëlaa, yll (iil), gjarpër*) shumësi i të cilëve konsiderohet nga autori si i parregullt, term i cili do të haset edhe në gramatikat e tjera, të cilave u jemi referuar në këtë punim.

Shumësin e emrave femërorë autori e sheh më të rregullt e me më pak variante. Kështu, të gjithë emrat femërorë, tema e të cilëve mbaron me *-e* , të paraprirë nga një bashkëtingëllore, e bëjnë shumësin njëjtë si njëjësi: *macce-macce.* Edhe në këtë kategori emrash, De Rada paraqet të ashtuquajturat "forma të parregullta": *deer-dier, door- duar* etj.

Si mjaft të larmishëm, shumësin e emrave të pashquar në arbërishte e konsideron edhe **Luis de Rosa,** i cili në *Elementi di grammatica Albanese* (2005) merr përsipër të trajtojë e të analizojë variantin arbëresh të Molises (një nga shtatë rajonet arbëreshe). Si më të përdorshme, për formimin e shumësit të pashquar, ai paraqet prapashtesat **-ë**, **-a** dhe **-e**: *arbëreshë, pleshta, samare, vende* etj. Si tipar të variantit arbëresh të Molises, De Rosa thekson praninë e prapashtesës **-e** në vend të prapashtesës **-a** në një numër të konsiderueshëm rastesh, p.sh.: libre për libra, *lise* për lisa, *bërryle* për bërryla, *filme* për filma etj.(f. 20). Përveç këtyre tri prapashtesave, autori përmend edhe prapashtesat **-nj, -ra, -ër,** të cilat shërbejnë si mjet për formimin e shumësit të emrave mashkullorë. Kështu, me prapashtesat **-nj** dhe **-ra** formohet shumësi i emrave të pashquar, që mbarojnë me zanore të theksuar: *kalli- kallinj, kërcu- kërcunj, bri- brinj, dhe- dhera, shi-shira*. Këtë rregull duket se e ndjekin edhe disa emra të pashquar, qëmbarojnë me togun zanor *–ua*. Në shumës ky tog transformohet në *-nj* ose *-uoj: ftua- ftonj (ftuoj), pallua-palluoj, thua- thonj (thuoj)*. Këtu autori tërheq vëmendjen rreth formimit, në gjuhën standarde, të shumësit të emrit bri (kafshe)- brirë (kafshe), si formë dalluese kundrejt formës *brinjë- brinjët (e njeriut)*, përkundër trajtave të variantit arbëresh të Molises: *"brinj" për brirë dhe "brinjazë" për brinjë* (fq. 21).

Me prapashtesën -ër e formojnë shumësin pak emra mashkullorë, si: *prind- prindër, shtrat- shtretër, kunat- kunetër, vulla- vullazër.* Brenda këtij grupi, siç shihet, në kalimin nga njëjësi në shumës vihet re krahas prapashtesimit, njëherazi, edhe ndërrimi i tingujve nga *-a* në *-e* që, sipas autorit, është i nëjtë me transformimet e zanoreve në formimin e emrave *plak- pleq, gardh- gjerdhe* etj. De Rosa nuk harron të përmendë edhe formimin e trajtave të pashquara të shumësit, duke ruajtur format e njëjësit, si: *korrës-korrës*. Po ashtu, autori klasifikon si "forma të parregullta" të shumësit emrat: *bir- bij, kalë- kuej. vit- vjet, njari-njerëz.*

Formimin e shumësit të emrave femërorëedhe De Rosa e sheh më pak të larmishëm. Ai i klasifikon në tri grupe format e përftuara të shumësit:
a) me prapashtesën *-a: pulë-pula, shkollë-shkolla.* Në këtë kategori autori thekson, para prapashtesimit, bjerrjen e *ë*-së te emrat, tema e të cilëve mbaron me *-ër* dhe *-ël; dhelpër- dhelpra;* b) duke ruajtur formën e njëjësit: *dhi-dhi, ditë- ditë, lule-lule;* c) në mënyrë të parregullt: *grua-gra, dorë-duor.*

Në këtë mënyrë e sheh të formuar shumësin e emrave femërorë edhe **Emanuele Giordano** në

Rreth shumësit të pashquar të emrave në Arbërishte

Gramatikë Arbëreshe (2005). Ai pasqyron, krahas shembujve për të tria grupet e mësipërme : a) *vashë-a, plakë-a, mbesë-a;* b) fjalë-*fjalë,* bukë-*bukë,* këmbë-*këmbë,* kusi-*kusi;* c) dorë–*duar,* derë-*dyer,* natë-*net* (ky shembull nuk është klasifikuar nga autori si formim me anë të metafonisë, siç ka vepruar me emrat mashkullorë) dhe disa emra femërorë, të cilët përdoren vetëm në numrin shumës, si p.sh.: *gërshërë, Pashkë* (f. 25).

Duke trajtuar veçori të formimit të shumësit të emrave, Giordano ofron një pasqyrë shumëpërfshirëse të një numri të konsiderueshëm të të folmeve arbëreshe. Edhe ky autor radhit mënyrat e formimit të shumësit të pashquar të emrave mashkullorë, duke i klasifikuar sipas kësaj radhitjeje: a) me anë të prapashtesave **-a, -ra, -e, -ë, -j, -nj**: *trim-a, plesht-a, gjëmb-a; viç-ra, mbret-ra, dhe-ra; katund-e, shkëmb-e; fjalor-ë, shqiptar-ë, prind-ë* (këtë trajtë De Rosa e sheh si formim me prapashtesën -ër: *prind-ër*). Brenda kësaj klase autori përfshin edhe disa emra të cilët, gjatë formimit të shumësit, e ndryshojnë togun zanor *-ua* të njëjësit në **-o,** shpesh duke marrë edhe prapashtesën *-e*: *thua-thonj, petkua-petkonj, krua-kronje* dhe *ftua-ftonje* (krs. *ftua-ftonj (ftuoj)* të paraqitura nga L. de Rosa). Po ashtu, Giordano klasifikon edhe prapashtesën **-j** ose **-l** si mjet për formimin e shumësit të emrave, që në njëjësin e pashquar mbarojnë me *-ll, -r: dell-dej (del), akull-akuj (akul), bir-bij (bil),* duke mos i konsideruar si formime të përftuara nga palatalizimi i zanoreve fundore; b) me anë të ndërrimit të tingujve (duke dhënë një klasifikim më të detajuar se autorët e mësipërm):

-palatalizim:*ujk (ulk)-ujq (ulq), zog-zogj;* -metafoni:*dash-desh, cjap-cjep, kal-kuel;* -palatalizim e metafoni: *plak-pleq, mashkull-meshkuj, fillar-fillel;* -palatalizim dhe prapashtesa *-e: varg-gje, lak-leqe* (pa përmendur metafoninë a>e); c) duke ruajtur formën e njëjësit: *gjirí, mësonjës*; d) në formë të parregullt: *njerí-njerëz, vëlla- vëllezër* (edhe këtë trajtë De Rosa e klasifikon si formim me prapashtesën *-ër), djalë-djem, ká-qe, derk-dirq, asht-eshtra.*

Duke marrë si kriter klasifikimi tingullin fundor të emrave asnjanës në njëjësin e pashquar, Giordano përgjithëson formimin e shumësit të pashquar, si formim me anë të prapashtesave: **-a**, kur tema e tyre mbaron me *-r, -rr* dhe **-ra**, kur ajo mbaron me çfarëdo bashkëtingëllore a zanore tjetër: *breshër-a, hekur-a; lëng-ra, djath-ra, shi-ra*.

Të larmishëm dhe të argumentuar me shembuj e paraqet edhe **Gaetano Gerbino** shumësin e emrave të pashquar në *Grammatica della parlata arbëreshe di Piana degli Albanesi* (2009). Ky autor, përgjithësisht, e sheh formimin me anë të mbaresave (duke mos përdorur termin "prapashtesë") **-a, -e, -ë, -nj,-ra** si mënyrën më prodhimtare të përftimit të shumësit të emrave (f. 35). Duke pasqyruar të njëjtat mënyra të formimit të këtij shumësi, ashtu si L.de Rosa dhe E. Giordano, Gerbino ofron një sërë shembujsh e trajtash të reja, që nuk i kemi hasur te autorët e përmendur në këtë punim. Kështu, në kuadër të formimit me mbaresat e përmendura pasqyrohen këto trajta emrash: *gur-ë, vesh-ë, dhëmb-ë, artist-ë; dardhë-dardha, glëmb-glëmba,derr-derra* (krs. *derk- dirq* të paraqitura nga E. Giordano); *dëm-e, gëzim-e, grusht-e; kushëri-nj, glu-nj, ftua-ftonj* (siç e kemi hasur te De Rosa) dhe *thua-thonj/ thonje* (si *ftonje*, formë e hasur te Giordano); *glisht-ra, prind-ra* (kjo trajtë del krejt e ndryshme nga trajtat e ofruara nga De Rosa dhe Giordano, të cilët e shohin si formim me prapashtesën *-ër*, përkatësisht *-ë*).

Trajta të reja emrash pasqyrohen nga autori edhe nëtrajtimin e emrave femërorë, shumësi i të cilëveështë i njëjtë me njëjësin e pashquar: shpi-*shpi*, dele-dele,anë-*anë*; ndërsa, si formime me ndërrime tingujsh hasim këta shembuj: *krushk-krushq, dushk-dushqe, disk-disqe, kungull-kunguj, djall-djej, kunat- kunetë* (dhe jo *kunetër,* siç e kemi hasur te De Rosa). Nuk mungojnë edhe shembuj emrash, të cilët njohin vetëm shumësin, si p.sh.: *të fala, të mbjella, të korra, të vjela,* apo dhe asnjanësit e tillë si: *të ngrënë-të ngrëna, brumë-brumra.*

Në fund, një vëmendje të posaçme Gerbino i kushton shumësit të formuar me prapashtesën *-ra*, i cili shfaqet mjaft i përdorshëm në të folmen arbëreshe të këtij rajoni e që tregon një grup sendesh a njerëzish, ndonjëherë me një kuptim të mjegullt nënçmues: *të ngrënë-të ngrënëra, student-studentëra, mavri-mavrira* (f. 38).

Pasqyrimi i shumësit të pashquar në të folmet arbëreshe nga gramatikanët De Rada, De Rosa, Giordano e Gerbino dëshmon për ekzistencën e larmishme të trajtave emërore mjaft herë të afërta e identike me format

Rreth shumësit të pashquar të emrave në Arbërishte

e shqipes standarde, të cilat janë ruajtur, mbledhur e shkruar me të vetmin qëllim: t'u trashëgohet e t'u mësohet të rinjve një arbërishte e pastër, që mund të përmirësohet e të rrojë më gjatë.

Përmbledhje

Arbërishtja ngërthen në vete një numër të folmesh që shfaqin ndërmjet tyre variante të ndryshme fonetike, morfologjike, leksikore e sintaksore.Duke analizuar gramatikat arbëreshe, të hartuara nga Jeronim de Rada (1894), Luis de Rosa (2005), Emanuele Giordano (2005) dhe Gaetano Gerbino (2009), të cilat përbëjnë edhe korpusin kryesor të vjeljes së materialit teorik e konkretizues në këtë punim, ne shkëputëm një segment të rëndësishëm gramatikor të klasës së emrave, siç është formimi i shumësit të pashquar. Veçoritë e këtij shumësi, mënyrat e përftimit, shembujt konkretizues që argumentojnë trajtat e larmishme emërore, përbëjnë edhe objektin kryesor të këtij punimi. Duke krahasuar trajtat e ofruara, kemi konstatuar se shumësi i pashquar i emrave në arbërishte, përgjithësisht, formohet me anë të prapashtesimit e të ndërrimit të tingujve, mënyra këto që janë cilësuar si mbizotëruese nga të gjithë gramatikanët e përmendur. Larmia e formave të hasura në të folme të ndryshme dëshmon për një fond të pasur të emrave të pashquar, i cili i ka mbijetuar asimilimit gjuhësor e kulturor.

Fjalët kyçe: shumësi i emrave, prapashtesa, ndërrime tingujsh, trajta emërore.

Literatura:

1. Gerbino, Gaetano (2009).Grammatica della parlata arbëreshe di Piana degli Albanesi, Cesena.
2. Giordano, Emanuele (2005). Gramatikë Arbëreshe, Manduria.
3. Rada, Jeronim de (1891). Caratteri e grammatica della lingua Albanese, Corigliano Calabro.
4. Rosa, Luis de (2005). Elementi di grammatica Albanese -Variante Arbëreshe del Molise, Rur.

Metafora konceptuale në poezinë e Esad Mekulit

dr. Helena Grillo
Universiteti "A.Moisiu", Durrës

Në traditën e studimeve letrare ka një sërë trajtesash për veprën letrare të Esad Mekulit. Monografia e Fadil Grajçevcit[1] është studimi më shterues që është bërë deri më tani për veprën e tij. Përgjithësisht, poezitë analizohen sipas strukturës tematiko – motivore, vlerave ideoartistike dhe ndikimeve të ndërsjella nga poetë bashkëkohës. Sipas strukturës tematiko – motivore, atdheu, vendlindja, vatra shqiptare, populli, gjuha shqipe, Kosova e Shqipëria, qytetërimi shqiptar, njeriu e liria e tij kombëtare e sociale janë tema e motive të poezisë së poetit Esad Mekuli.

Në trajtesën tonë do të rrekemi për një qasje tjetër, të patrajtuar më parë, në mbështetje të mendimit se poezia e Esad Mekulit si vlerë artistike qëndron krahas vlerave më të mira të poezisë shqipe të kësaj periudhe. Me këtë rast kemi parasysh një sërë poezish (ato që tradicionalisht janë quajtur poezi peizazhi ose përshkruese: "*Mbramja", "Në mëngjes", "Muzgu në qytet", "Pa titull", " Në liqenin e zanave", " Andrra e vajzës", " Vdekja e ditës", " Idil mbramjeje"*) , që ne i quajmë *poezi konceptuale*, duke kapërcyer dhe periudhën në të cilën janë shkruar, duke lënë të hapur trajtesën për bashkëpërkime në fillesa të modernizmit. Poeti Ali Podrimja[2] nënvizon se '*vetëm në periudhën që u përkasin poezive të viteve të fundit poeti shfaq përsiatje mendimesh e refleksesh'.*

Në poezinë konceptuale përshtatshmëria e fjalëve përdoret më shumë në konceptin fillestar. Në formën ekstreme këto poezi janë quajtur " *të orientuara nga procesi* " dhe nuk vijnë si ekspresive.[3]

Poezia e Mekulit, ndonëse e orientuar nga procesi, vjen tërësisht ekspresive si ngjizje e soditjes, që dinë ta shohin vetëm sytë e poetit dhe formëson vetëm ligjërim poetik.

Sipas akademikut Rexhep Qosjes, "*vepra e Mekulit vjen e vogël për nga vëllimi, por e madhe për nga domethënia, ku janë bashkuar: bukuria e fjalës së poetit; ideja larghedhëse e mendimtarit dhe etika e lartë e Njeriut"*.[4]

Nocioni i metaforës konceptuale

Bukuria e fjalës së poetit dhe ideja larghedhëse e mendimit ngjizen në poezi mes aktit soditës dhe nocionit të metaforës konceptuale. Nocioni "*metaforë konceptuale*" është futur në gjuhësi me lindjen e kthesës kognitive të viteve '80 të shekullit të kaluar, nga gjuhëtarët George Lakoff dhe Mark Johnson. Ata metaforën e vështrojnë të ndarë në dy kategori: në metaforë konceptuale dhe në metaforë leksikore (linguistike). Metafora konceptuale operon në nivel njohjeje, duke aktivizuar lidhje midis fushave të ndryshme konceptuale. Këto fusha më pas janë të pasqyruara gjuhësisht me mjete leksikore.

Aristoteli te " *Metafizika*" pohon: "*....Arti lind atëherë kur, nga një seri përvojash dhe konstatimesh, krijohet një nocion i përgjithshëm në lidhje me objektet e ngjashme*".

Studiuesi Isak Shema poezitë e këtilla të Mekulit i quan përshkruese (*"Mbramja", "Në mëngjes", "Muzgu në qytet", "Pa titull"* etj.), ku dukuritë natyrore gërshetohen me elemente të jetës sociale.

Këtu qëndron edhe vlerësimi për pikëtakime me poezinë e De Radës. Sipas Ramiz Kelmendit ," *jo njëherë e kam vlerësuar e mbivlerësuar, e kam krahasuar dhe kam vënë shenjën e barazimit midis Esadit e De Radës*.[5]

Në vargjet e poemës " *Këngët e Milosaos*":

"*Kur u çova për së pari, / nga Mbuzati hënëza / sipër detit llamburinte. / Kur u çova për së dyti, ylli s'ish duke vështruar / njerzit e bishat që flinin, / por u takste deleve / net me fate të mëdha. / Kur u çova për së treti, / hëna kishte perënduar*…", përshkrimi poetik, ndonëse hëna e ylli marrin statusin e simbolit, vjen i ndryshëm në rrjedhën e ngadaltë të natës, si rezultat i aktit soditës dhe lëvizjes kohore.

Duke u zgjuar, Milosao vëren qëndrimin e ri të hënës, falë aktit të hollë të soditjes, ndonëse gjendja shpirtërore mbetet e pandryshueshme.

Metafora konceptuale në poezinë e Esad Mekulit

Soditja refleksive

Falë aktit soditës, edhe Mekuli shpërthen në përshkrime ekspresive, duke anashkaluar një veçori të poezisë konceptuale, ndonëse e orientuar nga procesi. Te "*Kanga intime"* poeti sodit bukuritë e vendlindjes, duke krijuar e rikrijuar portretin intim, që bashkëlidhet me dashurinë për tokën e popullin e tij:
"*Të sodis - Suedeze e bukur / dhe m'kujtohen syt'e saj / të kaltërt e të kthjelltë si liqeni i Ohrit / ku uji asht i qartë / dhe në të çdo gjë pasqyrohet; dhe shoh flokët e saj / si kallijt e artë t'Dukagjinit / kur nën erë valojnë; dhe buzët e saj / që çelin si gonxhe / tue pështpërit emnin tim…".*
Mes detajeve konkrete, që gjuhësisht vijnë me fjalët *lule* e *fusha,* poeti kalon në metaforën konceptuale:
"Ajo asht lule e njomë
E fushave tona-
Dashunija për popullin tim."
Poezia e peizazhit harmonizon format e soditjes me bashkëpërkime asociative, duke shkrirë lexuesin me krijuesin, çastin krijues me çastin përjetues në një akt soditës. Soditja në këtë poezi vjen si përditshmëri e zakonshme, duke u afruar me vështrimin konkret: *fusha, druj, livadhe, ara të vesueme*. Kjo soditje realizohet gjuhësisht mes detajeve konkrete, duke kaluar nëpërmjet "*ngulmimit në detaje të kulluara realiste"*,[6] në poezinë konceptuale, përmes rrugëtimit të poezisë së narracionit lirik.
Poezia e *narracionit* lirik, si një nga dimensionet e lirikës moderne, zë fill me poetin austriak Georg Trakli. "*Në shprehjen e tij poetike gjejmë vazhdimisht kontrastin ndërmjet kuptimit të parë të fjalës dhe domethënies së saj kontekstuale (e jashtme /e brendshme), me të cilin krijohen zona hijeje që ndërpresin rrjedhën e mendimit. Nje teknikë e tillë organizuese në lirikë sjell devijimin e tipit të ligjërimit poetik nga "vizioni" tek "narracioni".*[7]

Algoritmi i krijimit poetik

Shumica e poezive konceptuale janë si një listë abstrakte , ndërsa drejtim i koncepteve në poezinë e këtillë mund të jetë ideja e gjuhës së përdorur në mënyrë sasiore. Procesi i shkrimit ose algoritmi organizon shkrimin si proces. Megjithëse çdo poemë mund të ketë zanafillën si ide abstrakte, në shumicën e këtyre poezive është shumëllojshmëria e ideve që bëjnë tekstin final. Në këtë koncept konjicioni (njohja) drejton gjuhën.
Kovecses e Szabo i mëshojnë faktit se shpesh haset një lidhje konjitive midis fushës së njohurive (d.m.th metaforës konceptuale), që motivon lidhjet e fjalëve të veçanta në një tekst të dhënë.
Nga pikëpamja gjuhësore metafora konceptuale lidh fjalët: *psherëtimë - gjethe e barit, dënesë – erë ,dielli-u dogj, u trand, zemra u poq* në vjershën "Vdekja e ditës" të Mekulit:
"Dielli n'perëndim
N'zjarrin flakrues
U dogj…
Dhe çdo gja u trand
Psherëtima e gjethit t'barit
dhe d'nesa e prajshme e erës
me pikllim zemrën e poq…"
Poeti nëpërmjet aktit soditës sjell imazhe të mrekullueshme të çasteve të ndryshme me shumëllojshmëri përjetimesh. Ai përshkruan artistikisht, duke përjetuar njëherazi horizonte me bardhësi mëngjesore, që zgjohen duke u përvjedhur në hapësirë si çarçafë të lëshuar në erë. Poeti është krijues artistik i ditës, që gdhin si trup i gufuem femne dhe përjetues i saj si fëmi:
Endem, si fëmi, n'qetësinë mëngjesore
dhe trupin e ushqej me freski
t'barishtave dhe t'erës; (Në mëngjes)
Kalimi i ndërmjetëm nga poezia e peizazhit – poezi e narracionit lirik – poezi konceptuale bëhet përmes strukturimit të disa poezive. "*Në liqenin e zanave*" Mekuli realizon ndarjen e poezisë së narracionit lirik me

anë të kllapës:

(Prindërit e mplakur, vra në pragun e shtëpisë,
Nëna i ka qarë
Dhe motrën me kërthi, të therur, i ka vajtuar
Me një prush fëmijësh në rrugë nga shtëpia e vet
e dëbuar…)

Detajet e kulluara: *Prindërit e mplakur, pragun e shtëpisë, shtëpia e dëbuar,këmbë fëminore, guralecë bardhoshë, ujë i kulluar, ballin e njomë, pishat, bari, syri kaltërosh* realizojnë përshkrime të mrekullueshme natyrore, duke krijuar tablo shumëplanëshe të lidhjeve asociative mes metaforave konceptuale: *prush fëmijësh, këmbë fëminore që mahen me fuqi, ballë i njomë të kthjellohet si thellësitë verore*. Janë këto fusha konceptore që lidhin poetin me fëmijërinë bonjake, që vjen konceptualisht jo si fëmijëri e zakonshme.

Shënime: 1) Fadil Grajcevci, "Vepra letrare e Esad Mekulit dhe kritika e sa"j, IA, Prishtinë, 2013; 2) Esad Mekuli, "Poezi të zgjedhura",Tiranë, Toena, 2006, f.7; 3) Craig Dworkin and Goldsmith,"Against Expression: An Anthology of Conceptual Writing", Northwestern University Press, USA, 2011; 4) Rexhep Qosja," Poet i tokës sonë", Me4) tafora nr. 1, LSHK, Prishtinë, 2011, f.4; 5) Ramiz Kelmendi, Letërsia në Kosovë doli nga mëngët e Esad Mekulit , Metafora nr. 1, LSHK, Prishtinë, 2011, f. 6; 6) Georg Trakli, "Poezia nën shenjën e ankthit", në "Rrugëtim në letërsinë e unit në krizë", leksione për letërsinë e huaj të shekullit të njëzetë, pj. 1, përgatitur nga Natasha Lushaj, SHB "Albas", Tiranë 2009, f.122; 7) Po aty.

“Shqiponja nuk e harron asnjëherë folenë e saj, por fluturon në lartësi”

(Papa Françesku)

Elidon Dodaj, Ma, Phd Cand.
gazetar, nga Tirana

Tiranë, 21 shtator 2014. Akoma nuk kishte lindur dielli (edhe pse koha nuk ishte shumë premtuese atë të Diel shtatori) por rrugët e kryeqytetit ishin mbushur përplotë si asnjeherë tjetër më parë, me njerëz që vinin nga katër anët e Shqipërisë, por jo vetëm. Nga Kosova e Mali i Zi, diaspora, kudo që jetojnë shqiptarë. Pas afro dy dekadash Shqipëria, po vizitohej nga një tjetër Shenjtëri. Ati i Shenjtë Papa Françesku kishte zgjedhur për udhëtimin e tij të parë Apostolik në Evropë kryeqytetin e shqiptarëve. Për ta nisur këtë udhëtim në një nga periferitë e afërta të Evropës, në atë periferi që vit pas viti po ringrihet shpresa e cila për shumë vite ishte venitur nga diktatura, por edhe nga pushtimi shekullorë. Shtigjet janë thyer, barrierat janë hedhur tutje, tashmë duhet vetëm një integrim i mirë për t’iu bashkuar kësaj ecejâkeje në shoqërinë e madhe. Ati i Shenjtë Papa Francesku e kishte lajmëruar që në fillimet e papnisë së Tij se do të shkonte ti takonte të gjithë ato njerëz që jetonin në periferinë e botës globaliste, dhe ashtu bëri. Zgjodhi vendin tonë për ta nisur këtë udhëtim me një nga popujt më të vjetër për nga historia, por më të rinj për nga mosha mesatare.

Ndërsa kishte kremtuar Meshën e së Dieles të 15 qershor 2014, në dritaren e Shtëpisë Apotolike teksa recitonte Engjëllin e TënZot, ndër të tjerë Papa Françesku do të shtonte: “**Me kënaqësi ju njoftoj se, duke pranuar ftesën e Ipeshkvijve dhe të Autoriteteve shtetërore të Shqipërisë, dëshiroj të shkoj në Tiranë, të diel, më 21 shtatorin e ardhshëm. Me këtë shtegtim të shkurtër dua të përforcoj në fe Kishën e Shqipërisë dhe t’i dëshmoj ikurajimin tim një vendi, që vuajti gjatë, si pasojë e ideologjive të së kaluarës”**. Me gëzim po pritej nga Kisha në Shqipëri ky lajm, por edhe ndjenja që përshkonte katolikët shqiptar ardhja e vetë Papës në vendin tonë ishte e pa parashikuar, përtej çdo pritshmërie tjetër edhe nga të gjithë shqiptarët pa dallim feje. Imzot Rrok Mirdita për mediat do të thoshte: “Në nderim të veprimtarisë dhe përkushtimit që ka dëshmuar çdo ditë, për të respektuar dhe inkurajuar njerëzit e thjeshtë, pa ndasi fetare apo status social, nëpërmjet shembullit të jetës së tij dhe veprave në krye të Selisë së Shenjtë, si dhe përzgjedhjen për të vizituar dhe bekuar si kryeqytetin e parë të Evropës, pikërisht Tiranën, kryeqytetin e Shqipërisë, simbol i bashkëjetesës fetare , i një populli besimplotë dhe mirënjohës për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë Selia e Shenjtë”. Ndërsa kryeministri Edi Rama, në një udhëtim pune në qytetin e Durrësit, duke folur mbi arkitekturën, historinë shekullore dhe gjendjen e saj, do ta ndërpriste fjalën duke treguar për mediat lajmin që sapo kishte mbërritur, e thënë nga goja e vetë Papa Bergoglio-s në pallatin e tij Apostolik – **“Po shkoj në Shqipëri**”. Për kryeministrin Rama, i cili para pak kohësh kishte pasur një takim me të në Selinë e Shenjtë po kryej një premtim që Papa i kishte dhënë: Po do vij në Shqipëri! Dhe Papa nuk do të vononte për të konfirmuar praninë e tij në Tiranë: **“Këtë vit është parashikuar Shqipëria. Disa thonë se Papa ka një stil, që e bën të fillojë gjithçka nga periferia. Por jo, pse shkoj në Shqipëri? Për dy arsye të rëndësishme. Së pari, sepse kanë arritur të formojnë një qeveri – mendoni se jemi në Ballkan, eh? – një qeveri bashkimi kombëtar ndërmjet myslimanëve, ortodoksëve, katolikëve, me një këshill ndërfetar, që ndihmon shumë dhe është i ekuilibruar. E kjo është mirë, është harmoni. Prania e Papës u thotë të gjithë popujve: “Mund të punojmë së bashku!”. Unë e ndjeva si ndihmë të vërtetë për atë popull fisnik. Edhe diçka tjetër: nëse mendojmë për historinë e Shqipërisë, nga pikpamja fetare, është i vetmi vend komunist që në Kushtetutë kishte ateizmin. Pjesëmarrja në meshë ishte antikushtetuese. E pastaj, njëri nga ministrat më tha se janë shkatërruar – dua të jem i saktë në shifër – 1.820 kisha: shkatërruar! Ortodokse, katolike… të asaj kohe. E kisha të tjera u shndërruan në kinema, teatër, salla kërcimi… E ndjeva se duhej të shkoja: është afër, bëhet në një ditë”** – teksa kthehej nga udhëtimi disaditorë në Korenë e Jugut.

Avioni zbriti sipas të gjithë parashikimeve. Silueta e bardhë e Papa Franceskut u dukë direkt teksa hodhi një shikim në gjithsinë që i dilte përpara. Kryeministri i vendit së bashku me bashkëpunëtorët e tij, Nunsi Apostolik, Ipeshkvinjtë e Shqipërisë të gjithë ishin aty për ta pritur Atin e Shenjtë. Ndërsa në shtëpitë e gjithë shqiptarëve transmetohej “Live” çdo gjë që ndodhte. Papa u akomodua pak minuta në ambjent të

"Shqiponja nuk e harron asnjëherë folenë e saj, por fluturon në lartësi"

(Papa Françesku)

sallonit të pritjes "Marubi" në Rinas, aeroportin "Nënë Tereza", dhe më pas me një makinë të shërbimit qeveritar u nis drejt Tiranës, jo më shumë se 20 minuta larg. Gjatë gjithë kohës Papa Françesku e ka bërë me dije mikpritjen e shqiptarëve e cila nga nisur nga Aeroporti në rrugët e periferisë së Kryeqytetit, nëpër rrugët ku ka kaluar eskorda e tij duke gjetur përpara entuziazmin e mbi 250mijë shqiptarëve të mbledhur ne Bulevardin "Deshmorët e Kombit" dhe Sheshin "Nënë Tereza" ku do të kremtohej Mesha e Shenjtë. Ndërsa prej disa ditësh kryeqyteti ishte zbukuruar me imazhe që shumë njerëz nuk i kishin parë ndonjëherë; ishin 40 Martirët e kishës Katolike në Shqipëri, të cilët priten që të kanonizohen së shpejti në Altarin e saj. Gjë e cila ishte vënë re edhe nga Ati i Shenjtë pasi gjatë gjithë qëndrimit në Tiranë e dëshmoi këtë si qendresë e Kishës së gjallë të atij sistemi të vetëm ateist të botës (1967).

Takimi i parë, që zyrtarizonte viziten e Shenjtërisë së Tij, u zhvillua në hyrjen e pallatit Presidencial ku Sh. T. Z. Bujar Nishani, President i Republikes, e mirëpriti nën tingujtë e bandës së Forcave të Armatosura, ku për nderim u kënduan të dy himnet respektive. Më pas takimi vijoi në një takim tetë a tetë mes Papa Bergoglio-s dhe Presidentit Nishani, fotografi të rastit, shkëmbim dhuratash, dhe një dedikim lenë për Kombin tonë. Presidenti Nishani do ta falënderonte Atin e Shenjtë për përzgjedhjen që kishte bërë për Vizitën e Tij të parë Apostolike në Evropë pikërisht vendin tonë, këtë vend sa të lasht, si në histori ashtu edhe në besim, vend i cili është themel i dialogimit të besimeve. "**Jam i gëzuar që gjendem mes jush, - në 'tokën e shqiponjave'"** – ka thënë Ati i Shenjtë. **"Ju përgëzoj posaçërisht për një karakteristikë fatlume të Shqipërisë, që duhet ruajtur me shumë kujdes e vëmendje: ... bashkëjetesën paqësore dhe bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve të feve të ndryshme."** Pas dimrit të izoluar e të përndjekjeve, erdhi më në fund pranvera e lirisë. Kisha Katolike, nga ana e vetë, mundi të rinisë jetën normale. Më pas presidenti Nishani i është drejtuar Papa Franceskut: "Ne shqiptarët jemi një popull i vjetër, me vetëdije të fortë kombëtare, kemi një gjuhë po aq të rrënjosur e përbashkuese, tradita e zakone të njëjta, por i falemi Zotit në mënyra të ndryshme. Këtë akt themelor të jetës sonë e kemi bërë gjithmonë në paqe e harmoni me njëritjetrin. Ngrehinën tonë shpirtërore e përbëjnë Krishtërimi me Islamizmi, këto dy besime të mëdha të botës, përkatësisht me Katolicizmin, Ortodoksinë, Muhamedanizmin, synit dhe atë bektashi, të cilat në gjirin e këtij populli të lashtë, bashkautor në ngjizjen e qytetërimeve mesdhetare, dinë veç të dialogojnë." E ndërsa z. Nishani ka parashtruar disa ka çastet më të rëndësishme që Kisha Katolike dhe Selia e Shenjtë është treguar mbështetja më e mirë duke nisur që në kohët e lashta me Papën Klementi, apo Albanin, që frymëzoi "Kuvendin e Arbrit"; Benediktin XV, i cili ngriti zërin kundër copëtimit të tokave shqiptare; Radio Vatikanin me zërin e tij që jepte mbështetje dimrit të erret që kishte kapluar Shqipërinë; Gjon Palin II, ku përtej brigjeve të Adriatikut lutej për popullin tonë, vizitën e tij në Shqipëri në 1993 kur ringriti edhe njëherë Kishën Katolike dhe duke nxitur edhe më tej harmoninë ndërmjet besimeve shekullore këtë vlerë shqiptare.

Pas takimit me Presidentin e Republikes, Ati i Shenjtë i hipur në makinen e tij "Papamobile" ka berë xhiron nga sheshi "Nënë Tereza", në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" duke arritur deri në sheshin "Skënderbe"; kudo duke u pritur nga ovacione të pamasë, duartrokitje dhe brohorima "Papa Françesku" etj. Ka pasur disa momente shumë të bukura kur makina është ndalur dhe janë lejuar disa fëmije të vegjël të marrin bekimin nga Papa, gjë e cila është pritur me shumë duartrokitje nga grumbujt e njerëzve që kishin mbushur qendrën e Tiranës. Rreth orës 11:00 ka nisur kremtimi i Meshës së Shenjtë, një bashkëkremtim me afro 300 meshtarë të ardhur nga e gjithë Shqipëria, por edhe trojet shqiptare, nga misionet katolike dhe nga shqiptarët Arbëreshë. Kremtimi i Meshës është bërë si në Shqip ashtu edhe në Latinisht i shoqëruar nga 100 korist. **Kam ardhë për të sjellë shpresën në Shqipëri dhe të vendos me përmallim "lulen e lutjes dhe të kujtimit falënderues për të gjithë ata ipeshkvij, meshtarë, rregulltarë dhe besimtarë laikë" të cilët gjatë viteve të diktaturës komuniste, "e kanë paguar me jetë besnikërinë e tyre" ndaj Krishtit dhe Kishës.** Kështu është shprehur Papa gjatë Meshës në sheshin "Nënë Tereza", një vend simbolik ky që i është kushtuar **"bijës së madhe dhe të përvujtë të kësaj toke"**. Vite në të cilat, jo vetëm katolikët por edhe ortodoksët dhe myslimanët pësuan "**vuajtje të tmerrshme**" dhe "**persekutime të rënda"**. Shqiponja që gjendet në flamurin

"Shqiponja nuk e harron asnjëherë folenë e saj, por fluturon në lartësi"

(Papa Françesku)

shqiptar qoftë për ju përherë nxitje qortuese "që ta vendosni besimin tuaj përherë në Hyjin, i cili nuk zhgënjen asnjëherë por është gjithmonë përkrah jush, e në mënyrë të veçantë në momentet më të vështira", është shprehur Papa. "**Shqiponja nuk e harron asnjëherë folenë e saj, por fluturon në lartësi** – e këtë frazë papa e shoqëron edhe me ngritjen e krahut të tij drejt qiellit, gjest i cili u shoqërua me një duartrokitje të gjatë – **Fluturoni në lartësi! Ikni lart...duke i hapur zemrat tuaja Krishtit, Hyjit, Ungjillit, në takimin me Hyjin, në takimin mes jush sikurse tashmë po e bëni, dhe me këtë takim i jepni dëshmi gjithë Europës**". Në mënyrë të veçantë, Papa Françesku ju drejtua të rinjve, dhe në një farë mënyre duke imituar Të Lumin Gjon Palin II, e ngriti zërin duke thënë: "**Mos kini frikë ti përgjigjeni me bujarì Krishtit i cili ju fton që ta ndiqni! Në thirrjen meshtarake apo rregulltare do të gjeni pasurinë dhe gëzimin e dhurimit të vetvetes për ti shërbyer Hyjit dhe vëllezërve tuaj. Mos i harroni plagët, por mos u hakmerrni, ecni përpara dhe punoni me shpresën e një të ardhmeje të madhe që ju pret".** Ndërsa pas meshës është rrecituar Engjëlli i Tënzot e pas saj Papa është ndalur disa momente duke thënë: "**Të dashur të rinj, ju jeni brezni i ri i Shqipërisë. Me forcën e Ungjillit dhe shembullin e martirëve, të dini ti thoni jo idhujtarisë së lekut, jo lirisë së rreme individualiste, jo varësisë nga dhuna, në mënyrë që ti thoni po kulturës së takimit dhe të solidaritetit, po bukurisë të së mirës dhe të së vërtetës; po jetës që konsumohet me shpirtgjerësi por dhe besnikëri në gjërat e vogla. Kështu do të ndërtoni një Shqipëri më të mirë, një botë më të mirë"**. Në fund, ju drejtua Virgjërës Mari, 'Zoja e Këshillit të mirë': **"Nisem shpirtërisht në Shenjtoren e saj në Shkodër, që e doni aq shumë, e ia besoj asaj gjithë Kishën në Shqipëri e mbarë popullin shqiptar, në veçanti, familjet, fëmijët e të moshuarit. Zoja ju piftë për të ecur së bashku me Zotin, drejt shpresës që nuk zhgënjen".**

Pas pushimit në Nunciaturën Apostolike në Tiranë, Papa Francesku ka zhvilluar disa takime private me Ipeshkëvinjt e Shqipërisë dhe shqiptarë jashtë saj. Më pas i është drejtuar Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ku ka zhvilluar takimin me përfaqësuesit e besimeve fetare në vend. "Besimi i vërtetë është burim i paqes dhe jo i dhunës! Askush nuk mund ta përdori emrin e Zotit për të shkaktuar dhunë. Të diskriminosh në emër të Zotit është çnjerëzore" – ka theksuar Ati i Shenjtë në krye të këtij takimi. **"Sa më shumë që të jemi në shërbim të tjetrit, aq më të lirë do të jemi! Nuk mund të dialogojmë nëse nuk fillojmë nga vetja e jonë. Do të ishte një dialog fantazëm"**. Shtrëngime duarsh, biseda të shkurta e kanë përfunduar këtë moment afro një orë "të dy skuadrat futbolli", siç ka dashur ta quaj Papa mënyren se si ishin vendosur gjatë bisedimeve. Pas kësaj Papa i është drejtuar Katedrales së Shën Palit, ku e prisnin me qindra klerikë, rregulltarë e rregulltare, seminaristë, të kushtuar, etj. Katedralja e tejet mbushur si një festë në brendësi ka pasur edhe motrat Klarise dhe ato të Karmelit të cilat e kanë festuar së bashku jashtë mureve të manastireve këtë ngjarje të shënuar për tokën tonë. Kanë qënë prekëse dy dëshmitë e Dom Ernest Troshanit dhe Motër Maria Karleta. Papa Francesku, është përlotur kur Dom Ernesti është afruar për ti puthur duart, duke mos e lejuar të ulet dhe e ka shtrënguar në një përmalle duke kujtuar ato vuajte te pashoqë që kleri, por jo vetëm shumë nga shqiptarët e sidomos ato katolike pësuan gjatë rrëgjimit të egër diktatorial komunist. **"Unë kam përgatit disa fjalë për ju, për t'jua thënë sot, por do t'ja dorëzoj Arqipeshkvit që ai t'jua japë juve. Por tani, më erdhi t'ju them diçka tjetër... Në këta dy muaj, jam përgatitë për këtë vizitë, duke lexuar diçka mbi Historinë e persekutimit në Shqipëri. Për mua ka qenë një surprizë: unë nuk e dija se populli i juaj ka vuajtur kaq shumë. Shihet mirë se ky popull e mban ende të gjallë kujtimin e martirëve të tij, të atyre që aq shumë kanë vuajtur! Ajo çka unë mund t'ju them me fjalët e mia, është vetëm ajo çfarë ta kanë shprehur me jetën e tyre, me fjalët e tyre të thjeshta... i tregonin gjërat me shumë thjeshtësi... por me shumë dhimbje!**" Në përfundim duke ju drejtuar dy martireve te gjallë dhe të gjithë të pranishëmve ka shtuar: "**Ju kërkoj falje, pse ju përdora si shembull sot, por të gjithë duhet të jemi shembull për njëri tjetrin. Të shkojmë në shtëpi duke menduar mirë: sot i kemi prekur martirët.**" Momenti i fundit i Atit të Shënjtë për gjatë vizitës së tij njëditore në kryqytetin shqiptar ka qënë në një fshat periferik të Fushë Krujës, Bubq, aty ku ndodhet komuniteti Betania, vepër kjo e laikëve katolikë

“Shqiponja nuk e harron asnjëherë folenë e saj, por fluturon në lartësi”

(Papa Françesku)

në ndihmë të të vegjëlve dhe nevojtarëve. Takimi është zhvilluar në Kishën e Shna Ndout pajtorit të kësaj shtëpie të madhe dhe njëra pas tjetres kanë ardhur edhe dëshmit e themelueses së kësaj shtëpie, vullnetarëve, e deri tek ato që kanë qënë pjesë e jetës e sot vijojnë të jenë fryt i saj. Papa Francesku u është drejtuar të gjithë vullnetarëve që vinin nga të gjitha qendrat bamirëse katolike në Shqipëri: “**Kjo fe që vepron me dashuri, i lëviz malet e indiferencës, të pabesueshmërisë dhe të apatisë dhe i hapë zemrat dhe duart për ta bërë të mirën dhe për ta shpërnda atë. ... me besim për të shërbyer në të varfrit dhe në të braktisurit Jezusin Zot dhe ta lusin Atë në mënyrë që zemrat dhe mendjet e të gjithëve të hapen ndaj së mirës, ndaj dashurisë vepruese, burim i gëzimit të vërtetë dhe autentik**.” Përqafime pafund, fëmijë që këndonin – transmetime Live në të gjitha mediat shqiptare. Deri sa në momentin e fundit kryeministri Rama, ministrat e kabinetit të tij, Nunci Apostolik, Imzot Massafra, Imzot Mirdita kanë përcjellur drejt avionit Shenjtërinë e Tij, duke përshendetur me duar teksa ai largohej për të lënë një ditë të shkruar në Historinë e këtij populli në celeluidët e tij. Dhe jo më vonë se në mëngjesin e nesërm Ati i Shenjtë i është rikthyer Zojës së Madhe në Romë për t’iu falënderuar për atë vizitë shumë të bukur e plotë dashuri të përcjell nga populli shqiptarë. Ndërsa në Audiencën e së Mërkures, e gjithë lutja qe për popullin tonë dhe për atë gjest të bukur mikritjeje që trashëgohet nga brezi në brez. Qindra, mijra artikuj janë shkruar për këtë vizitë, miliona njerëz janë informuar mbi këtë popull të vogël në Ballkanin e zymtë, por aq e madhe është bërë dëshira për ta vizituar këtë tokë martire, sa që qindra telegrame urimi kanë mbërritur nëpër institucionët organizative. E Ati i Shenjtë nuk do të harronte edhe të na kujtonte për 102 vjetorin e Pavarësisë duke iu drejtuar Presidentit te Republikes Z. Bujar Nishani: “**Me kujtime ende të gjalla prej vizitës sime në Shqipëri, po u dërgoj Shkëlqesisë Suaj dhe bashkatdhetarëve tuaj përshëndetjet e përzemërta me rastin e Festës suaj Kombëtare. Duke u lutur që populli shqiptar të vazhdojë ta nxisë të mirën e përbashkët, në solidaritet dhe paqe, po ia besoj të gjitha provanisë së Zotit të Gjithëpushtetshëm”.**

Fehmi Korça, poeti i afërsisë dhe dashurisë

don Lush Gjergji
Vikar Gjeneral i Ipeshkëvisë së Kosovës, Prishtinë

Me Fehmi Korçën jam takuar për herë të parë më 8 qershor 2013 në Grykën e Karadakut, në Dunav, me rastin e manifestimit kulturor "*Trekëndëshi Poetik i Paqes"*. Ishin shumë poetë shqiptarë, nga të gjitha viset e Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi, si dhe nga diaspora. Gëzimi, malli, dhembja, atdhedashuria hetohej në çdo fytyrë, shtrirje të dorës, përshëndetje dhe përqafim. Ishim një familje e madhe dhe e larmishme kulturore dhe shpirtërore.

Karadaku ynë i Idriz Seferit, rezistenca shumëshekullore, ambienti i bukur dhe piktoresk, këtij takimi i jepte kolorit dhe ngrohtësi, zgjonte kujtime, frymëzonte fjalë dhe mendime për të tashmen dhe të ardhmen tonë.

Ndër shumë fytyra të njohura dhe të panjohura ishte edhe Fehmi Korça, që kishte ardhur nga diaspora, Gjermania. Ishte i gjatë, mjaft korpulent, më një buzëqeshje tipike dhe karakteristike, që shprehte dhe dhuronte njëkohësisht gëzim dhe dhembje. U afrua, më përshëndeti dhe më përqafoi ngrohtësisht e miqësisht. Mundohesha ta njihja, por pa sukses.

Më tha: "*Unë jam Fehmi Korça, burri i Elira Halimit, bijës së arsimtarit tuaj të dikurshëm në Zhegër, të ndjerit Hamza Halimit, dhe të shoqes tuaj të shkollës, Bedrije Halimi. Ju mua nuk më njihni personalisht, por unë Ju njoh mirë Juve, sepse jeni për ne fytyrë familjare*".

Pas këtyre fjalëve, mua m'u hapën horizontet e reja. Në mua vlonin shumë kujtime, përjetime, malli, nderimi dhe falënderimi, dashuria. Biseda, shoqërimi dhe takimi ynë vazhdoi tërë ditën, në rrënzën e Dunavit, te kisha e "Shna Prenës", me shumë kënaqësi dhe shmallje. Hetova se ishte shumë i përmallur, i përvëluar nga mërgimi dhe largësia.

Herën e dytë u takuam në Prishtinë në Rezidencën e Ipeshkvisë së Kosovës pranë Katedrales "Nëna Tereze", kur ma dhuroi vëllimin e tij poetik *"Nuk jam larg" Poezi, Waso, Tiranë 2011*. Përkushtimi i tij ishte ky: "*Me shumë respekt për mikun – vëllaun tonë, njeriun që më dashuri mbjell farën e tolerancës dhe mirëkuptimit ndërnjerëzor, Don Lush Gjergjit, nga autori. Prishtinë, me datë 14. 06. 2013"*.

Përshtypja ime ishte që ky njeri diçka po ngutej, po kërkonte dhe rikuperonte. Luftonte me kohën, e cila rridhte pa mëshirë, me hapësira shqiptare, që gjithnjë "zgjeroheshin", si dhe me vetveten. U morëm vesh për t'u takuar së shpejti në Gjilan.

Takimi ynë i tretë ishte në Gjilan, te familja e bashkëshortes së tij, Elirës, për t'u takuar edhe me Bedrije Halimin dhe familjen e tyre. U kënaqëm, u çlodhëm dhe shmallëm me shumë kujtime nga fëmijëria dhe rinia jonë. Premtimi im ishte ky: "*Së shpejti, me rastin e parë që do të vizitoj Gjermaninë, do të vij në Nyrnberg*".

Mirëpo ky takim i paraparë dhe i dëshiruar nuk u plotësua kurrë. Ndodhi diçka e papritur, lajmi që Fehmi Korça kishte vdekur. U shtanga dhe trondita në shpirt dhe në zemër. Me familjen e tij – tonë, që tashmë ishte krijuar, ndjeva dhembje dhe pikëllim të madh, disi një lloj faji që ndodhi gjithçka kaq shpejt dhe në mënyrë të papritur. Më 30 gusht 2013 në varrezat e Gjilanit, para varrit të hapur, miqve të përlotur dhe të përmallur, hetova dhe përjetova thënien: "*Kur zemra është e plotë, goja është e zbrazët*", teksa mbajta fjalën time lamtumirëse, një lloj vazhdimi i takimeve, bisedimeve, dialogut tonë të shkëputur. Tashmë fliste vetëm heshtja, dhembja, loti, shpresa, amshimi.
Fehmi Korça, për mua, është një Njeri, Vëlla, i cili, nëpërmes poezisë shprehu dhe dhuroi ndjenja të pastra dhe të thella njerëzore, patriotike, mallëngjyese me vlera sublime dhe virtyte të lashta dhe të tashme, një testament shpirtëror dhe kulturor për "*gjakun tonë të shprishur*" siç thonë Arbëreshët tanë, kushtuar çdo

Fehmi Korça, poeti i afërsisë dhe dashurisë

shqiptari në tokat tona apo në mërgim. "*Nuk jam larg*" titulli i kësaj përmbledhjeje, mendoj unë, ishte për Fehmiun moto-ja dhe credo-ja e tij, mbi të gjitha, dëshira dhe përcaktimi jetësor dhe poetik, që vërtet të jetë afër, bashkë, një, me çdo njeri vëlla apo motër.

Dhe sikurse të ndihej i robëruar dhe i cunguar nga kufijtë kohorë dhe hapësinorë, ai "shpërtheu" këtë jetë dhe këtë botë, tejkaloi botën e vogël shqiptare dhe tokësore, për ta shijuar dhe gëzuar matanë dhe amshimin. Largësia, mërgimi, malli, jokomunikimi, indiferentizmi, shthurja jonë kulturore dhe shpirtërore, tek ne dhe në botë, gjithnjë e shqetësonin dhe mundonin. Ai ishte "pengu" i mallit, dashurisë, vetmisë, largësisë. Shi për këtë "iku" fizikisht, për të qenë shpirtërisht sa më afër dhe një me ne.

Testamenti i tij "*Nuk jam larg*", na thotë se është afër nesh, me ne, dhe ne me të. Dikur ai në Gjermani, e ne në trojet tona stërgjyshore. Tani ai në amshim, ne ende në këtë tokë dhe jetë.
Komunikimi mes Fehmi Korçen, familjes dhe miqve të tij vazhdon edhe nëpërmjet veprës postume *"Përtej poleve të jetës" Poezi, The Balkans Free Press, 2014,* në redaksinë e Valentina Dafa dhe recenzentit Gentijan Banaj, që është promovuar në Kuvendin Komunal të Gjilanit (28. 04. 2014) , me pjesëmarrje të familjes dhe miqve të tij dhe të poezisë.

Jeta, komunikimi, afërsia, vëllazëria, dashuria vazhdon, kuptohet, tash ndryshe, me fuqinë e fesë dhe të uratës, me frymëzimin e dashurisë. E dogji malli dhe largësia. E rrëmbeu mërgimi dhe vdekja. E pranoi dhe përqafoi amshimi dhe pavdekësia.

Tash unë jetoj dhe komunikoj me Fehmi Korçën nëpërmjet kujtimeve, fesë, uratës, poezisë, miqësisë dhe vëllazërisë posa të nisur, pavdekësisë së amshuar.
Pushoftë në Paqe dhe Lumturi!

Nobelistja shqiptare e Paqes - Nëna Tereze

don Lush Gjergji
Vikar Gjeneral i Ipeshkëvisë së Kosovës, Prishtinë

Më 10 dhjetor 2014 është **35vjetori** i marrjes së Shpërblimit Nobel për Paqe të Nobelistes Shqiptare - Nënës Tereze (10 dhjetori 1979), ditë kjo vërtet e madhe, e dalluar, e bekuar dhe shënuar për të gjithë Shqiptarët në mendje dhe në zemra, sepse Bija-Motra dhe Nëna Tereze është e para shqiptare Nobeliste e Paqes.

Kjo ngjarje befasoi botën atëherë, disa edhe sot, sepse shumë njerëz pyteshin: *"Çka ka bërë Nëna Tereze për paqe në botë?".*

Shumë, gjithçka, sepse e ka shkrirë jetën e saj në mesin e të varfërve ndër më të varfër të botës, për të gërbulur, për njerëz që ishin të braktisur, të shkelur dhe të shëmtuar, duke iu dhënë atyre dinjitetin njerëzor nëpërmjet dashurisë në vepër. Ajo veçmas ishte në mbrojtje të jetës së fëmijëve të palindur, si dhe të atyre që tashmë ishin në buzë të vdekjes.

Më kujtohen edhe sot tri shtyllat, apo edhe tri "përcaktimet" e Nënës Tereze për paqe nga "*Katedra e Paqes*" në Oslo:

- *"Pa dashuri dhe flijim jeta s'ka kuptim"*
- *"Vetëm Dashuria do ta shpëtojë botën".*
- *"Veprat e dashurisë janë vepra të paqes".*

Shtyllat e paqes, sipas Nënës Tereze, janë: pranimi, nderimi, mbrojtja e jetës, prej zanafillës e deri te kalimi në amshim;

Aftësia për të kërkuar dhe dhuruar falje;

Dashuria flijuese dhe dhuruese për Zotin dhe për të afërmin, sidoms për nevojtarë, ata që janë të kërcnuar dhe të rrezikuar, apo siç thoshte ajo "dashuria në veprim".

Dhe vazhdoi kështu: *"Në botën e sotme ka aq shumë vuajtje, urretje, mjerim dhe mu për këtë duhet të fillojmë në familjet tona, në uratë dhe në flijim... Dashuria lind në familje, sepse nuk ka rëndësi çka veprojmë ne, por me sa dashuri bëjmë diçka... Kur marr në rrugë ndonjë të uritur, i jap një pjatë me oriz, një copë bukë dhe ai kënaqet. Ka larguar urinë. Por, ai i cili është i dëbuar, që ndihet i padëshiruar, i padashur, i tmerruar, ai është flakur jashtë shoqërisë. Ky lloj varfërie është aq e rëndë, shumë e vështirë. Në perëndim motrat tona punojnë në mes të këtyre njerëzve... Jemi këtu për ta ndarë këtë mundim, për ta ndarë këtë vuajtje të njerëzve... Pra, ta takojmë gjithmonë njëri-tjetrin me buzëqeshje, sepse buzëqeshja është fillimi i dashurisë...".*[1]

Një kënaqësi plebishitare botërore, sepse ishte shpërblyer Nëna e botës së mjerimit, ajo e cila vërtet kishte merituar këtë titull të lartë, e cila ishte flijuar dhe dhuruar për të mirën e të gjithëve pa asnjë dallim apo përjashtim kombëtar, racor, gjinor, kastor apo fetar.

Lars Roar Langslet, Kryetari i Komisionit Parlamentar për marrëdhënie me Kishë dhe për Shkollim, ndër të tjera dëshmoi: *"Tërë bota e ka miratuar, kësaj here, vendimin e Institutit Nobel, Dhuratën e madhe të Nobelit për Paqe t'i jipet bamirëses së njerëzimit... mirënjohje e dashurisë, mirësisë së tërë njerëzimit, sepse të gjithë njihemi në të. Njerëzimi e vlerëson atë si* NËNË*, si e thërrasin të gjithë; shi me këtë me të vërtetë është vlerësuar njeriu, të drejtat dhe nevojat e tij... Kjo është fitorja e mirësisë dhe e dashurisë... Nëna Tereze është kulminacioni i punës vetëmohuese, i mirësisë dhe i dashurisë...".*[2]

Kryetari i Komitetit të atëhershëm Nobel për Paqe, dr. John Sannes-i, në aereoportin e Osllos, gjatë përcjelljes së Nënës Tereze për kthim në Kalkutë, ndër të tjera theksoi: *"Këtu me të vërtetë nuk dimë se kush ka marrë Dhuratë: ne apo Nëna Tereze? Ne i falënderojmë asaj, që e ka pranuar këtë Shpërblim, dhe kështu e ka ngjitur edhe më tepër vlerën e kësaj mirënjohjeje të lartë... Qysh tani lypset menduar për kandidatët e vitit të ardhshëm. Mbas Shpërblimit të Nënës Tereze do të jetë mjaft vështirë ta gjejmë një personalitet të dimensioneve të ngjashme si Nëna Tereze...Më mirë dhe më thjeshtë do t'ishte që ajo prapë ta fitonte këtë Dhuratë"* (këtë e tha duke qeshur, ndoshta si mahi, vr. ime).[3]

Nëna Tereze e pranoi këtë Shpërblim vetëm në emër të të varfërve, për t'i ndihmuar të varfërit ndër më të

Nobelistja shqiptare e Paqes - Nëna Tereze

varfër, duke vërë në qendër të vëmendjes dy shtylla, shpesh të harruara dhe të ngatërruara, ZOTIN dhe NJERIUN.

Kështu kishte dëshmuar para mbarë botës se *"Dashuria"* do t'i shëronte të gjitha të ligat e botës, sepse do t'ia mundësonte njeriut tejkalimin e kufinjve të kohës dhe të hapësirës, të nacionit dhe religjionit, të kasteve dhe të ngjyrave...

"Receptі" i Nënës Tereze është aq i thjeshtë, gjithnjë aktual, i mundshëm dhe përshtatshëm për çdo njerì: *"Punë të vogla me dashuri të madhe*".

Dhe në mbarim më lejon *"të lundroj"* në kujtime dhe kështu t'ju bëjë edhe juve pjesëmarrës të kësaj ngjarje dhe përjetimin tim të paharrueshëm. Ishte e dielë, 8 dhjetori 1979. Isha në përcjellje të Imzot Nikë Prelës, ipeshkvit tonë (1918-1996). Dolëm për ta pritur Nënën Tereze në aereoportin e Osllos. Me Nënën Tereze ishte edhe vëllau i saj, Lazër Bojaxhiu, dhe bija e tij, Age lind. Bojaxhiu-Guttadauro. Pra, një familje e vogël shqiptare.

Kur na pa dhe u përshëndetëm, me shumë befasi, na pyeti kështu: *"A keni ardhur këtu vetëm për mua?"*.

Imzot Nikë Prela, në stilin e tij hokatar, i tha: *"Jo, por kemi ardhur për t'i parë bukuritë natyrore të Norvegjisë"*.

Nëna Tereze, e gëzuar, me sy të përlotur, na tha: *"Po më vjen shumë mirë që keni ardhur, si t'kishte ardhur Nëna Loke imja e vdekur. Zoti iu pagoftë dhe iu ktheftë me të mira!*"**.[4]**

Ndër temat që i shtronim në biseda të gjata dhe të përmallshme edhe në orët e vona të natës, ishte doemos edhe çështja kudo në botën shqiptare, Kosova, mbi të gjitha Shqipëria.

Ja përgjigja e Nënës Tereze: *"Unë nuk di çka të them, sepse nuk di çka ngjanë atje. Një gjë vetëm e dij: "Unë mund të them vetëm se lutem shumë për Shqipërinë, që Zoti t'iu jepë dritë për të parë se nëse dëshirojnë të jetojnë në paqe, atëherë do ta dojnë njëri-tjetrin..."*.**[5]**

Gjatë Konferencës për shtyp ajo ndër të tjera tha dhe e shkrojiti me dorën e saj në gjuhën shqipe: *"Unë gjithmon e kam në zemër popullin tem shqiptar. Shum luti Zotin qi Pagja e tij të vjen në zemrat tona, në gjitha familjet tona, në gjith Botën. Lutuni shum për fukarat e mi - dhe për mua dhe motrat e mija.*

Unë lutem për juve.

M.Tereza Bojaxhiu, Osllo, 10/7/79".**[6]**

Në pyetjen time: *"Çka domethënë së pari për Ju, për motrat Tuaja dhe për të varfërit Shpërblimi Nobel për Paqe?"*

Nëna Tereze tha: *"Për mua dhe motrat tona asgjë posaçe, asgjë s'do të ndryshojë në Shoqërinë tonë. Kjo Dhuratë, si dhe të gjitha të tjerat, të cilat i ka fituar Kongregata jonë, janë vetëm për të varfëritë tanë... Kjo është si një kontribut i madh i paqes, sepse tekembramja sot bota e ka kuptuar se veprat e dashurisë janë më të rëndësishmet për paqe...Pa dashuri nuk do të kemi kurrë paqe."***[7]**

Nëna Tereze pa dyshim është ajo që, pas Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, e bashkon shpirtërisht dhe kulturalisht kudo popullin Shqiptar, është Ambasadorja e historisë, traditës, kulturës, me shekuj edhe fesë tonë të përbashkët.

Për ne ka rëndësi të madhe jo vetëm nderimi, falënderimi, dashuria ndaj Nënës Tereze, por nëpërmjet jetës dhe frymëzimit të saj, zbatimi i dashurisë për njëri-tjetrin, apo si shprehej ajo bukur: "PËR ZOTIN DASHURI dhe PËR VËLLAUN NJERI".

Ja, e tillë ishte Bija, Motra dhe Nëna e mbarë botës, Nobelistja Shqiptare e Paqes - Nëna jonë Tereze!

Prishtinë, 10 dhjetor 2014

---

1) Gjergji dr. Lush, Nëna jonë Tereze, botimi i dytë, Drita, Ferizaj, 1990, fq. 201-205; Më gjerësisht lexo fjalimin e Nënës Tereze në Oslo, 10 dhjetor 1979, me rastin e marrjes së Çmimit Nobel për Paqe, fq. 196-205; **2)** Po aty, fq.213; **3)** Po aty, fq. 213-214; **4)** Gjergji dr. Lush, vep. e cit. fq. 208; **5)** Drita 12/1979, fq. 8; Më gjerësisht lexo: Drita, Po aty, fq. 1-9; **6)** Po aty, fq. 9; **7)** Gjergji dr. Lush, vep. e cit., fq. 290.

Seminari XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare

(Prishtinë, 18-30 gusht 2014)

Simbjet, te Seminari XXXIII Ndërkombëtar i Prishtinës, i drejtuar ka prof. Bardh Rugova, **Arbëreshët çë mbajtin ligjërata, referime o kumtesa** qenë: *Emilia Conforti & Aliula Jubani* (Shkrimtarët Italianë për romanin "Gjin Bardhela i arbresh, Etja e gurëzuar"), *Francesco Altimari* (Jeronim De Rada dhe roli i tij në Rilindjen Arbëreshe dhe shqiptare – në 200-vjetorin e lindjes), *Antonio Bellusci* (Letërsia gojore te Arbërorët e Greqisë), *Agostino Giordano,* drejtori i J. A. (Domethënia e fjalëve "lirì, pavaresì, demokracì…" në veprën poetike të Vorea Ujko-s).

Ishin edhe te tjerë Arbëreshë në program (si Francesco Fusca e Giovanni Belluscio), po s'erdhën fare.

Bashkëpuntorët shqiptarë (të vjetër dhe të rinj) **të"Jetës Arbëreshe"**, çë morën fjalën në Seminar, qenë: *Aleksander Novik* (Personazhet mitologjike ndër shqiptarët e Devollit: paralele me traditën e shqiptarëve te Ukrainës), *A.Novik&Russana Beyleri* (Shqiptaret e fshatit Mandrica të Bullgarise: shkenca dhe ideologjia), *Imri Badallaj* (Kontributi i De Radës në gramatologjinë e gjuhës shqipe), *Manjola Lubishtani* (Funksionet sintaksore të ndajfoljes në gramatikat tradicionale të shqipes), *Rrezarta Draçini* (A mund të flitet për paragjykim gjuhësor në Shqipëri?), *Bardh Rugova* (Ideologjia e preskriptivizmit në gjuhën shqipe), *Merita Hysa* (Varietete gjuhësore mes paragjykimeve teorike dhe kontrasteve ideologjike), *Edmond Çali* (Kode të mëdha në vepra (të mëdha dhe) të vogla: E.Koliqi-"Gjaku. I.Kadare-"Dasma", S.Drini-Shembja e idhujve&midis dy kohëve, E.Dones-Vergine giurata/Hana"), *Hamit Xhaferi* (Kodi biblik në veprën "Abeli" të Etëhem Haxhiademit).

Mbi Letërsinë Arbëreshe, ndër të tjerët, mbajti një kumtesë *Vebi Bexheti* (Gërshetimi i lirikës deradiane me atë popullore në "Këngët e Milosao-s).

Seminari i kushtoi "Orën Letrare", të 28 gushtit, Promovimit të librit me poezi "Telet e Zëmrës" (Faik Konica, Prishtinë 2013) të Buzëdhelprit /Agostino Giordano - , në lokalet e Qendrës së Studentëve, te hera 21.00. Morën pjesë proff.: Imri Badallaj (faktòtumi i këtij botimi), Sedat Kuçi, dekan i Fakultetit, prodekània Lindita Sejdi-Rugova; Bardh Rugova, drejtor i Seminarit e Rexhep Ismajli, akademik. Si edhe të tjerë proff. pjesëmarrës të Seminarit. Mbajtën referimin e rastit dy studjuese vlonjate, pedagoge në Universitetin e Durrësit, dr.Helena Grillo e dr.Alisa Velaj; ndërsa fjalën e hyrjes e mbajti prof. Agim Vinca, poet e letrar. Gjatë 'Orës Letrare' u djovastin disa poezi të Buzëdhelprit. Ky, më ndë fund, muar fjalen e falenderoi gjithe ata çë punuan per botimin e librit: Imri Badalla së pari, pra Shtëpinë Botuese Faik Konica me redaktorin e saj Nazmi Rrahmanin dhe kritikun letrar Kujtim Rrahmanin për Paraqitjen e poezivet në libër; dhe lexoi disa mendime të tij mbi "Poezinë". Një sukses, sipas atyre (jo pak) çë morën pjesë te Promovimi. Pas Promovimit të Poezivet, një grup Arbëreshësh, - me në krye tre seminaristë të Eparhisë së Ungrës- këndoi kënka të njohura arbëreshe e shqiptare. E u vallëzua. Mosnjarì iku i varesur.

Autorë e Shkrime*

(Jeta Arbëreshe, nn.72 pjesërisht, 73-78)

Alfano Nicola (ka Shën Pali), Vjershe (poezi popullore) (74)
Alimemaj Zamira (nga Vlora), Kongreset Gjuhësore dhe shkeljet drejtshkrimore të Shqipes (75)
Alimemaj Zamira (nga Vlora), Lab-Labërì, Arbër-Arbërì (77)
Amato Lucia (ka Purçilli), Jeta Arbëreshe –poezi- /10vjetori i J.A./ (73)
Arbri Roman (arhjim.Eleuterio F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Una lettera da Roma (7) ;
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Il coro di Lungro in concerto (9);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), La festa Nazionale d'Albania (11);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Il sogno di Skanderbeg (12);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Dialogo con il cavallo di Skanderbeg (14);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Conversazione con il Babuino (15);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Il Babuino e gli Dei (17) ;
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Penjtë e shën Nilit (19);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini e Draguni (20);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini e muzika pa fjalë (21);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini sod flet me zëmer (22);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Djalli e Ëngjlli (23);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini sod flet me tru (24);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini e Pashkat Bizantine (25);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Përpara varrit të Emil Tavolarit (26);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini, Evropa dhe abetari (27) ;
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Joket olimpike (28);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Kongresi i të Urtëvet (29);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Jo vet priftrat venë Grotaferratë (30) ;
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini e mesha arbëreshe (31);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini e Natallet (32);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Sinodi i Arbëreshëvet (33);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Atmosfera e Sinodit të Arbëreshvet (34);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini e Kalimera e Lazarit (35);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini, Papa i ri dhe maçet (36);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini, Ndrikullat dhe Hënza (37);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini, Ikonat dhe Statuat (38);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Besa e Lëtinjvet (39);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini dhe Historia e Arbëreshëvet (40);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini dhe Skanderbeku i fatartur (41);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini dhe Ernest Koliqi (42);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini dhe miku i Arbëreshëvet (43);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini kërkon një fjalë (44);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini dhe Tradita (45);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini dhe Shën Mëria e Arbëreshëvet (46);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini, një filosof dhe prifti i ri (47);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini dhe Judha tradhëtar (48);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Guardia Piemontese, ndë Kalabrje (49);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini, Kryqja dhe British Airwais (50);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini, çmimi Nobel e Identiteti arbëresh (51);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Fjalori biobibliografik i Arbëreshëvet (52);
Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini dhe Liria (53);

Autorë e Shkrime*

(Jeta Arbëreshe, nn.72 pjesërisht, 73-78)

Arbri Roman (arhjim.E. F.Fortino, ka Shën Bendhiti), Babuini dhe vdekja e piktorit Martini (54):
e rëkimi im tij s’të qëndron i fshehur.
Llaftarisën zëmra ime
fuqia më lëshon
shuhet drita e syvet të mi.
Miq e shokë llargohen ka lavomat e mia,
gjitònët e mi rrinë llargu.
Ndën leqe kush do të më vrasë,
ngatërren pajìdhe kush kërkon shkatërrimin tim
e gjithë ditën mejton gënjime.
U, si një i shurdur, nëng gjegjënj
e, si një pagolë, s’hapënj grikën;
jam si një njeri çë s’gjegjën e s’përgjegjet.
Tek ti shpresonj, o Zot,
ti do të më përgjegjesh, o Zot Perëndia im.
Thashë: “Mos të gëzojën mbi mua,
kundër meje mos të lavdërohen,
kur këmba ime dridhet”.
Sepse u jam po të bie
e kam ngamot përpara dënimin tim.
Njo, skomollisënj ftesën time.
jam në ankth për mbëkatin tim.
Armiqtë e mi janë të gjallë e të fortë,
shumë më duan lik pa arsye,
më shpagùajën të mirën me të ligën.
më ngalesjën se kërkonj të mirën.
Mos më lëshò, o Zot;
Perëndia im, mos rri llargu ka u.
Eja e më ndih, o Zot, shpëtimi im.

Psalmi 62

O Perëndi, ti je Perëndia im: si dihet, të kërkonj;
për tij ka etë shpirti im,
tij të dëshiron kurmi im,
si dhé i shkretë, i thatë, pa ujë.
Kështù te hjerorja të kërkova,

se të ruanj mirë fuqinë tënde e lavdinë tënde.
Sepse hiri yt vlen më se jeta,
buzët e mia do të rrëfyejën lavdinë tënde.
Kështù do të t’bekonj për sa të rronj,
nd’ëmrit tënd do të ngrënj duart e mia.
Do të ndëndem si te një tryes madhështore
e me zëra gëzimi do të të lëvdonjë gola ime.
Kur, te shtrati im, kujtohem për tij,
e të mendonj tij në të zgjùarit e natës.
tij çë qeve ndihma ime,
harepsem me gëzim nën hjenë e krahëvet të tu.
Tij të shtrëngohet shpirti im
e fuqia e së djathtës sate më mban.
Po ata çë duan të më vrasën,
do të zbriten tek thellësia e botës,
do të jenë plaçkë e shakàlvet.
Rregji do të gëzonjë te Perëndia,
do të lëvdohet kush merr bé për ‘të,
sepse të rremëvet do t’i mbëllihet gryka.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjtë, nani e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.
Alliluia (3 herë). Lavdi Tij, o Perëndi. Lipisi, o Zot (3 herë).

Psalmi 87

O Zot, Perëndì i shpëtimit tim,
përpara teje thërres ditë e natë.
Le t’errënjë njera tek Ti lutja ime,
ndëji veshin rëkimit tim.
U jam plotë me tërbime,
jeta ime është afër varrit.
Jam i nëmruar ndër ata çë zbriten ndë varrt,
jam si një burrë nanì pa fuqi.
Është ndër të vdekurit shtroja ime,
si janë të vrarët të shtënë tek varri
të cilët ti s’i kujton
e çë dora jote ka lëryer.
Më shture te gropa e thellë,
ndër errësirat e tek hjea e vdekjes.
Mbështon mbi mua mëria jote
e me gjithë suvalat e tua më mbyten.
Llargove ka u shokët e mi,
më bëre për ‘ta një tmerr.
Jam filaqìr pa shpëtim,
grisen sytë e mi tek të pësuarit.
Tërë ditën të thërres, o Zot,
drej teje ndënj duart e mia.
Mos bën mërèkul për të vdekurit?

Java ‘ Madhe / E Hëna e Shëjtë

O ngrëhen hjetë të të japën lavdi?
Mos festohet mirësia jote te varri,
besa jote ndë pisët?
Mos ndër errësirat njihen mërekulit e tu,
drejtësia jote te katundi i harrimit?
Po u tij, o Zot, thërres ndihmë,
e menatet errën tek ti lutja ime.
Pse, o Zot, më reshtën?
Pse më fshehën faqen tënde?
Jam i mjerë e po të vdes ç’ka vogëlìa,
jam pa fuqi, i shtypur ka trëmbjet e tua.
Mbi mua shkoi zëmërimi yt,
trëmbjet e tua më asgjësuan,
më rrethojën si ujë gjithë ditën,
gjithë bashkë më pështjellën.
Llargove ka u miq e të njohur,
më janë shoqe vetëm errësirat.

Psalmi 102

Bekò Zotin, o shpirti im,
çdo është tek u bekoftë ëmrin e tij të shëjtë.
Bekò Zotin, o shpirti im,
mos harrò aq mirësí të tija.
Ai ndjen gjithë mëkatët e tu,
shëron gjithë sëmundjet e tua;
shpëton ka varri jetën tënde.
të kurorëzon me hir e me lipisí;
ai ndëndën me të mira ditët e tua
e ti ndërron si shqiponjë rininë tënde.
Zoti shërben me drejtësì
e me të drejtë ndaj gjithë të shtýpurvet
I kallëzoi Moiseut udhët e tija,
të bilvet të Izraillit veprat e tija.
I mirë e lipisjar është Zoti,
i gjatë te zëmërimi e i math te dashuria.
Ai nëng ngjatet tue kundërshtuar
e s’mban për gjithmonë mërinë e tij.
Nëng na trajton sipas mëkatëvet tanë,
nëng na shpaguan sipas fajevet tanë.
Si qielli është lart mbi dhenë,
ashtù ë e madhe lipisia e tij mbi ata ç’i trëmben;
si është llarg lindja ka perëndimi,
kështù llargon ka na fajet tanë;
si një àtë ka lipisì për biltë e tij,
ashtu Zoti ka lipisi për ata ç’i trëmben.
Sepse Ai di me kë jemi plazmuar,
kujton se na jemi plëh.

Java ‘ Madhe / E Hëna e Shëjtë

Si barët janë ditët e njeriut;
si lulet e sheshit, ashtu ai lulëzon.
E zë ajri e më s’është
e vendi i tij më nëng e njeh.
Po hiri i Zotit është ka gjithmonë,
rron gjithmonë për ata ç’i trëmben;
drejtësia e tij për biltë e të bilvet,
për ata çë mbajën besëlidhjen e tij
e kujtohen të ruajën urdhërat e tij.
Zoti e vu në qiell thronin e tij
e rrëgjëria e tij përqafon gjithësinë.
Bekoni Zotin, ju gjithë ëngjëlit e tij,
përmbarùes të fuqishëm të urdhëravet të tij,
gati të gjègjni fjalën e tij.
Bekoni Zotin, ju gjithë aradhët e tija;
ju ministrat e tij, çë bëni vëlimën e tij.
Bekoni Zotin, ju gjithë veprat e tija,
te çdo vend i zotërimit të tij.
Bekò Zotin, o shpirti im.

Psalmi 142

O Zot, gjegj të falurit tim,
mirr vesh lutjen time pas vërtetës sate,
gjegjmë pas drejtësisë sate.
Dhe mos hyr mbë gjykim me shërbëtorin tënd,
se mosnjë i gjallë mund të dalë i drejtë përpara teje
Se armiku rrahu shpirtin tim,
përuli jetën time për dheu:
më vu të rri ndër vende t’errët
si të vdekurit ç’ka mot.
Prandaj m’e zu hjidhia shpirtin tim
e zëmra ime u taraks përmbrënda meje.
Kujtova ditët e shkuara,
mendova gjithë të bënat e tua, tue menduar mbi të bënat e duarvet të tua.
Ndëjta duart e mia drej teje,
shpirti im ka etë për tij si dhé i thatë.
Shpejt gjegjmë, o Zot,
m’u zu fryma.
Mos prir mënjanë faqen tënde prej meje,
se mos t’i gjas atyre çë zbryten ndë varrt.
Bën të gjegjënj lipisinë tënde çë menatet,
se u tek ti pata shpresë.
Bën të njoh udhën tek cila kam ‘ ecënj,
se tek ti ngrëjta shpirtin tim.
Shpëtomë nga armiqtë e mi, o Zot,
tek ti u erdha e u fsheha.
Mësomë të bënj vëlimën tënde,

se ti je Perëndia im.
Shpirti yt i mirë le të m’udhëronjë mbi dhé të drejtë.
Për ëmrin tënd, o Zot, ngjallmë;
në drejtësinë tënde nxir shpirtin tim nga ngushtica.
Dhe në lipisinë tënde asgjësò armiqtë e mi,
e humb gjithë ata çë helmojën shpirtin tim,
se u jam shërbëtori yt.
Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjtë, nani e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.
Alliluia (3 herë). Lavdi Tij, o Zot (3 herë), Shpresa jonë, lavdi tij.

Litaní e gjatë

Djaku: Në paqe le t’i lutemi Zotit.
Populli: Lipisì, o Zot.
Dja: Për paqen së larti dhe për shpëtimin e shpirtravet tanë, le t’i lutemi Zotit.
Pop: Lipisì, o Zot.
Dja: Për paqen e tërë jetës dhe për qëndrimin e mirë të qishavet të shëjta të Perëndisë dhe për bashkimin e të gjithëve, le t’i lutemi Zotit.
Pop: Lipisì, o Zot.
Dja: Për këtë shpi të shëjtë dhe për ata çë hyjnë këtù me besë, me ponì dhe trëmbësì Perëndije, le t’i lutemi Zotit.
Pop: Lipisì, o Zot.
Dja: Për Peskopin tonë (…) të ndershëm, për të nderuarën Priftërì dhe Dhjakërinë në Krisht, për gjithë klerin dhe popullin, le t’i lutemi Zotit.
Pop: Lipisì, o Zot.
Dja: Për qeveritarët tanë, për bashkëpunëtorët e tyre dhe për ushtrinë, le t’i lutemi Zotit.
Pop: Lipisì, o Zot.
Dja: Për këtë katund, për çdo katund e horë, dhe për ata çë rrinë ndër ‘ta me besë, le t’i lutemi Zotit.
Pop: Lipisì, o Zot.
Dja: Për butësinë e erëvet, për pasurinë e pemëvet të dheut dhe për mote të paqëm, le t’i lutemi Zotit.
Pop: Lipisì, o Zot.
Dja: Për ata çë udhëtojnë në dhe, në det dhe në erë, për të sëmurët, për ata çë durojnë, për ata çë janë në filaqì edhe për shpëtimin e tyre, le t’i lutemi Zotit.
Pop: Lipisì, o Zot.
Dja: Se të na ruanjë nga çdo helm, mëri, rrezik dhe nevojë, le t’i lutemi Zotit.
Pop: Lipisì, o Zot.
Dja: Tue kujtuar bashkë me gjithë shëjtrat të tërëshëjten, të dëlirën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tone Hyjlindësen dhe gjithmonë Virgjëren Marì, vetëhenë tonë dhe njerijatrin, dhe gjithë jetën tone Krishtit Perëndi le t’ja parashtrojmi.
Pop.: Tij, o Zot.
Prifti: Se Tij të nget çdo lavdì, nderë dhe adhurim, At, Bir e Shpirt Shëjtë, nanì e përherë dhe në jetët e jetëvet.
Pop.: Amin.

Alliluia

- Çë natën rri zgjuar shpirti im përpara teje, o Perëndi, se kumandamentet e tu janë dritë mbi dhenë. (Alliluja, 3 herë).
- Xëni drejtësinë, ju banorë të dheut. (Alliluja, 3 herë).

Java ‘ Madhe / E Hëna e Shëjtë

- Zelli do të zotëronjë mbi popullin kryengrëjtur, dhe zjarri do të përpinjë armiqtë e tu. (Alliluia, 3 herë).
- Mburoja, o Zot, mburoja të ligat kryelàrtëvet të dheut. (Alliluia, 3 herë).

Njo se dhëndrri po vjen (Idhù o Ninfios)

Njo se dhëndrri po vjen ndë mes të natës, dhe i lumtur shërbëtori kë do t’e gjënj të zgjuar. I padenjë përkundra kë do t’e gjënjë të qëlluar. Shih prandaj, o Shpirti im, të mos të jesh ka gjumi i zënë, se të mos të jesh dorëzuar vdekjes, dhe të jesh i reshtur jashtë Rregjërisë. Po ni zgjohu ture thërritur: I Shëjtë, i Shëjtë, i Shëjtë je o Perëndia ynë; me lutjet e Hyjlindëses kij lipisi për ne. (3 herë)

(Shih Himne Liturgjike, faqe 105)

Litaní e shkurtër

Djaku: Përsëri dhe përsëri në paqe le t’i lutemi Zotit.
Populli: Lipisì, o Zot.
Dja: Ndihna shpëtona, kijna lipisì dhe ruajna, o Perëndì, me hirin tënd.
Pop.: Lipisì, o Zot.
Dja: Tue kujtuar bashkë me gjithë shëjtrat të tërëshëjten, të dëlirën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tone Hyjlindësen dhe gjithmonë Virgjëren Marì, vetëhenë tonë dhe njerijatrin, dhe gjithë jetën tonë Krishtit Perëndi le t’ja parashtrojmi.
Pop.: Tij, o Zot.
Prifti: Se jotja është fuqia, rregjëria dhe lavdia, Atë, Bir e Shpirt Shëjtë, nani e përherë e në jetët e jetëvet.
Pop.: Amin.

Kàthizmi

Kjo ditë bën të lehen mbi jetën, si dritë shpëtimi, Pësimet e Shëjtë; për mirësinë e tij, Krishti anangàset t’i nënshtrohet pësimit; Ai çë mban gjithësinë tek dora e tij, denjohet, për shpëtimin e njeriut, të jetë i vjerrë te kryqja!

Gjyqtàr i padukshëm, si u buthtove te mishtë, e vete të jesh i vrarë ka njerëz të padrejtë, tue dënuar dënimin tonë me pësimin tënd! Prandaj, me zë të përbashkët ngrëjmi e dhurojmi lëvdi, madhështi e lavdërìm fuqisë sate.

Kjo ditë shprishën dritën e saj mbi pësimet e parë të Krishtit. Po i dalmi përpara, o besimtarë, me këndime! Krijuesi niset të pësonjë kryqen, pyetjet, fshikullat, gjykimin e Pillatit. Të gjitha i pranon se të shpëtonjë njerinë, edhe të jetë i zënë me shpëllaka ka një shërbëtor. Prandaj na thërresmi: “O Krisht Perëndi, lipisjar, dhuroji ndjesën e mbëkatëvet atyre çë me besë adhurojën pësimin tënd të pafajshëm”.

Vangjeli

Prifti: Edhe sa të vlerësohemi të gjegjmi Vangjelin e shëjtë, Zotit Perëndisë tonë le t’i lutemi.
Pop.: Lipisì, o Zot (3 herë)
Prifti: Urtësì, drejtë! Le të gjegjmi Vangjelin e shëjtë. Paqë gjithëve!
Pop.: Edhe shpirtit tënd.
Djaku: Këndim ka Vangjeli i shëjtë sipas Mateut
Pop.: Lavdì tij, o Zot, lavdì tij.

Vangjeli (Mat 21, 18-43)

Nd’atë mot, Jisui, si u pruar te qyteti, pati ú. E, parë një fik udhës, ju qas e s’gjeti tek ai veç se fleta, e i thotë atij:”Mos u leftë më nga ti frut për gjithmonë”. Dhe fiku u tha gjithnjëherje. Si panë këtë, Dishipujt e tij u

Java ‘ Madhe / E Hëna e Shëjtë

marmarostin e thanë:”Si u tha gjithnjëherje fiku?”. U përgjegj Jisui e i tha atyre: “Me të vërtetë ju thom juve se nëse s’patshit besë, e nëng ndënjshit mbë një e mbë dy, do të bëni jo vetëm këtë të fikut; po edhe nëse i thofshit këtij mali: ngreu e hjidhu te deti, do të bëhet. E çdo lipshit te lutja, tue pasur besë, do t’e kini”. Si hyri Aì te Tempulli, ju qastin atij, çë mësonij, Kryepriftrat dhe Pleqtë e gjindjes, dhe i thonë:”Me të cilin zotërim bën ti këto shërbise? E kush t’e dha tij këtë zotërim?”. Jisui i tha atyre:”Edhe u ju bënj një pyejtje; e, nëse ju m’u përgjegjëshit, edhe u ju thom juve me të cilin zotërim bënj këto shërbise. Pagëzimi i Janjit nga ish? Nga qielli ose nga njerzit?”. Dhe ata flisjin ndër ata e thojin:”Nëse thofshim “nga qielli”, ai do të na thetë: pse s’i patëtit besë? Nëse pra i thofshim “nga njerëzit”, i trëmbemi gjindjes, sepse gjithë mbajën Janjin si Profit”. Dhe ju përgjegjëtin prandaj Jisuit e i thanë:”S’e dimi”. E ai i tha atyre:”Edhe unë s’ju thom juve me cilin zotërim bënj këto shërbise. Ç’ju duket pra juve? Një burrë kish dy bij; si ju qas të parit, i tha: “Bir, ec sot e shërbè te vreshta ime”. Ai ju përgjegj e i tha: “Ëh, zot”, e s’vate. Si ju qas të dyjtit, i tha edhe atij ashtu; e ai ju përgjegj: “S’dua”, po pëstaj u pendua e vate. Cili, ndër të dy, bëri vlimën e të jatit?”. I thonë atij:”I dyjti”. I thotë atyre Jisui:”Me të vërtetë ju thom se publikanët e gratë çë bëjën turpa venë më parë se ju te rregjëria e Perëndisë. Sepse erdhi Janji në udhë drejtësije dhe s’i patëtit besë. Publikanët, përkundra, dhe gratë çë bëjën turpa i patëtin besë. Ju, përkundra, patë e s’u penduat se t’i kishit besë. Gjegjni njetër përrallëz. Ish një burrë kryeshpije çë kish vënë një vreshtë e rreth asaj vu një gardh, dhe gërmoi tek ajo një tinë e stisi një turrë e ja dha dica punëtorëve dhe iku. Kur pëstaj u qas moti i të vjelavet, dërgoi shërbëtorët e tij tek punëtorët, se të mirrjin frutet e vreshtës. Po punëtorët, marrë shërbëtorët, ca i rrahtin, ca i vranë, ca i zunë me gurë. Njetër herë dërgoi të tjerë shërbëtorë, më shumë se të parët, po edhe atyre i bënë ashtu. Ndë fund dërgoi tek ata të birin, ture thënë: tim bir do t’e nderojën! Po punëtorët, si panë të birin, thanë ndër ‘ta: “Ky është trashëgimtari: ejani, e vrasmi e trashëgimin e tij do t’e kemi na”. E, marrë atë, e nxuartin jashtë vreshtës dhe e vranë. Kur prandaj do të vinjë i zoti i vreshtës, ç’do t’i bënjë atyre punëtorëve?”. I thonë atij:”Keq do të bënjë të vdesin ata të ligj, e vreshtën do t’ja japë të tjerëve punëtorë, të cilët do t’i japën atij frutet tek moti ‘ tyre”. I thotë atyre Jisui:”S’kini dhjavasur ndonjë herë te Shkrimet: ‘Gurin, çë shtunë mënjanë stisarët, u bë krye këndi; nga Zoti u bë ky shërbes dhe është i mërakullueshëm përpara syvet tanë’?”. Prandaj ju thom juve, se do t’ju nxiret rregjëria e Perëndisë e do t’i jipet popullit çë bën të sjellë frut. Ai çë bie mbi këtë gur do të xhakmiset, dhe mbi atë çë bie do t’e bluanjë”. E si gjegjëtin kryepriftrat e farisenjtë përrallëzat e tija, ndëlguan se flit për ata e kërkojin t’e rrëmbejin, po i trëmbëshin gjindjevet, sepse e mbajin si profit.

Pop.: Lavdì tij, o Zot, lavdì tij.

(Këtu **këndohet Psalmi 50**, ndërsa populli puthën Vangjelin)

Psalmi 50
(Shih: H. L., faqe 135)

Kij lipisí për mua, o Perëndí, pas lipisisë sate të madhe
dhe, pas dhëmbshurivet të tua të shumta, shuaje paudhësinë time
Lajmë më shumë prej paudhësisë sime
edhe pastromë prej mëkatit tim.
Se u e njoh paudhësinë time
e mëkati im është kurdoherë përpara meje.
Bëra mëkat kundër tij vetëm
edhe përpara teje bëra të ligën,
kështu çë ti je i drejtë ndër fjalët e tua
e i këthjellët ndër gjykimet e tu.
Se njò ndër të ligat qeva i piksur

e ndë mëkata më leu mëma ime
Se njo ti dishe mirë të vërtetën,
të fshehurat e të panjohurat e urtësisë sate ti m’i zbulove
Lyejmë me hisop e u do të pastrohem,
lajmë e u do të bëhem më i bardhë se bora
Bën të gjegjënj gëzim e haré,
eshtrat e mi të përulur do të gëzohen
Prir mënjanë faqen tënde nga mbëkatat e mia
edhe shuaji gjithë paudhësitë e mia
Stis një zëmër të pastër tek u, o Perëndi,
dhe përtërir përmbrënda meje një shpirt të drejtë
Mos më resht llarg prej faqes sate
e mos nxir prej meje shpirtin tënd të shëjtë
Ëmë prap gëzimin e shpëtimit tënd
e fortëromë me shpirt madhështor
Do t’i mësonj të paligjëvet udhët e tua
dhe të pabesët do të priren tek ti
Shpëtomë prej gjakrash, o Perëndi, Perëndia i shpëtimit tim,
e gjuha ime do të lavdëronjë me gëzim drejtësinë tënde
O Zot, hapi buzët e mia
e gola ime do të rrëfyenjë lavdinë tënde
Se ndëse ti kishe dashur një therore, u t’e kisha dhënë,
po tij holokaustet s’të pëlqejën
Therore ndaj Perëndisë është shpirti i përdhëmbur:
një zëmër të përdhëmbur dhe të përulur Perëndia nëng do t’e shanjë
Bën’i mirë, o Zot, Sionës pas mirëdashjes sate dhe le të ndërtohen
muret e Jerusalimit. Ahiera do të të pëlqejën therore
drejtësije, dhurata e hollokauste
Ahiera do të të sjellën viçra mbi alltarin tënd.

Kanoni (Triòdhjon)

Kënga I

I këndojmi Zotit, çë me veprën e tij të perëndishme terti detin e furishëm e të pashkueshëm, e udhëtoi popullin e Izraillit t’e shkonej mbë këmbë. Ai u mbulua me lavdi!

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjtë.

Zbritja e pathënshme e Fjalës së Perëndisë, çë është Krishti i vetë, Perëndi e njerì, kur muar formën e shërbëtorit, i buthtoi dishipulvet se nëng mendoi t’ish një vjedhje të qënurit Perëndi. Ai u mbulua me lavdi!

Nanì e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.

Unë, Krjiuesi, erdha se të shërbeja njeriun, të cilit mora formën me dashje, e se të jipja jetën, u, i bëgatë i hyjnisë sime, megjithëse s’mund pësoja si Perëndi, se të shpagùaja Adhamin, të nëmurin, u bëra i varfër.

Litaní e shkurtër

Djaku: Përsëri dhe përsëri në paqe le t’i lutemi Zotit.

Java ‘ Madhe / E Hëna e Shëjtë

Populli: Lipisì, o Zot.
Dja: Ndihna shpëtona, kijna lipisì dhe ruajna, o Perëndì, me hirin tënd.
Pop.: Lipisì, o Zot.
Dja: Tue kujtuar bashkë me gjithë shëjtrat të tëreshëjten, të dëlirën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tone Hyjlindësen dhe gjithmonë Virgjëren Marì, vetëhenë tonë dhe njerijatrin, dhe gjithë jetën tonë Krishtit Perëndi le t’ja parashtrojmi.
Pop.: Tij, o Zot.
Prifti: Se Ti je Perëndia ynë e na të lavdërojmi Tij - Atë, Bir e Shpirt Shëjtë - nanì e përherë e në jetët e jetëvet.
Pop.: Amin.

Shkurtorja (Kontàqjon)

Jakovi qanej bjerrjen e Sepës, ndërsa ai, zëmërgjeri, ish ulët mbi një qerre, i nderuar si një rregj. E, se s’u kish nënshtruar ëndjevet të Egjipcjànes, ish i lavdëruar ka Ai çë sheh te zëmrat e njerëzvet e shpërndan kurorën e pastërt.

Dhoma (Ikos)

Shtomi shërtim mbi shërtim e qami, tue rrahur stomahjin bashkë me Jakovin për të urtin Sepë, i denjë t’ish i festuar, çë qe bërë shkllavër te kurmi, po mbajti të lirë shpirtin e u bë i zoti i tërë Egjiptit. Zoti, në të vërtetë, i jep shërbëtorëvet të tij kurorën çë s’kalbet.

Kujtim i ditës

Te kjo e Hënë e Shëjtë dhe e Madhe, kujtojmi të lumturin e shumë të mirin Sepë, dhe fikun e mallkuar e të thajtur ka Zoti.

Vargje:

(për Sepën e urtë)

Sepa i urtë
u buthtua qeveritar i drejtë
e çë dhuron të mira.

(për fikun e mallkuar)

Krishti, tue simbolizuar te fiku sinagogën
e ebrenjvet, pa frute shpirtërorë,
e than me nëmën e tij.
Pështomi ka shortja e tij mixore!

Prifti: Për lutjet (uratat) e shumë të mirit Sepë, o Krisht, Perëndia ynë, kij lipisi për ne. Amin.

Kënga VIII

Zjarri i pashueshëm, i shtyjtur me material të pakufishëm, u trëmb për kurmin e panjollë, të gjasshëm shpirtit, të djemvet të pambëkat, e u kërrus. E si u shua flaka përherë e gjallë, këndohej një himn i përhershëm: “Ju vepra të gjitha, lëvdoni Zotin e lartësonie për gjithë shekulit”.

Bekojmi Atin e Birin e Shpirtin ‘ Shëjtë, Zotin.

Java ‘ Madhe / E Hëna e Shëjtë

Ture vatë ndaj Pësimit, Shpëtimtari i thotë miqvet të tij: do të ju njohën si dishipulit e mi, ndëse ruajshi kumandamentet e mi. Rroni mbë paqë ndër ju e me gjithë; ndëse kini ndjenja të thjeshta do të jini lartësuar; e ndëse më njihni mua si Zot, lavdëromni e lartësomni ndër gjithë shekulit.

Nanì e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.

Zotërimi juaj mbi ata çë ju gjasen qoftë i tërë ndryshe ka ai i paganëvet. Të ndìejturit kryelartë nëng është trashëgim imi, po tiraní. Cili ndër ju do të jetë i pari, qoftë i sprasmi i të gjithve. Ndëse më njihni mua si Zot, lavdëromni e lartësomni ndër gjithë shekulit.

Djaku: Lëvdojmi e madhërojmi Mëmën e Perëndisë dhe mëmën e dritës.

Kënga IX

Madhërove, o Krisht, Mëmën e Perëndisë, çë të leu e ka e cila Ti, krjiuesi ynë, more një
kurm, çë mund të pësonjë, e çë na liron nga fajet tanë. Ture e thërritur të bekuar gjithë jenìtë, na të madhërojmi.

Lavdì Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjtë

Xheshni çdo njollë të zjarrtë, e vesheni me ndjenja të drejta, të denja të Rregjërisë së Perëndisë, - i thoje dishipulvet të tu, ti, o urtësí e përgjithshme; - me anën e saj ju do të jini të lavdëruar e do të shkëlqeni më se dielli.

Nani e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.

O Zot, ti i the dishipulvet të tu: Gjìtmni mua e mos dishëroni ndera, po ecni në përulësì. Pini kupën çë pi unë, se do të jini të lavdëruar me mua te rregjëria e Atit tim.

Litanì e shkurtër

Djaku: Përsërì dhe përsërì…
……
Prifti: Se fuqitë e qielvet të lëvdojën e të lavdërojën (japën lavdì) - At, Bir, e Shpirt Shëjtë - nani e përherë e në jetët e jetëvet.
Pop: Amin.

Dërgimtare / Eksapostilàrion

Dasmën tënde (Ton Ninfona)

Dasmën tënde po shoh, o Shpëtimtar, të ndrequr, dhe të veshurën u nëng e kam, se të mund hynj unë tek ajò. Zbukuromë të veshurën e shpirtit tim, o Dritëdhënës, dhe shpëtomë. (3 herë)

(Shih: Himne Liturgjike, faqe 107)

Lëvditë / Èni

Psalmi 148

Lëvdoni Zotin prej qielvet,
Lëvdonie lart ndër qiel!
Lëvdonie ju të gjithë, ëngjëlit e tij,

Java ‘ Madhe / E Hëna e Shëjtë

Lëvdonie ju të gjitha, ushtëritë e tija
Lëvdonie, diell e hënë,
Lëvdonie ju të gjithë, ylëz të ndritshëm
Lëvdonie, ju qiel të qielvet,
ju ujra përmbi qielt.
Le të lëvdojën të gjithë ëmrin e Zotit.
sepse ai tha e u krijuan.
I vendosi për gjithmonë,
vuri një ligjë çë nëng shkon.
Lëvdoni Zotin, ju mbi dhé,
stihjì të detit e gjithë ju àvse,
zjarr e breshër, borë e mjegull;
ajër monostrofi çë i gjegjën fjalës së tij;
male, e gjithë ju rehje,
arvure frutorë e gjithë ju cedra;
ju egërsira e gjithë ju kafsha,
gjarpre e zogj me pendë.
Rregjrat e dheut e gjithë populit,
qeveritarët e gjyqrat e dheut
trimat e vashat,
pleqtë bashkë me djemtë
le të lëvdojën ëmrin e Zotit:
sepse vet ëmri i tij është shumë i lartë,
lavdia e tij shkëlqen mbi dhenë e ndër qiel.
Ai ngrëjti fuqinë e popullit të tij.
Është këngë lëvdimi për gjithë ata çë kanë besë tek aì,
për biltë e Izraillit, popull çë ai do mirë.

Psalmi 149

Këndoni Zotit një këngë të re;
lavdia e tij tek mbledhja e besimtarëvet.
Le të gëzonjë Izrailli në Krijuesin e tij
le të gëzojën te Rregji ‘ tyre të biltë e Sionës
Le të lavdërojën ëmrin e tij me valle,
me timpane e çetra le t’i këndojën himne.
Zoti do mirë popullin e tij,
kurorëzòn të butët me fitore.
Le të gëzojën besimtarët te lavdërimi,
le të ngrëhen të gëzuar nga shtretrat e tyre.
Lëvditë e Perëndisë mbi buzën e tyre
e shpata me dy èhje ndër duart e tyre,
për të bëjën ahmarrjen ndë mes të populvet,
e të bashkojën gjindjet;
se të shtrëngojën me hekure krerët e tyre.
bulerët e tyre me pengore hekuri;
për të bëjën mbi ata dënimin tash ‘ shkruar:
kjo është lavdia për gjithë ata çë kanë besë tek aì.

Java ‘ Madhe / E Hëna e Shëjtë

Psalmi 150

Lëvdoni Zotin në shëjtëroren e tij,
lëvdonie në qiellin e fuqisë së tij.

Thirrtore (Stihjirà Idiòmela)

Lëvdonie për mërèkulit e tij
lëvdonie për madhështinë e tij të pamasë.

Ture vatë Zoti drej pësimit vullnetar, udhës i thoj dishipulvet të tij: Njo, hipemi në Jerusallim e i Biri i Njeriut do të jetë dorëzuar, si është shkruar për ‘të. Po edhe na, prandaj, me mendje të pastruara, i bëmi shokërì atij, se të jemi të kryqëzuar me ‘të e, për të, t’i vdesmi gëzimevet të mishit; sepse të mund t’rromi edhe na me ‘të e t’e gjegjmi çë thotë: Nëng hipem më në Jerusallimin botëror, se të pësonj, po tek Ati im e Ati juaj, tek Perëndia im e Perëndia juaj; e do të ju qellënj me mua te Jerusallimi qiellor, te rregjëria e qielvet.

Lëvdonie me zë trùmbje,
Lëvdonie me harp e me çetër;
Lëvdonie me timpane e me valle
Lëvdonie mbi telet e mbi fyelt.

Ture vatë Zoti drej pësimit vullnetar……(shih lart)

Lëvdonie me klaviçèmbale tingëllorë
Lëvdonie me klaviçèmbale tingëllues;
çdo i gjallë le të lëvdonjë Zotin.

Si errumë, o besimtarë, te pësimi shpëtues i Krishtit Perëndi, lavdërojmi zëmërgjerësinë e tij të pathënshme; se për lipisinë e tij, Ai ç’është i mirë e çdo mirë njerëzit, të ringjallënj me ‘të edhe neve, të vdekur për mbëkatin.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit ‘ Shëjtë, nanì e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.

Ture vatë, o Zot, ndaj pësimit, more mënjanë dishipulit e tu, e, se t’i përforcoje, i thoje atyre: po si i harruat fjalët çë një ditë ju thoja: Një profet s’mund të jetë i vrarë veç se në Jerusallim? Nanì errù moti për të cilin ju fola: njò se do të jem i dhënë ndër duart e mbëkatarëvet se të jem i përqeshur; ata, pra çë më vunë mbë kryq e ndë varrt, do të më mbajën si një të vdekur çë s’vlen. Po ju bëni zëmer! U do të ngjallem të trejtën ditë, për harenë dhe jetën e pasosme të besimtarëvet.

Prifti: Tij të ka hje lavdia, o Zot Perëndia ynë, e tij të japmi lavdi, Atë, Bir e Shpirt Shëjtë, nanì e përherë e në jetët e jetëvet.
Pop: Amin.

Dhoksollojìa (këndohet)

(Shih: H. L., faqe 136-141)

- Lavdi Tyj çë na buthtove dritën, lavdì Perëndisë në të lartat edhe mbi dhé paqë ndër njerzit mirëdashje.
- Të himnojmë, të bekojmë, tyj t’adhurojmë, të lavdërojmë, të falënderojmë për lavdinë tënde të madhe.
- O Zot, mbret qiellor, Perëndi, Atë i tërëfuqishëm, Zot dhe Bir i vetëmlindur, Jisu Krisht dhe Shpirt i Shëjtë.
- O Zot Perëndi, Qengji i Perëndisë, Biri i Atit që nxier mbëkatin e jetës, po kijna lipisi, ti çë nxier mbëkatet e jetës.

Java ‘ Madhe / E Hëna e Shëjtë

- Prite faljen tonë, ti çë rri ndë të djathtën e Atit, edhe kijna lipisi.
- Se ti je i vetmi Shëjt, ti je i vetmi Zot, Jisu Krisht, për lavdi të Perëndisë Atit. Amin.
- Për çdo ditë do të të bekonj dhe do t’e lavdëronj ëmrin tënd për jetën dhe në jetën e jetës.
- Vlerësona, ti o Zot, ndë këtë ditë, të ruhemi pa ndonjë mbëkat.
- I bekuar je, o Zot, Perëndi i Etërvet tanë, dhe ëmri yt është i himnuar dhe i lavdëruar në jetët. Amin.
- Le të jetë, o Zot, përdëllimi yt mbi ne, sikundër kemi shpresuar tek ti.
- I bekuar je, o Zot, mbësomë të drejtat e tua.(3 herë)
- O Zot, u bëre ti streha jonë, gjeneratë mbë gjeneratë; unë thashë: o Zot, kijmë lipisì, shëroje shpirtin tim sepse të mërijta
- O Zot tek ti gjeta strehim, mbësomë të bënj dëshirën tënde sepse ti je Perëndia im
- Se ti je burimi i jetës, me dritën tënde do të shohim dritë
- Ti zgjate lipisinë tënde mbi ata çë të njohin
- Shëjt Perëndi, Shëjt i Fuqishëm, Shëjt i pavdekshëm kijna lipisì (3 herë)
- Lavdì Atit e Birit…Nanì e përherë …. Shëjt i Pavdekshëm kijna lipisì
- Shëjt Perëndi, Shëjt i Fuqishëm, Shëjt i pavdekshëm kijna lapis.

Litanì

Djaku: Le të ja plotësojmi lutjen tonë Zotit.
Populli: Lipisì, o Zot.
Dj: Ndihna, shpëtona, kijna lipisì dhe ruajna, o Perëndi, me hirin tënd.
Pop.: Lipisì, o Zot.
Dj: Mbrëmjen e tërë, të përsosur, të shëjtë, të paqme dhe të pamëkatme le t’ja lypmi Zotit.
Pop: Falna, o Zot.
Dj: Ndjesë dhe falje të mëkatevet dhe të fajevet tona, le t’ja lypmi Zotit.
Pop: Falna, o Zot.
Dj:Të mirat dhe të duhurat për shpirtrat tanë dhe paqen për jetën le t’ja lypmi Zotit.
Pop: Falna, o Zot.
Dj: Se të shkojmë, në paqe dhe në pendim jetën çë na qëndron le t’ja lypmi Zotit.
Pop: Falna, o Zot.
Dj: Mbarim të krishterë të jetës sonë, pa dhëmbje, të paqërtueshëm e të paqëm dhe mbrojtje të mirë përpara gjykatores së trëmbshme të Krishtit, le t’ja lypmi Zotit.
Pop: Falna, o Zot.
Dj: Tue kujtuar bashkë me gjithë shëjtrat të tëreshëjtën, të dëlirën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjen tonë Hyjlindësen dhe gjithmonë Virgjëren Mari, vetëhenë tonë dhe njerijatrin edhe gjithë jetën tonë Krishtit Perëndi le t’ja parashtrojmi.
Pop: Tyj, o Zot.
Prifti: Se ti je Perëndi i mirë e çdo mirë njerëzit dhe tij të dërgojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjt, nani e përherë e në jetët e jetëvet.
Pop: Amin.
Prifti: Paqë të gjithëve.
Pop: Edhe shpirtit tënd.
Dj. Krerët tuaj uljani Zotit.
Pop: Tyj, o Zot.
Prifti: (me zë të ulur). O Zot i shëjtë, çë rri ndër më të lertit qiel e ke kujdes për shërbiset e përulura; e me syun tënd, përpara kujt s’i pështon mosgjë, ruan mbi gjithë dheun, përpara teje na përulmi shpirtin tonë e kurmin tonë e të parkalesmi: Shëjt i shëjtravet, ngjat dorën tënde të padukshme ka ndënjja jote e shëjtë, e bekò neve të gjithë. Ndëse bëmë ndonjë mbëkat, me dashje o pa dashje, ti çë je Perëndi i mirë e ç’do mirë

njerëzit, ndjena dhe dhurona të mirat e jetës e të qiellit.
(me zë të lartë)
Prifti: Se tij të nget të na kesh lipisi e të na shpëtosh, o Perëndia ynë, e na të dhurojmi lavdi tij, Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjtë, nani e përherë e në jetët e jetëvet.
Pop: Amin.

Paravargje (Apòstiha)

O Zot, e jëma e të bilvet të Zebedhèut, sepse s’ish e gëzuar për misterin e pashpjegueshëm të planit të shpëtimit, të lypnej t’i jipje të bilvet nderën e njëi rregjërije të përmotshme; ti lajmërove, përkundra, se miqtë e tu kish’të pijen një kupë vdekjeje, kupë çë thoje se kish‘ t’pjie ti më parë se ata, për pastrimin e mbëkatëvet. Prandaj të thërresmi: o shpëtim i shpirtravet tanë, lavdi tij.

- Qemë të ndëndur, menatet, me hirin tënd: harèpsemi e gëzomi për gjithë ditët tona; jipna harenë për ditët e pësimit, për vitet në të cilët pamë vrerin. (Psalm 89, 14-16)

Kur i mbësoje, o Zot, dishipulvet të tu të prirëshin ndaj përsosurisë, i trùhshe të mos t’i gjisjen paganëvet në zotërimin e të më t’ulëtvet; s’do të jetë kështu ndër ju, dishipulit e mi, sepse vullnetarisht jam i varfër; i pari ndër ju qoftë shërbëtori i të gjithëve: kush urdhëron si kush gjegjën, kush ë i pari si i sprasmi. U erdha, në të vërtetë, se të shpëtoja Adhamin, u bëra i varfër, e për të jipja jetën si shpagim i të shumëvet, çë më thërresën: lavdi tij.

- Qoftë mbi ne mirësia e Zotit, Perëndia ynë: fortërò për ne veprën e duarvet tona, veprën e duarvet tona fortërò. (Psalm 89,17)
Le t’i trëmbemi, o vëllezër, dënimit të fikut të thajtur për shterpësinë e tij, e dhurojmi frute, të denjë pendimi, Krishtit, çë na jep lipisinë e madhe.

- Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjtë, nanì e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.

Dragoi, si gjet tek Egjipcjàna një Evë të dyjtë, kërkonej të gënjènej Sepën me fjalë lëvdimi; po ai i lëshoi të veshurën, e pështoi ka mbëkati, e, me gjithë se ish xheshur, s’kish turpë, si Adami parë mbëkatit. Me lutjet e tija, o Krisht, kij lipisi për ne.

Prifti: Është mirë të lëvdojmi Zotin e t’i këndojmi ëmrit tënd, o shumë i Lartë. Të lajmërojmi menatet lipisinë tënde, e natën të vërtetën tënde.

Trishëjtore (Trisajion)

Pop.: Shëjt Perëndi, Shëjt i Fuqishëm, Shëjt i pavdekshëm, kjina lipisi (3 herë).
Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjt, nani e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.
Trinì e tërëshëjtë, kijna lipisi; o Zot, falna mbëkatat tona; o Zot i madh, ndëlena paudhësitë tona për lavdinë e ëmrit tënd.
Lipisi o Zot (3 herë)
Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjtë, nani e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.
Ati ynë, çë je ndër qiel, u shëjtëroftë ëmri yt; ardhtë rregjëria jote, u bëftë vullimi yt si në qiell ashtu mbi dhe. Bukën tonë të përditshme ëna neve sot dhe ndjena neve detyrat tona si edhe na ja ndjejmi detorëvet tanë, dhe mos na shtjer në ngasje, po lirona ka i Ligu.

Prifti: Se jotja është rregjëria, fuqia e lavdia, At, Bir e Shpirt Shëjtë, nanì e përherë e në jetët e jetëvet.
Pop.: Amin

Java ‘ Madhe / E Hëna e Shëjtë

Shkurtorja (Kontàqjon)

Jakovi qanej bjerrjen e Sepës, ndërsa ai, zëmërgjeri, ish ulët mbi një qerre, i nderuar si një rregj. E, se s’u nënshtrua ëndjevet të Egjipcjànes, ish përkundra i lavdëruar ka Ai çë sheh te zëmrat e njerëzvet e shpërndan kurorën e pastërt.

Thohet: Lipisì, o Zot (12 herë)

Lavdì Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjtë, nanì e përherë e në jetët e jetëvet. Amin

Na të madhërojmi Tij, çë je më e nderuara se Hjeruvimet dhe më e lavdëruara se Serafimet, çë pa u përlyer linde Fjalën e Perëndisë, o Mëma e vërtetë e Perëndisë.

Djaku: Bekò, o àtë, në ëmrin e Zotit.
Prifti: Ju bekoftë Krishti Perëndia ynë, ç’është i bekuar nga mot, nanì e përherë e në jetët e jetëvet. Amin. O mbret qiellor, ngushëllimtar, Shpirt i së vërtetës, çë ndodhe kudo e mblon të gjitha; thesar i të miravet dhe jetëdhënës, eja e qëndrò ndë mes të neve, e pastrona nga çdo mbëkat dhe shpëtò, o i mirë, shpirtrat tanë.

(Këtu bëhen 3 Përmisje, ndërsa thohen këto lutje):

- O Zot, Rregj i jetës sime, mos më lëshò ndër duart e limondisë, të lehtësisë, të kryelartësisë dhe fjalëmadhësisë.
- Jipi përkundra shërbëtorit tënd shpirt urtësije, përulësije, durimi e dashurije.
- Ëh, o Zot Rregj, bën të shoh fajet e mi e të mos dënonj vëllaun tim, sepse ti vet je i bekuar, në jetët e jetëvet. Amin.

Përlëshimi

Prifti: Lavdi tij, o Krisht Perëndi, shpresa jonë, lavdi tij.
Populli: Lavdi Atit, Birit edhe Shpirtit Shëjtë, nanì e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.
Prifti: Tue vatë Zoti Krisht, Perëndia ynë i vërtetë, drej pësimit vullnetarisht, për pësimin tonë, me ndërmjetimin e Mëmës së tij të shëjtë e të dëlirë, me anën e kryqes së tij, të nderuar e jetëbërëse, me mbrojtjen e fuqivet qiellore të nderuara e pakurm, me lutjet e të nderuarit e të lavdëruarit profit e pararendës Janjit pagëzor, të Apostulvet të lavdëruar e të Shëjtë, të shëjtravet martirë të lavdëruar e fitimtarë, t’Etërvet tanë të shëjtë e theoforë, të shëjtit (të qishës,) të Hyjprindërvet të shëjtë e të drejtë Joaqimit dhe Anës e të gjithë shëjtravet, na pastë lipisi e na shpëtoftë; se është i mirë e do mirë njerëzit.
Me uratat e Etërvet tanë të shëjtë, o Zot Perëndia ynë, kìjna lipisì edhe shpëtona.
Populli: Amin.

Idiomatizme të Purçillit e të Frasnitës

(i mbjoth) **Drejtori**
ka Purçilli (Cs)

(vjen ka numri 77)

gjum-i, sm = sonno

866. u bë me gjum rahj, *si è fatto di sonno (un) colle* (si è fatta una lunga dormita)
867. nd'vafsh atjè, t'shkon gjumi!, *se andrai lì, ti passa il sonno!* (te ne accorgerai!)
868. frihet gjum / fjë si gjeri, *dorme / si sazia di sonno come il ghiro* (dorme molto)
869. ka/ècen me gjumin ndëper sí, *ha/cammina con il sonno negli occhi* (è mezzo addormentato)
870. e zu gjumi, *l'ha preso il sonno* (ha fatto ritardo)
871. bëri nj'koc gjum, *ha fatto un 'capo' di sonno* (ha dormito un po')
872. ata t'dí ndajen gjumin, *quei due dividono il sonno* (vanno molto d'accordo/si aiutano l'un l'altro)
873. -Je fjë? -Ë', jam e fjë te gjumi par!, -*Stai dormendo? –Sì, sto dormendo al primo sonno!* (Non riesco ad addormentarmi!)
874. është një gjum-math, *è un dormiglione,* (non ha pensieri, è tranquillo)

H

ha, v.tr = mangiare

875. vete tue ngrën cjapa, *va mangiando cicorie* (mangia poveramente)
876. këtu mund han dhjet moronìz, *qui possono mangiare dieci moranesi,* (c'è cibo in abbondanza)
877. ha me di vukùne (gangàl), *mangia con due bocconi (ganasce)*, (mangia a bocca piena)
878. ha mb'lakmì, *mangia con ingordigia,* (è ingordo)
879. -Ç'hëngtit? -Gjith t'mirat!, -*Che cosa mangiaste? -Tutte le bontà!* (tutto il desiderabile)
880. ësht e i hà lar lar, *li sta mangiando a forza,* (non sono di suo gradimento)
881. hani se kemi!, *mangiate, ché abbiamo!* (abbiamo cibo in abbondanza)
882. ha me di korìt, *mangia con due trogoli,* (mangia a più non posso)
883. at ullì e ha ajri, *quell'ulivo se lo mangia il vento,* (è troppo esposto al vento)
884. i hënger edhe pàlthit e eshtravet, *gli mangiò anche il midollo delle ossa,* (lo sfruttò al massimo)
885. hënger sa i duall ka sit, *mangiò tanto che gli uscì dagli occhi,* (a crepapelle)
886. me kto shurbise s'ha buk, *con queste cose non mangi pane,* (non riesci a campare)
887. hënger e hënger sa pat lëshonej tirqit, *mangiò e mangiò (tanto) che dovette lasciar andare/slacciare i pantaloni,* (mangiò in modo spropositato)
888. - S'dish t'haje? Nanì ha bri kaciqi!, *non volesti mangiare? Adesso mangia corna di capretto!, (*adesso arràngiati!)
889. s'bë' t'hash buk t'ëmbel!, *non ti faccio mangiare pane dolce!, (*ti dò filo da torcere!)
890. ha mbë vater, *mangia sul/al focolare, (*vicino al fuoco/gli fa freddo)
891. hënger (bëri) harèt e shën Bumbinit (Pashkvet), *mangiò/fece le gioie del santo Bambino (Pasquali)*, (ha mangiato/fatto i dolci di Natale (Pasqua)
892. bën stoçe tek t'ngrënit, *produce/fa rifiuti nel mangiare, (*è schifiltoso)
893. ke ç'mund hash nj'pul diten,e llave?, *puoi mangiare una gallina al giorno e ti preoccupi?* (stai bene e ti lamenti?)
894. e hëngtin me gjith të veshurat, *lo mangiarono con tutti i vestiti,* (se lo mangiarono con gli occhi, dall' l'invidia)
895. han gjith te nj'koporrìq, *mangiano tutti in una scodella* (sono poveri)
896. ha sa nj'krimb, *mangia quanto un verme* (molto poco)
897. ha si Marsi Parajùzit, *mangia come Marzio lo schifiltoso*, (mangia poco, con la puzza sotto il naso)

Idiomatizme të Purçillit e të Frasnitës

898. hëngra nj'lug fasule, *mangiai un cucchiaio di fagioli* (un po' di fagioli)
899. hëngra nj'tul buk, *mangiai una mollica di pane* (un po' di pane)
900. hëngra nj'grep past, *mangiai una forchetta di pasta,* (un po' di pasta)
901. hëngra nj'tul, *mangiai un po'* (ho preso uno spuntino)
902. ha si nj'allmàn, *mangia come una belva,* (molto e voracemente)
903. ai t'ha, t'pi e të tradhiren, *lui ti mangia, ti beve e ti tradisce,* (ti sfrutta e poi ti abbandona)
904. dua t'ha mish e asht, *voglio mangiare carne e osso,* (voglio tutto, bene e male)
905. i hënger mish e eshtra, *gli mangiò carne e ossa,* (lo spennò a dovere)
906. ha tul e kother, *mangia mollica e crosta*, (mangia tutto)
907. jam e ha buk, *sto mangiando pane*, (sto mangiando / pranzando o cenando)
908. ësht e ha t'gjall e t'vdekur, *sta mangiando vivi e morti,* (sfrutta vivi e morti)
909. ësht e e ha me sìt, *lo sta mangiando con gli occhi,* (prova forte invidia)
910. i hëngtin misht drràsat, *gli mangiarono la carne, le tavole*; (le tavole del letto l'hanno consumato)
911. i ha bitha (lkùra), *gli prude il sedere (la pelle),* (non ha cosa fare e litiga)
912. ulu e ha si të kërshtèret!, *siediti e mangia come i cristiani,* (come si deve, in modo composto)
913. s'ha më gjë se buk thèkerje, *non mangia altro che pane di segala*, (è molto povera)
914. -Ç'hëngre sot? -Qep t'gjalla e qep t'zìera. -*Che mangiasti oggi? -Cipolle crude e cipolle cotte*. (un mangiare povero e scadente)
915. leje t'e han qent!, *lascialo che lo mangino i cani,* (lascialo perdere)
916. i han duart, *gli prudono le mani,* (litiga facilmente)
917. kta mish thot "ha o ik!", *questa carne dice "mangia o vattene!"*, (è buonissima)
918. bëri t'ngrën sa një kakàv, sikuna kan han gjë ulq! *(ha fatto da mangiare una caldaia, come se debbano mangiare dei lupi!,* (ha fatto da mangiare in quantità esagerata
919. ç'kem hami, darsmet?, *che dobbiamo mangiare/consumare, un banchetto nuziale?,* (mi inviti a nozze?)
920. nàni t'e ha kanaròcin!, *fra poco te la mordo/addento la gola!,* (fra poco ti meno!)
921. hëngsh vllenin/rrënjen e kangarès!, *possa tu mangiare il veleno/la radice della cancrena*, (possa tu morire avvelenata o col cancro!)
922. t'u hëngt misht!, *che ti venga mangiata la carne!,* (che tu muoia con una cancrena!)
923. t'hëngshin morrat (qent,ulqit,krimbat)!, *ti mangino i pidocchi (i cani, i lupi, i vermi)!,* che tu possa morire miseramente

hapënj, v.tr/intr = aprire

924. m'u hap dora (këmba...), *mi si è aperta la mano (la gamba),* (l'ho slogata)
925. kur gjegja ashtu, m'u hap zëmra, (*quando sentii in quel modo, mi si aprì il cuore)* (fui contento)
926. m'u hap kurmi, *mi si aprì il corpo* (mi sono allarmato/spaventato)
927. ture vat lart e posht, m'u hap gradha, *andando su e giù, mi si aprì la schiena,* (ho la schiena a pezzi)
928. mos hap griken!, *non aprire la bocca!* (non ti distrarre facilmente)
929. është një grik-hapt i mirë..., *non è altro che una bocca-aperta*, (non è che uno sciocco)
930. u hap Krivi!..., *si è aperto il Crivo!* (venne giù un fiume d'acqua dalla montagna, come se si fosse aperto il Crivo)
931. e hapi si der mulliri, *la aprì come porta di mulino,* (la spalancò tutta)
932. hap nùnezit/sìt ka vete!, *apri le pupille/gli occhi dove vai*, (attento a dove vai)

(21 – është më)